

Enti Rregullator i Ujit



RAPORTI VJETOR

2021

Tiranë
Shkurt 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR 2021

VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
DHE
GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS KANALIZIME

Shkurt, 2022

PËRMBAJTJA

Shkurtime	2
Parathënie	3
Përmbledhje	6
1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit	15
1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë.....	15
1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të “Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë”	16
1.3 Struktura Organizative e ERRU-së	16
1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese	17
1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK	17
Situata e Licencimit Sipas Reformës	19
1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor	19
1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore	23
1.4.4 Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve	25
1.4.5 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK	27
1.4.6 Përmirësimi i Standardeve në Sektorin UK nëpërmjet Instrumenteve Rregullatore	29
1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së	30
1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare	30
1.5.1.1 Me Kuvendin e Shqipërisë	30
1.5.1.2 Me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë	30
1.5.1.3 Me Autoritetin e Konkurrencës	31
1.5.1.4 Me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).....	31
1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare	31
1.5.2.1 ERRU Anëtare e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare	32
1.5.2.2 Bashkëpunimi me Donatorë dhe Aktorë Kombëtar dhe Ndërkombëtar	32
1.5.2.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERRU-së	33
Artikuj Studimorë, Botimet.....	33
1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median	34
1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së	34
1.7.1 Të Ardhurat	34
1.7.2 Shpenzimet Operative	35
2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2021	37
3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi	45
4 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2022	47
5 Gjendja në Sektorin e Ujësllës Kanalizime	48
5.1 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2021	48
Investimet në Sektorin e Ujësllës Kanalizimeve	54
Subvencionet	54
6 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe të Sektorit të Ujit	55
Aneks 1 - Aplikimet e Shoqërive dhe Situata e Licencimit për Vitin 2021	56
Aneks 2 - Tarifat aktuale për Shërbimin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin e Ujërave të Ndotura ..	59
Aneks 3 - Treguesit e Performancës së Shoqërive UK, Viti 2021	60
Aneks 4 - Subvencionet e Shoqërive UK për Vitin 2020-2021 (në lekë)	61
Aneks 5 - Zonat Urbane me Furnizim me Ujë 24/7 orë (Viti 2021)	62
Aneks 6 - Mbledhjet dhe Vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator Viti 2021	63
Aneks 7 - Referencat Ligjore të Aktivitetit të ERRU-së	65

Shkurtime

ERRU	Enti Rregulator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjiellës Kanalizime
U	Ujësjiellës
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregulator
KM	Këshilli i Ministrave
SHA	Shoqëri Aksionere
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
IWA	Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
SHUKALB	Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë
SHUKOS	Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Kosovës
WAREG	Shoqata e Rregullatorëve të Ujit të Evropës
NER	Rrjeti i Rregullatorëve Ekonomik
ERC	Rregulatori për Shërbimet e Ujit dhe Energjisë në Maqedoninë e Veriut
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesorë të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operative dhe Mirëmbajtjeje
BE	Bashkimi Evropian
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
UPA	Uji Pa të Ardhura

Parathënie

Enti Rregullator i Ujit në përmbushje të detyrimit që e ngarkon ligji si dhe në përmbushje të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për ERRU-në për tu realizuar gjatë vitit 2021 harton çdo vit Raportin Vjetor të aktivitetit të tij, i cili pasqyron aktivitetin dhe performancën e këtij institucioni.

ERRU si institucion i pavarur për rregullimin e sektorit UK edhe gjatë vitit 2021 ka rritur përpjekjet në mbështetje të përmirësimit të performancës së sektorit duke rritur në mënyrë të vazhdueshme kërkesat ndaj shoqërive me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.

Megjithëse pandemia ka vijuar të jetë prezente edhe gjatë vitit 2021 duke ndikuar në disa raste edhe në vijimin normal të punës, ERRU ka vijuar aktivitetin e saj në zbatim të udhëzimeve dhe akteve nënligjore të nxjerra nga qeveria për masat mbrojtëse.

Drejtimet kryesore të aktivitetit të ERRU-së gjatë vitit 2021 kanë qenë:

- Licencimi i Shoqërive UK
- Miratim i Tarifave të reja të propozuara nga Shoqëritë UK
- Monitorimi i Performancës së Shoqërive UK
- Trajtim i Ankesave të Konsumatorëve dhe Monitorimi i tyre
- Pjesëmarrje në Konferenca dhe takime pune në nivel institucional kombëtar dhe ndërkombëtar si fizike ashtu dhe përmes platformave online
- Raportime dhe Analiza mbi Aktivitetin e ERRU-së, etj.

Gjatë vitit 2021, ERRU ka marrë në shqyrtim kërkesën për licencim, për efekt të përfundim të afatit të licencës së mëparshme, të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik për 31 shoqëri UK si dhe ka analizuar aplikimet për tarifa për tre shoqëri dhe ka nxjerrë vendimet përkatëse për dy shoqëri UK, përkatësisht UK Patos dhe UK Sarandë ndërsa për UK Mallakastër vendimi përfundimtar do të merret në fillim të janarit 2022. Gjithashtu ERRU ka marrë tre vendime për fillimin e procedurës për tarifa përkatësisht për UK Konispol, UK Kukës dhe UK Bulqizë.

Gjatë analizës së propozimeve për tarifa të reja ERRU, ka vendosur objektiva ambicioze për tu arritur nga shoqëritë në të ardhmen në drejtim të përmirësimit të treguesve kryesorë të performancës, si në aspektet financiare të uljes së kostove të punës dhe të energjisë ashtu dhe të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve.

Pjesë shumë e rëndësishme e punës së ERRU-së për vitin 2021 ka qenë edhe monitorimi i performancës në terren i 35 shoqërive UK nga 58 që operojnë në sektor, si një praktikë e zakonshme e ERRU-së me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes së punës së shoqërive të licencuara. Në të njëjtën kohë ERRU, ka realizuar edhe dy procese monitorimi pranë shoqërive UK Durrës dhe UK Elbasan mbi trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve drejtuar këtyre shoqërive me qëllim kryesor mbrojtjen e konsumatorit.

Konstatohet se saktësia e të dhënave të raportuara, rritja e efikasitetit të përdorimit të energjisë elektrike, organograma e stafit e cila duhet të jetë e justifikuar si dhe agregimi i sektorit si një mundësi për rritjen e efikasitetit nëpërmjet ekonomisë së shkallës mbeten sfidë për shoqëritë UK dhe për sektorin në përgjithësi.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe përmirësimit të instrumenteve rregullatore dhe studimeve të ndryshme sidomos atyre që lidhen me aplikimin për ndryshimin e tarifave, efikasitetin operacionale të shoqërive si dhe përmirësimeve në drejtim të trajtimit të ankesave të konsumatorëve si më poshtë:

- **“Metodologjia e Re e Vendosjes së Tarifave”** dokument ky shumë i rëndësishëm për punën e ERRU-së dhe sektorit UK i cili u realizua me ndihmën e një eksperti ndërkombëtar të fushës në përshtatje të ndryshimeve që kanë ndodhur në sektor dhe atyre të pritshme. Metodologjia e rishikuar e tarifave përmban dy metoda të llogaritjes së tarifave, atë ekzistuese të rishikuar “Kosto-Plus” e cila do të vazhdojë të përdoret për shoqëritë UK që propozojnë rritje tarifash deri në mbulimin 100% të kostove të O&M, dhe ajo e “Çmimit Tavan”, e cila aplikohet për tarifa të propozuara për shoqëritë me target mbulimin deri 100% të Kostove Kapitale të aktivitetit.
- **“Struktura e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes”**, u miratuar nga ERRU si struktura përgjegjëse brenda rregullatorit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorit dhe shoqërisë UK në sektorin ujësjellës kanalizime së bashku me rregulloren mbi të cilën do të zhvillojë veprimtarinë SZAM.
- **“Studimi mbi Problematikën e Mbulimit të Kostove të Energjisë për Shoqëritë UK”** i cili kishte si qëllim paraqitjen e gjendjes së shoqërive UK me nivel debie të konsiderueshme ndaj (OSHEE), analiza e faktorëve që kanë ndikuar në akumulimin e kësaj debie, si dhe dhënia e rekomandimeve për mundësinë e shlyerjes së tyre.

ERRU ka qenë aktive dhe ka vijuar bashkëpunimin me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës, me Njësinë e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvendin e Shqipërisë, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me Autoritetin e Konkurrencës në mbrojtje të interesave të konsumatorëve.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve dhe të cilësisë së aktivitetit të saj edhe pse në kushte pandemie, ERRU, përmes platformave online dhe takimeve dypalëshe ka vazhduar bashkëpunimin me WAREG (Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit), ku ERRU është anëtare me të drejta të plota, Programin e Danubit financiar nga Banka Botërore, IWA (Shoqata Ndërkombëtare e Ujit), marrëdhëniet dypalëshe kryesisht me rregullatorin e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, si dhe me shoqatat e ujësjellësve të Shqipërisë dhe Kosovës SHUKALB dhe SHUKOS.

Pjesë e këtij Raporti është edhe performanca e përgjithshme e sektorit UK për vitin 2021 përfshirë dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e performancës së sektorit në të ardhmen.

Gjendja e sektorit UK për vitin 2021 e paraqitur përmes Treguesve Kryesorë të Performancës krahasuar me vitin e mëparshëm tregon se sektori UK është përmirësuar pothuajse në të gjithë

treguesit e tij me përjashtim të treguesit mbulimi i Kostove të Operim Mirëmbajtjes i cili mbetet pothuajse në të njëjtin nivel si dhe treguesi Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë i cili është po në të njëjtin nivel edhe pse brenda shoqërive ka shumë prej të cilave e kanë përmirësuar ndjeshëm këtë tregues.

Përgjithësisht përmirësimi i gjendjes së sektorit UK për vitin 2021 vjen si rezultat i rritjes së performancës së shoqërive UK në drejtimin të menaxhimit si në rritjen e faturimit, arkëtimeve të faturave të vitit dhe atyre të prapambetura, shtimin e numrit të matësve dhe uljen e humbjeve të cilat kanë ndikuar më pas në të gjithë treguesit e tjerë.

ERRU, në përmbushje të detyrimeve ligjore të tij kundrejt sektorit UK dhe konsumatorëve, do të vazhdojë të rrisë angazhimin për të forcuar pavarësinë, transparencën, profesionalizmin, bashkëpunimin ndër institucional në mënyrë të tillë që me autoritetin e vet rregullator të krijojë ekuilibrin e duhur midis ofruesve të shërbimit, politikëbërësve dhe konsumatorit.

Theksohet fakti që për rritjen e performancës së sektorit qeveria qendrore është duke ndërmarrë një reformë që konsiston në agregimin e tij për të përfituar nga ekonomia e shkallës, si dhe për të forcuar aspektet manaxhuese të shoqërive. Detaje të reformës dhe të zhvillimit të saj në kohë sipas planeve të veprimit dhe zbatimit të hapave të duhur institucionale do të jepen gjatë vitit 2022.

Komisioni Kombëtar Rregullator

Përmbledhje

Raporti Vjetor 2021 i Aktivitetit të ERRU-së Instrument Informimi dhe Transparency

Raporti Vjetor 2021 i aktivitetit të ERRU-së paraqet veprimtarinë e këtij institucioni në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8102 dhe të Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së ERRU-së për vitin 2020”. Qëllimi i Raportit është informimi i të gjithë institucioneve qendrore, publikut dhe institucioneve të tjera që lidhen me sektorin e ujit për aktivitetin e ERRU-së në përmbushje të misionit të tij që të "sigurojë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që operatorët e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve t'i ofrojnë ato me cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe të jenë financiarisht të qëndrueshme".

Në raport, në kapituj të veçantë përcaktohen edhe objektivat e punës së ERRU-së në të ardhmen si dhe analizohet gjendja e performancës së sektorit të ujit, dhe jepen rekomandime për rritjen e performancës së tij në të ardhmen

ERRU, Statusi Ligjor, Përgjegjësitë dhe Struktura Organizative

Baza kryesore ligjore e ushtrimit të aktivitetit të ERRU-së si institucion i pavarur është ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar. Ky ligj e ngarkon ERRU-në me përgjegjësitë e licencimit, vendosjes së tarifave të shërbimeve UK dhe njëkohësisht me mbrojtjen e interesave të konsumatorëve nga mundësia e abuzimit nga shoqëritë UK me natyrën monopole të këtyre shërbimeve, si dhe për garancinë që ato të jenë cilësore.

Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 34 në vitin 2016. Në përbërje të ERRU-së janë gjithsej 28 punonjës, nga të cilët 5 anëtarë komisioni, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës. Duke parur parasysh aktivitetin ekzekutiv gjithnjë në rritje të ERRU-së në sektor, ndihet mjaft nevoja e plotësimit të organikës aktuale me pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, për të cilin i është bërë kërkesë Kuvendit të Shqipërisë pasi është marrë aprovimi më parë nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Administratës Publike. Duke qenë se ERRU ka pavarësi financiare nga buxheti i shtetit për zhvillimin e aktivitetit të tij, pozicioni shtesë i Sekretarit të Përgjithshëm nuk ka ndonjë efekt financiar në buxhetin e shtetit. Gjithsesi në përgjigje të kërkesave të kohës për rregullimin e veprimtarisë së sektorit dhe për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së ERRU-së është i nevojshëm rishikimi në disa drejtime i ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar. Për përmirësimin e rolit të ERRU-së në rregullimin e sektorit UK, ligji 8102 për Rregullimin e sektorit UK ka nevojë të rishikohet në veçanti për të eliminuar konfuzionin e mbivendosjes së kompetencave ndërmjet ERRU-së dhe AKUM-it.

Licencimi i Shoqërive UK

Në sektorin UK shërbimi i “grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik” për vitin 2021 është ofruar **nga 58 shoqëri nga të cilat 53 prej tyre disponojnë licenca të vlefshme**, ndërsa për 5 të tjerat gjendja është si më poshtë:

UK Patos është në proces për rinovim të licencës pranë ERRU-së për efekt të ndryshimit të zonës së shërbimit që më parë ishte pjesë e UK Fier, por që akoma nuk kanë mundur të sigurojnë Akt-Miratimin Higjiëno – Sanitar.

UK Divjakë vijon të operojë me licencë të pavlefshme pasi ende nuk ka kryer regjistrimet përkatëse të aseteve pranë QKB.

Shoqëritë e reja, përkatësisht UK Pustec, UK Kamëz dhe Ndërmarrja e Bashkisë Klos, nuk kanë arritur të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar për licencim, përkatësisht shoqëritë UK Pustec dhe Kamëz për Akt Miratim Higjieno Sanitar, ndërsa bashkia Klos ende nuk ka krijuar shoqërinë e saj aksionare sipas VKM Nr.63.

Gjatë vitit 2021 ERRU ka vijuar përpjekjet për konkretizimin e nevojës për rishikimin e akteve dhe nën akteve ligjore përkatëse për përfitim të Akt Miratimit Higjieno Sanitar duke ju drejtuar përsëri me shkresë zyrtare Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për ngritjen e grupit të punës me përfaqësues nga institucionet përgjegjëse për këtë çështje. ERRU ka zhvilluar takime me Drejtorin e Programit të Ujit të GIZ, në lidhje me asistencën e nevojshme që mund të kërkohej për përmirësimet e mësipërme, nga ku është marrë premtimi për të përfshirë në buxhetin e vitit 2022 të GIZ fondet e nevojshme për asistencën e kërkuar.

***Procesi i
Miratimit të
Tarifave për
Shërbimet UK***

Gjatë vitit 2021 ERRU ka miratuar tarifa për 3 shoqëri UK përkatësisht për UK Patos, UK Sarandë si dhe për UK Mallakastër. Gjithashtu KKRR ka marrë vendimet përkatëse për fillim procedure të aplikimit për nivel të ri tarifor edhe për 3 shoqëritë UK Bulqizë, UK Konispol dhe UK Kukës. Këto dy të fundit janë shoqëri që operojnë me tarifa të pa miratuara nga ERRU dhe me aplikimet përmbushin detyrimin ligjor në këtë drejtim.

UK Patos është një nga shoqëritë me performancën më të dobët financiare që mbulonte vetëm 25% të kostove të O&M, si rezultat i kostove të larta, veçanërisht atyre të energjisë elektrike. Tarifat e reja të miratuara synojnë kryesisht përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërisë dhe mundëson pagimin e një pjesë të faturës së energjisë elektrike. ERRU miratoi edhe tarifën e KUN, shërbime që më parë ofroheshin dhe financoheshin nga bashkia Patos.

UK Sarandë ka aplikuar për herë të parë pas riorganizimit për tarifa të reja e të unifikuara për të dyja zonat Ksamil dhe Sarandë. ERRU miratoi gjithashtu edhe tarifën e shitjes së ujit me shumicë për UK Finiq. Tarifat e reja të miratuara mundësojnë përmirësimin e performancës financiare duke mbuluar mbi 100% të kostove të O&M, interesat e kredive të marra, si dhe pjesërisht kostot e amortizimit.

UK Mallakastër ka aplikuar për të miratuar tarifa për herë të parë për shkak të problemeve që kanë patur vazhdimisht me licencimin. Me tarifën e reja të miratuara përmbushet detyrimi ligjor që shoqëria duhet të operojë sipas tarifave të miratuara nga ERRU, si edhe synohet përmirësimi i gjendjes financiare duke mbuluar rreth 61% të kostove të O&M. Në vendimin për tarifa ERRU i ka vendosur shoqërisë objektiva ambicioze që në të ardhmen e afërt të mundësohet përmirësimi i mëtejshëm i treguesve financiarë të saj.

***Monitorimi i
Performancës
së Shoqërive
UK***

Gjatë vitit 2021, ERRU, pavarësisht vështirësive nga pandemia e COVID 19 ka monitoruar me vizita të shoqëruara në terren për 35 shoqëritë UK kryesore në të gjithë vendin duke filluar nga dy shoqëritë që zënë peshën kryesore të konsumatorit dhe të sektorit, përkatësisht UK Tiranë dhe UK Durrës.

Gjatë praktikës rishtas të monitorimit të shoqërive ERRU ka përgatitur dhe proceduar bazuar në një skedë (model) monitorimi e cila ka qenë baza e vlerësimit dhe diskutimit të performancës së shoqërisë. Procesi i monitorimit realizohet nga ekipi i ERRU-së gjatë vizitës në vend duke diskutuar si me stafin drejtues kyç menaxhues të shoqërisë edhe me kryetarin e bashkisë përkatëse, i cili është përgjegjës nga ana ligjore për realizimin me cilësi dhe efikasitet të

shërbimeve të FU dhe KUN për konsumatorët në territorin administrativ të bashkisë.

Kjo praktikë monitorimi në baza të dhënash dhe tregues performance vjetore e përsëritshme çdo vit për secilën shoqëri ka rezultuar mjaft e frytshme në drejtim të evidentimit të problemeve që has secila shoqëri UK gjatë aktivitetit të saj në ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Nga ana tjetër ERRU gjatë këtyre takimeve diskuton dhe jep alternativa të zgjidhjes së këtyre problematikave referuar edhe eksperiencës të shoqërive të tjera. Kjo praktikë i ka mundësuar ERRU-së krijimin e një panorame mjaft të qartë të larmisë së problematikave për të gjithë sektorin të unifikuar ose jo, si edhe për dhënien e rekomandimeve në nivel strategjik për përmirësimin e performancës së sektorit aktualisht dhe në terma afatmesme dhe afatgjata.

***Trajtimi dhe
Monitorimi i
Ankesave të
Konsumatorëve***

Trajtimi i ankesave të konsumatorëve ka vijuar të jetë në fokusin kryesor të punës së ERRU-së për mbrojtjen e interesave të tyre dhe për të garantuar cilësinë dhe përmirësimin e shërbimit të FU dhe KUN që ofrojnë shoqëritë UK. Gjatë vitit 2021 pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorit janë depozituar 14 ankesa nga konsumatorë familjarë ku 9 prej tyre ju janë drejtuar shoqërive UK dhe kanë vendosur ERRU-në “për dijeni” për ankesën e tyre. Edhe për këto lloj ankesash, ERRU ka vijuar trajtimin e ankesave duke ndjekur procedurat e komunikimit zyrtar me shoqëritë UK. Veçanërisht i është kushtuar rëndësi trajtimit të një ankesë problematike nga një konsumator familjar me verifikim në terren dhe takim të përbashkët Konsumator - Rregullator - Shoqëri UK, e cila është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme për të dyja palët.

ERRU ka patur si objektiv zhvillimin e një praktike të unifikuar monitorimi për trajtimin e ankesave nga shoqëritë UK me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit në këndvështrimin e së drejtës së tij për t’u ankuar nëpërmjet një procedure korrekte ligjore. Në përmbushje të këtij objektiv, ERRU gjatë vitit 2021 zhvilloi dy procese monitorimi pranë shoqërive UK Durrës dhe UK Elbasan mbi trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve ndaj këtyre shoqërive. Monitorimi u fokusua në infrastrukturën e organizimit dhe procedurave të shoqërisë për trajtimin e ankesave të konsumatorëve, në respektimin e legjislacionit, si dhe evidentimi i problematikave dhe të metave që kanë shoqëritë në këtë drejtim. Në përfundim të monitorimeve, u hartuan raportet finale ku u pasqyruan gjetjet dhe rekomandimet e ERRU-së mbi procesin e trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve.

***Përmirësimi i
Standardeve në
Sektorin e UK
Nëpërmjet
Instrumenteve
Rregullatore***

Përmirësimi i standardeve rregullatore edhe për vitin 2021 ka qenë pjesë e punës së ERRU-së ku i është kushtuar një rëndësi e veçantë përmirësimit dhe pasurimit të instrumenteve rregullatore kryesisht ato që lidhen me aplikimet për ndryshimin e tarifave, si dhe ato të trajtimit të ankesave të konsumatorëve. **“Metodologjia e Vendosjes së Tarifave”** Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr.539, datë 30.12.2021 miratoi dokumentin e ri “Metodologjia dhe procedura për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve”. Hartimi i tij u realizua edhe me ndihmën e një eksperti ndërkombëtar të fushës, financuar nga Banka Botërore në kuadër të Programit të Danubit duke marrë në konsideratë praktikën më të mira rregullatore të Europës të përshtatura më tej me nevojat e sektorit UK në vendin tonë. Metodologjia e rishikuar e tarifave përmban dy metoda të llogaritjes së tarifave, atë ekzistuese të rishikuar “Kosto-Plus” e cila do të vazhdojë të përdoret për shoqëritë UK që propozojnë rritje tarifash deri në mbulimin 100% të kostove të O&M, dhe ajo e “Çmimit Tavan”, e

cila aplikohet për tarifa të propozuara për shoqëritë me target mbulimin deri 100% të Kostove Kapitale të aktivitetit. Metodologjia sipas “Çmimit Tavan”, kërkon që shoqëritë të aplikojnë për tarifa të reja detyruesisht bazuar në një Plan Biznesi 5 vjeçar. Në këtë të fundit ERRU përcakton planin tarifor dhe objektivat për periudhën rregullatore 5 vjeçare gjatë së cilës shoqëria do të jetë në monitorim të vazhdueshëm. Në fund të çdo viti ERRU do të përditësojë tarifën e tyre, sipas nivelit të performancës dhe efektivitetit të kostos që shoqëria ka arritur për një vit, dhe këto tarifa do të hyjnë në fuqi për vitin e ardhshëm.

“Struktura e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes”, u miratua nga KKRR me vendimin nr. 450, datë 23.11.2021, si struktura përgjegjëse brenda rregullatorit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorit dhe shoqërisë UK. Miratimi i saj u bë në zbatim të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar por edhe në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi në Rezolutë për vitin 2021. Me vendimin e KKRR nr. 478, datë 09.12.2021 u miratua rregullorja “Për miratimin e aktit normativ administrativ “Rregullore për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes midis konsumatorit dhe shoqërisë UK nga Struktura e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes”, dokument mbi të cilën do të zhvillojë veprimtarinë SZAM.

“Studimi mbi Problematikën e Mbulimit të Kostove të Energjisë nga Shoqëritë UK” u realizua gjatë vitit 2021 nga ERRU dhe u prezantua edhe në Konferencën Ballkanike Vjetore për Ujin të zhvilluar nga SHUKALB-SHUKOS në Nëntor 2021. Qëllimi i studimit ishte evidentimi i gjendjes debitoare të shoqërive UK për pagesën e energjisë elektrike ndaj OSHEE-së, analiza e faktorëve që kanë ndikuar në akumulimin e kësaj debie, si dhe dhënia e rekomandimeve për mundësinë për rritjen e aftësisë financiare të shoqërive UK për të bërë të mundur pagesën e faturës së energjisë elektrike, si dhe të detyrimeve të prapambetura ndaj OSHEE-së.

Nëpërmjet të dhënave të raportuara nga OSHEE dhe nga Shoqëritë e Sektorit UK në Shqipëri, ERRU konstatoi se mundësitë për zgjidhjen e kësaj problematike të krijuar ndër vite janë: rritja e efikasitetit të përdorimit të energjisë elektrike, përmirësimi i treguesve të performancës në tërësi për shoqëritë UK, Plan i ri tarifor për shërbimet Ujës-jellës - Kanalizime që shoqëritë ofrojnë, Subvencionimi pjesërisht/ plotësisht nga buxheti i shtetit.

Studimi analizoi në veçanti dhe në mënyrë të detajuar problematikën për 7 Shoqëri UK të cilat përfaqësonin rreth 70% të detyrimit total për energjinë elektrike. Analiza u shoqërua edhe me rekomandimet përkatëse për përmirësimin e performancës financiare për secilën prej 7 shoqërive, por që shërben në mënyrë përgjithësuese për të gjithë sektorin.

***Të Ardhurat
dhe
Shpenzimet e
ERRU-së***

Burimet e financimit të aktivitetit e veprimtarisë së ERRU janë pagesat rregullatore vjetore nga Shoqëritë UK si dhe pagesat për licencime.

Të ardhurat totale nga veprimtaria gjatë vitit 2021 u realizuan në vlerën 54, 671, 805 lekë përbërë, përkatësisht nga pagesat rregullatore në vlerën 53, 241, 805 lekë dhe nga licencimet dhe rinovimet e licencave në vlerën prej 1,430,000 lekë. Shpenzimet buxhetore të kryera nga ERRU gjatë vitit 2021 janë realizuar në shumën 42, 893, 161 lekë nga 51, 919, 550 lekë të planifikuara për tu shpenzuar gjatë vitit. Në mbyllje të vitit 2021, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të ERRU-së garanton plotësisht realizimin e parashikimit të planit të shpenzimeve të vitit 2022.

Performanca e Sektorit UK dhe Analiza e çdo Treguesi të Veçantë

ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme gjendjen dhe performancën e sektorit UK. Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës të miratuar nga ERRU. Situata e treguesve të performancës për vitin 2021 dhe tendenca e tyre krahasuar me vitin paraardhës 2020 jepet në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2020	Viti 2021	Tendenca
1	Uji Pa të Ardhura	%	65.4	64.7	↗
2	Mbulimi i Kostove O&M	%	103.2	103	↘
3	Norma e Arkëtimit Korrente	%	76.6	79.8	↗
4	Norma Arkëtimit e Përgjithshme	%	89.8	94.1	↗
5	Niveli i Matjes	%	79.6	80.7	↗
6	Efiçenca e Stafit	(stafi/1000 lidhje UK)	5.32	5.28/4.9*	↗
7	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	13.8	13.8	=
8	Mbulimi me Furnizimin me Ujë	%	76.1	77	↗
9	Mbulimi me Kanalizime	%	51.5	51.9	↗

Burimi: ERRU

*** Efiçenca e Stafit 5.28 staf për 1000 lidhje përfshin edhe personelin roje të nënkontraktuar me privatin ndërsa 4.9 staf për 1000 lidhje UK nuk përfshinë këto të fundit.**

Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2021 paraqiten me një përmirësim të lehtë pothuajse në të gjithë treguesit me përjashtim të treguesve Mbulimi i Kostove O&M dhe Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë të cilët mbesin në të njëjtin nivel me ato të vitit 2020.

Ndërkohë që është përmirësuar treguesi i Normës së Arkëtimit Korrent, kemi një përkeqësim të lehtë të treguesit të Mbulimit të Kostove të O&M, pra rritja e kostove të O&M nuk është kompensuar mjaftueshëm me të ardhurat.

Përmirësimi i gjendjes së sektorit UK për vitin 2021 ka ardhur si rezultat i rritjes së performancës së shoqërive në drejtim të menaxhimit nga rritja e faturimeve dhe arkëtimeve dhe ulja e humbjeve.

Ndërkohë përmirësimi i gjendjes financiare të sektorit për të tentuar mbulimin e Kostove Totale kërkon një kontroll dhe menaxhim më të mirë të kostove të O&M që ato të jenë të justifikueshme (mundësisht të reduktohen), si edhe rritja e të ardhurave nga faturimi dhe mbledhja e tyre.

Në detaje analizohet ecuria e secilit tregues kryesor të performancës, përkatësisht:

"Uji Pa të Ardhura" (UPA), mbetet akoma në nivele mjaft të larta, por që për vitin 2021 është përmirësuar me rreth 0.7% krahasuar me një vit më parë. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së nivelit të faturimit me 4.9 milion m³ përkundërt atij të prodhuar i cili është rritur me 2.6 milion m³ gjatë vitit 2021. Ndikimi kryesor ka ardhur nga shoqëria UK Tiranë e cila ka një rritje të volumit të faturuar me 2.7 milion m³ e cila është më e madhe se sasia totale e rritur e ujit të prodhuar nga i gjithë sektori për vitin 2021. Pjesa më e madhe e sasisë së ujit të faturuar me rreth 2 milion m³ për UK Tiranë ka ardhur nga rritja e volumit të faturuar për bizneset private, si edhe nga sasia e ujit të shitur me shumicë. Në nivele më të ulëta faturimi paraqiten UK Durrës me 485 mijë m³, UK Selenicë me 319 mijë m³, Dropull me 290 mijë m³, UK Sarandë 260 mijë m³ etj.

"Mbulimi i Kostos së O&M" është treguesi i cili shpreh mbulimin e kostove direkte me të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë. Në kostot e O&M përfshihen kostot për personelin, energjinë, kimikatet dhe kosto të tjera sekondare. Mbulimi i Kostos së O&M për vitin 2021 është 103% pothuajse i njëjtë me atë të vitit paraardhës që ishte 103.2%. Si numër shoqërisë ky tregues ka pak përmirësim sepse nga 57 shoqëri vetëm 12 prej tyre arrijnë të mbulojnë mbi 100% kostot O&M, nga 10 shoqëri që ishin në vitin 2020. Në sektor janë 24 shoqëri të cilat performojnë dobët në nivelin 70% të këtij treguesi që me vështirësi mbulojnë pagat e personelit. Pjesa tjetër prej 21 shoqërive që mbeten janë në nivelet 73.5% deri 100% të këtij treguesi. Mbulimi i kostove Totale në të cilat përfshihen dhe kostot e amortizimit dhe të interesave të kredive edhe për vitin 2021 vijon të mbulohet tërësisht vetëm nga dy shoqëri UK në sektor, përkatësisht UK Tiranë dhe UK Ersekë.

"Norma e Arkëtimit" Norma e Arkëtimit Korrente (arkëtimi vetëm për faturimin brenda vitit, pa borxhet e së kaluarës) për sektorin UK në vitin 2021 rezulton të jetë përmirësuar në 79.8 % nga 76.6 % që ishte në vitin 2020. Ndikimin kryesorë e japin shoqëritë të cilat kanë një normë arkëtimi korrente mbi mesataren e sektorit siç janë, Kamëz, Poliçan, Vorë, Pogradec, Vlorë, Konispol, Lezhë .etj.. Norma e Arkëtimit e Përgjithshme, ku përfshihen dhe kostot e amortizimit dhe të interesave të kredive për vitin 2021 paraqitet e përmirësuar në 94.1% nga 89.8% në vitin 2020. Kjo tregon se shoqëritë kanë punuar mirë në drejtim të mbledhjes së debive të prapambetura ku shpesh herë nga ana e tyre përdoret alternativa e lidhjes së akt marrëveshjeve me debitorët për shlyerjen e tyre. Shoqëritë të cilat kanë punuar mirë në drejtim të mbledhjes së debive të prapambetura për vitin 2021 janë Tiranë, Elbasan, Sarandë, Divjakë, Vlorë, Belsh, Përmet, Berat Kuçovë, Ura Vajguore, Tepelenë, Korçë etj.

"Niveli i Matjes" ka një përmirësim konstant nga viti në vit dhe për vitin 2021 është përmirësuar me 1.1% dhe është në nivelin 80.7%. Megjithatë gjatë vitit janë instaluar rreth 39,146 matës uji, në sektor ende raportohen 177, 024 klientë pa matës nga të cilët 7,111 janë të kategorisë jo familjarë. Shoqëritë duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë pajisjes 100% të konsumatorëve me matës, në mënyrë që konsumatorët të paguajnë volumn real të ujit të konsumuar, por edhe për faktin se faturimi aforfe lë shteg për shpërdorimin e ujit nga konsumatorët për ujitje, veçanërisht ato të shtëpive private dhe zonave rurale e cila jep më pas impakt negativ edhe në treguesin tjetër të Uji Pa të Ardhura.

"Eficienca e Stafit" për vitin 2021 është 5.28 punonjës për 1000 lidhje UK kundrejt 5.32 që ishte në vitin 2020, këtu janë përfshirë stafet sipas organogramës së shoqërive përfshirë dhe personat për shërbim roje të veta ose të nënkontraktuara tek privati. Treguesi i efikasitetit së stafit pa përfshirë shërbimin roje është në nivelin e 4.9 punonjës për 1000 lidhje UK. Kjo mënyrë vlerësimi i këtij treguesi bazuar në organogramën e shoqërisë do të ndiqet nga ERRU në të ardhmen sepse i vendos të gjithë shoqëritë në një sistem të njëjtë krahasimi për këtë tregues. Përmirësimi i lehtë i efikasitetit së stafit për vitin 2021, nuk tregon për përmirësimin e vëmendjes së shoqërisë për këtë tregues sepse kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve të ujit me rreth 17,200 lidhje ndërkohë që numri i stafit është shtuar me 11 punonjës. Në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të kërkesës në plotësimin e detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së veprave me personel roje të sistemeve të FU dhe KUN, si dhe abuzimi me punësimet e pajustificuara. Në këtë drejtim kërkohet një angazhim më i madh nga shoqëritë dhe bashkitë përkatëse për të eliminuar punësimet nepotike apo të karakterit politik.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" lidhet direkt me cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe shpreh mesataren e orëve të furnizimit me ujë në ditë të konsumatorëve. Ky tregues për vitin 2021 mbetet i njëjtë në nivelin 13.79 orë/ditë si në vitin 2020. Objektivi afatshkurtër i qeverisë qendrore me investime nga buxheti i shtetit nëpërmjet AKUM është të ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë 24 orë deri në vitin 2023 për 58 nga 66 qendra urbane, projekt ky që ka filluar të zbatohet që në vitin 2018. Deri në fund të vitit 2020 si rezultat i investimeve të kryera nga AKUM u arrit një regjim furnizimi me ujë pa ndërprerje (24/7 orë) i 22 qendrave urbane, përkatësisht: Shkodër, Fushë Arrëz, Lezhë, Tropojë, Gramsh, Cërrik, Korçë, Pogradec, Maliq, Bilisht, Fier, Sarandë, Himarë, Konispol, Tepelenë, Përmet, Pukë, Vau Dejës, Koplik, Peqin, Poliçan dhe Këlcyrë.

Gjatë vitit 2021 si rezultat i investimeve të qeverisë qendrore nëpërmjet AKUM-it për vlerën 945,867,715 lekë, u arrit përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për konsumatorët me një regjim 24/7 orë edhe për 7 qendra urbane, përkatësisht Kamëz, Krujë, Rrëshen, Ersekë, Berat, Kuçovë dhe Memaliaj duke e çuar në total në 29 qendra urbane të banuara me regjim të pandërprerë të furnizimit me ujë.

"Mbulimi i Furnizimit me Ujë" për vitin 2021 ka një përmirësim me rreth 1% dhe është në nivelin e 77% nga 76.1% që ishte në vitin 2020. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i shtimit të popullsisë së shërbyer në zonën e shërbimit me rreth 46,716 banorë. Impakti kryesor ka ardhur nga shtimi i popullsisë së shërbyer nga shoqëritë Kamëz, Tiranë dhe Durrës.

"Mbulimi me Kanalizime" për vitin 2021 ka një përmirësim të papërfillshëm me 0.4 % krahasuar me vitin 2020 dhe është në nivelin e 51.9 %, pasi popullsia e shërbyer me KUN është rritur vetëm me rreth 17,770 banorë. Në sektor janë akoma rreth 195 mijë banorë të cilët e realizojnë grumbullimin e ujërave të ndotura nëpërmjet gropave septike kundrejt 2.3 milion banorëve që shërbehen nga shoqëria me kanalizime. Gjithashtu rritja e cilësisë së shërbimit të kanalizimeve lidhet edhe me nevojën e të pasurit të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Për vitin 2021 kanë raportuar të dhëna 7 shoqëri ku numri total i popullsisë së shërbyer me ITUN është rreth 497,960 banorë me një rritje prej 33,563 banorë krahasuar me vitin 2020. Ky tregues gjithsesi mbetet në nivele të pakënaqshme.

**Objektivat e
ERRU-së për
Vitin 2022**

- Rishikimin e ligjit nr. 8102 për forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur dhe të performancës së tij në shërbim të rritjes së performancës së sektorit në përgjithësi.
- Të ndjekë dhe nxisë procesin e plotësimit të strukturës së saj organizative me pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm në përgjigje të rritjes së efikasitetit të aktivitetit në përputhje me kërkesat e kohës dhe me detyrat që e ngarkon ligji.
- Në vijim të kërkesës drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për nevojën e ngritjes së grupit të punës për rishikimin e nën akteve ligjore që lidhen me Akt Miratimin Higjieno Sanitar, si kusht i domosdoshëm për licencimin e shoqërive UK, të vijoje të jetë aktive dhe ta ndjekë këtë proces deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.
- Të vijoje të jetë proaktive në drejtim të monitorimit të shoqërive UK në nxitje për përmirësimin e treguesve kryesorë të performancës, në veçanti të uljes së humbjeve dhe rritjes së normës së arkëtimit.

- Të forcojë kontrollin në shoqëritë UK me qëllim ndërgjegjësimin e tyre në raportimin e të dhënave të sakta.
- Të vijojë punën për procesin e monitorimit të shoqërive UK mbi mënyrën e trajtimit të ankesave të konsumatorëve dhe evidentimit të problematikave që kanë shoqëritë në drejtim të ofrimit të shërbimit ujësjellës kanalizime, duke lënë rekomandime konkrete për tu realizuar nga ato.
- Në kuadër të rritjes profesionale të stafit, të organizojë trajnimin në vazhdimësi të tyre me anë të programit të ASPA, si dhe duke shfrytëzuar mundësitë nga bashkëpunimet me rregullatorët Evropianë të sektorit të ujit dhe të rajonit të Ballkanit Perëndimor.
- Të marrë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK për përmirësimin e instrumenteve rregullatore gjatë veprimtarisë së tij.
- Në vazhdimësi të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të forcojë bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKUM-it, me AMBU, si dhe aktorët e tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për përmirësimin e performancës së sektorit UK.
- Me mbështetjen e Programit të Modernizimit të Sektorit UK në Shqipëri, financuar nga Banka Botërore të synohet hartimi i një udhëzuesi dhe model i unifikuar i Planit 5 Vjeçar të Biznesit për Shoqëritë UK, përfshirë dhe trajnimet përkatëse të nevojshme për këtë qëllim.
- Mbas formalizimit të reformës së qeverisë qendrore për riorganizimin e mënyrës së administrimit të sektorit UK, të luajë rol aktiv në mbështetje të realizimit të objektivave përkatëse për realizimin e saj dhe për përmirësimin e performancës së sektorit.

***Rekomandime
për
Përmirësimin e
Performancës
së Sektorit UK
dhe të ERRU-së***

- Duke patur parasysh problematiken për liçensimin e shoqërive UK, të fillojë procesi i ngritjes së grupit të punës për rishikimin dhe hartimin e akteve të nevojshme nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjiene Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të rregullores së Inspektimeve Higjiene Sanitare për sistemet e FU dhe KUN. Hartimi i nën akteve të mësipërme do të shërbejë rritjes së garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e riskut të ndotjes së rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit.
- Për shoqëritë problematike në drejtim të pagesës së faturës së energjisë elektrike në bashkëpunim me AKUM-ERRU-OSHEE të realizohet një analizë e thelluar e gjendjes për secilën shoqëri sipas një vlerësimi real të Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP), si dhe të firmoset një kontratë performance bazuar në objektiva që synojnë përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive. Në kontratën e performancës fokusi kryesor duhet të jetë në TKP, sidomos të UPA, Normës Korrente të Arkëtimit dhe Efiçencës së Stafit dhe të përmirësimit të treguesit të efiçencës së energjisë elektrike. Realizimet e vlerësuara të këtyre kontratave të shërbejnë edhe si element bazë për shpërndarjen e subvencioneve nga qeveria qendrore për shoqëritë UK.

- Në kuadër të nismës së qeverisë qendrore të ndërmarrë gjatë vitit 2021 mbi agregimin e sektorit si avantazh i ekonomisë së shkallës për përmirësimin e performancës së sektorit në drejtim të përmirësimit të efikasitetit operacionale dhe qëndrueshmërisë financiare, të vijohet sa më parë me konkretizimin e këtij procesi sa i përket formës dhe detaje të tjera organizative, financiare dhe kohore që janë parashikuar për realizimin e saj.
- Për rritjen e efikasitetit të ERRU-së në mbështetje të përmirësimit të performancës së sektorit të UK në vend, si dhe në përgjigje të kërkesave të kohës për sektorin dhe të ndryshimeve klimatike, të mbështetet rishikimi i ligjit nr. 8102 për rregullimin e sektorit.

1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit

1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është një institucion i pavarur publik, i cili rregullon sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. ERRU është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, i cili ka si qëllim kryesor:

“Në një ambient monopol shoqëritë UK të ofrojnë shërbime ujësjellës kanalizime me cilësi maksimalisht të mundshme për konsumatorët duke mbrojtur këto të fundit nga abuzimet me tarifa të larta të pajustifikuara dhe krijimin e një mjedisi transparent dhe ligjor në sektor”.

Përgjegjësitë kryesore të ERRU janë licencimi i shoqërive që veprojnë në sektor bazuar në përmbushjen e kushteve që stafi teknik dhe ai menaxhues të kenë aftësinë për të realizuar një operim profesional të aktivitetit të shoqërisë, si dhe të jenë përmbushur kërkesat higjieno sanitare të elementeve të sistemeve të furnizimit me ujë dhe KUN për të garantuar sigurinë e shëndetit publik. ERRU ka përgjegjësinë e marrjes së masave administrative ndaj shoqërive që veprojnë në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 8102 dhe kushteve të licencës së operimit.

Përgjegjësi tjetër kryesore e ERRU-së është miratimi i tarifave të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për të gjitha kategoritë e klientëve bazuar në kostot e justifikuara të shoqërisë duke nxitur një qëndrueshmëri financiare në rritje të kësaj të fundit, si dhe duke mbrojtur interesat e konsumatorëve. Ndër të tjera ERRU ka përgjegjësi të monitorojë gjendjen e sektorit dhe të shoqërive në veçanti dhe të përgatisë raporte me të cilat informon Kuvendin, Këshillin e Ministrave dhe publikun.

Në zbatim të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, Këshilli i Ministrave miratoi VKM nr. 1089, datë 24.12.2020 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve”. Kjo VKM parashikon mënyrën e funksionimit të strukturës alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që duhet të krijohet pranë ERRU dhe autoriteteve rregullatore të tjera.

KKRR me vendimin nr. 450, datë 23.11.2021, “Për krijimin e strukturës së zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes (SZAM)” miratoi krijimin e SZAM pranë ERRU dhe me vendimin nr. 478, datë 09.12.2021 “Për miratimin e aktit normativ administrativ “Rregullore për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes midis konsumatorit dhe shoqërisë UK nga Struktura e ZAM”, miratoi rregulloren mbi të cilën do të zhvillojë veprimtarinë SZAM.

ERRU gjithashtu ngarkohet me përgjegjësi sipas ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, i cili ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, duke promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese.

Gjithsesi në përgjigje të kërkesave të kohës për rregullimin e veprimtarisë së sektorit dhe për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së ERRU-së është i nevojshëm rishikimi në disa drejtime të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe KUN”, në veçanti për të eliminuar konfuzionin e mbivendosjes së kompetencave ndërmjet ERRU-së dhe AKUM-it. ERRU e ka përgatitur për propozim draft-propozimin përkatës.

1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të “Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë”

ERRU nuk është subjekt i detyrimeve ndërkombëtare, si dhe i rekomandimeve të “Progres-Raportit për Shqipërinë” që duhen përmbushur prej saj.

1.3 Struktura Organizative e ERRU-së

Struktura dhe organika e ERRU-së rregullohen në përputhje me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”. Si institucion i pavarur struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të nëpunësve të Entit, miratohen me vendim të Kuvendit të Shqipërisë.

Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 34/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)”. Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë gjithsej 28 punonjës, nga të cilët 5 anëtarë komisioni, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës, struktura organizative e së cilës, jepet në figurën 1.




Figura 1. Struktura e Entit Rregullator të Ujit

Kjo strukturë, ka për qëllim rritjen e efikasitetit, profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të rregullatorit duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat dhe sfidat që ERRU-ja ka përballë reformës së sektorit ujësjellës kanalizime që burojnë edhe nga objektivat strategjike të institucionit.

Duke parur parasysh aktivitetin ekzekutiv gjithnjë në rritje të ERRU-së në sektor, ndihet mjaft e nevojshme plotësimi i organikës me pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, për të cilin është marrë aprovimi paraprak nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Administratës Publike dhe aktualisht është depozituar kjo kërkesë pranë Kuvendit të Shqipërisë për aprovim. Theksohet fakti që duke qenë se ERRU ka pavarësi financiare nga buxheti i shtetit për zhvillimin e aktivitetit të saj, pozicioni shtesë i Sekretarit të Përgjithshëm nuk ka ndonjë efekt financiar në buxhetin e shtetit.

1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese

1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK

Në sektorin UK shërbimi i *"grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik"* për vitin 2021 është ofruar nga 58 shoqëri nga të cilat vetëm 2 prej tyre kryejnë edhe shërbimin e *"përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik"*. Shërbimi i *"grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura"* ofrohet nga 53 shoqëri ndërsa përpunimi i tyre arrihet të kryhet vetëm nëpërmjet 8 (tetë) impianteve të ndërtuara ndër të cilat vetëm 5 (pesë) prej tyre janë të pajisur me licencë nga ERRU, ndërsa 3 (tre) prej tyre ende nuk plotësojnë kërkesat ligjore për licencim për këtë kategori shërbimi.

Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me procesin e licencimit, gjatë vitit 2021, pranë Enti Rregullator të Ujit janë paraqitur 32 aplikime për licencim që i përkasin 31 shoqërive UK pasi shoqëria UK Krujë ka aplikuar dy herë brenda vitit për shkak të përfundimit të afatit të licencës së mëparshme si dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor.

Enti Rregullator i Ujit ka marrë në shqyrtim kërkesën për licencim apo rinovim licence për 31 shoqëri UK dhe kanë kaluar për vendimmarrje dhe janë miratuar në KKRR, licencat përkatëse për 30 shoqëri UK, pasi shoqëria UK Patos mbetet në proces për mos plotësim të plotë të dokumentacionit. (shih aneksi 1 tabela 1).

Aplikimet për licencim kanë qenë si pasojë e:

- a) përfundimi i afatit të licencës për 23 (njëzet e tre) shoqëri UK nga të cilat 1 (një) shoqëri, UK Lezhë ka dhe shtim të kategorisë D;
- b) ndryshimeve të drejtuesve ligjor dhe/ose teknik në 6 (gjashtë) shoqëri UK;
- c) licencim për herë të parë 1 (një) shoqëri, UK Memaliaj e cila deri në vitin 2020 ka qenë pjesë e shoqërisë UK Tepelenë;
- d) aplikim për ndryshim të zonës së shërbimit për 1 (një) shoqëri, UK Sarandë.


Në mbyllje të vitit 2021 rezultojnë me licencë të vlefshme të miratuar nga ERRU sipas ligjit, 53 Shoqëri UK nga 58 që operojnë në sektor (shih aneksi 1 tabela 2).

Konkretisht:

- Pesëdhjetë e tre (53) operatorë disponojnë licenca të vlefshme;
- Një (1) operator është në proces për rinovim të licencës, UK Patos e cila për efekt të ndryshimit të zonës së shërbimit që më parë shërbeheshin nga UK Fier, nuk ka mundur të sigurojë akt-miratimin higjieno – sanitar.
- Një (1) operator (U Divjakë) operon me licencë të pavlefshme:
 - *Shoqëria U Divjakë* ende nuk ka kryer reflektimet përkatëse pranë QKB ndonëse fokusi i ERRU-së ka qenë licencimi i saj. Janë organizuar disa takime me shoqërinë ku i është kërkuar të licencohet edhe me zonat ekzistuese të saj deri sa të përfundojë riorganizimi i plotë i shoqërisë. Në inspektimin e fundit të kryer pranë shoqërisë, ndonëse KKRR doli me vendimin “masë administrative me gjobë” shoqëria ende nuk ka reaguar për finalizimin e procesit të licencimit.
- Tre (3) shoqëritë e reja (UK Pustec, UK Kamëz dhe Ndërmarrja e bashkisë Klos), me gjithë komunikimet e shumta, nuk arritën të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar për licencim dhe të pajiseshin me licencë për këtë vit, por vëmë në dukje se UK Kamëz dhe UK Pustec janë në

përfundim të plotësimit të dokumentacionit për tu licencuar në fillim të vitit 2022, ndërsa bashkia Klos ende nuk ka krijuar shoqërinë e saj aksionare sipas VKM Nr.63.

Në grafikun 1, jepet situata e licencimit në përqindje, ndërsa për secilën nga 58 shoqëritë UK jepet në aneksin 1, tabela 2.



Grafiku 1. Situata aktuale e licencimit

Arsyet e “aplikimeve në proces” si dhe “shoqëritë pa licencë” janë mos plotësimi i kërkesave në zbatim të VKM nr. 958, për licencimin e operatorëve nga ERRU në fushën e ujësjellës kanalizimeve, dhe përkatësisht për:

- **Marrjen e akt-miratimit higjiëno-sanitar**, nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Kjo ka ardhur kryesisht sepse shoqëritë kanë zgjeruar zonën e shërbimit me zona shtesë rurale që kanë asete mjaft të amortizuara të sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe shoqëritë e reja të krijuara rishtas në sektor, përkatësisht Patos, Pustec dhe Kamëz;
- **Krijimi i shoqërisë Aksionare**, për UK Klos e cila akoma vazhdon të operojë si ndërmarrje pranë bashkisë dhe jo në zbatim të kërkesave të VKM nr. 63.
- **Përditësimi i QKB-së**, për UK Divjakë si rezultat e neglizhencës nga ana e saj.

ERRU edhe gjatë vitit 2021 ka vijuar përpjekjet e saj në drejtim të nevojës për rishikimin e akteve dhe nënakteve ligjore përkatëse për përfundimin e Akt Miratimit Higjiëno Sanitar dhe i është drejtuar përsëri me shkresën nr.366 prot, datë 06.10.2021, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për ngritjen e grupit të punës me institucionet përgjegjëse për këtë çështje. Në të njëjtën kohë ERRU ka zhvilluar takime me Drejtorin e Programit të Ujit të GIZ, në lidhje me asistencën e nevojshme që mund të kërkohej për përmirësimet e mësipërme, nga ku është marrë premtimi për të përfshirë në buxhetin e vitit 2022 të GIZ fondet e nevojshme për asistencën e kërkuar.

Situata e Licencimit Sipas Reformës

Reforma në sektorin e ujit e cila i ka fillimet e saj në janar 2016 në zbatim të VKM nr. 63, e cila parashikonte riorganizimin e shoqërive UK sipas parimit 1 shoqëri = 1 bashki, edhe pse tashmë kanë kaluar 6- vite nga miratimi i saj ende nuk është përfunduar nga të gjitha shoqëritë UK.

Riorganizimi i sektorit rezultoi një sfidë mjaft e madhe për shoqëritë dhe bashkitë për t'u realizuar në formën e kërkuar brenda afateve të përcaktuara në VKM. Procesi i inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit të aseteve dhe me pas regjistrimi i tyre në QKB paraqitej mjaft problematik, për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës nga ish komunat. Gjithashtu pajisja me Akt Miratime Higjieno Sanitare e përmendur dhe më sipër, ka qenë veçanërisht problem për shoqëritë UK pas riorganizimit si rezultat i shtimit në zonën e shërbimit të hapësirës administrative rurale.

Aktualisht shoqëritë UK operojnë dhe ofrojnë shërbimin në të gjithë zonën përkatëse administrative sipas ndarjes së re territoriale, por zyrtarisht nuk kanë arritur të plotësojnë kërkesat përkatëse ligjore për licencim. Procesi i riorganizimit parashikonte gjithashtu që brenda 3 muajve të licencimit për zonën e re të shërbimit shoqëritë duhet të aplikojnë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave të reja për të gjithë zonën e re të shërbimit. Natyrisht pengesat në procesin e licencimit sipas zonave të reja të shërbimit kanë sjellë pengesa edhe për aplikimet për tarifa të reja.

Në mbyllje të vitit 2021 rezulton se kanë përfunduar riorganizimin dhe janë licencuar nga ERRU sipas reformës 42 nga 58 shoqëri UK që operojnë në sektor, të cilat jepen në mënyrë të detajuar në (Aneks 1 tabela 3).

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka ndjekur dhe ka inkurajuar procesin e riorganizimit dhe të licencimit të të gjithë shoqërive UK në përputhje me riorganizimin e tyre sipas reformës. Në këtë kontekst, ERRU ka vazhduar takimet e drejtpërdrejta me shoqëritë dhe Kryetaret e bashkive përkatëse duke ofruar edhe asistencën e tij profesionale në këtë drejtim.

1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor

ERRU përcakton metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave të shitjes me shumicë e pakicë të ujit për konsum publik, tarifat për ujërat e përdorura dhe trajtimin e tyre, përcakton procedurat e standardet minimale kombëtare për vendosjen e tarifave si dhe afatet dhe kushtet e shërbimit për çdo veprimtari të ushtruar nga operatorët në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, bazuar në ligjin nr. 8102 datë 28.06.1998 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

Në aplikimet për tarifa, në përgjithësi propozohen tarifa të tilla që të ardhurat e gjeneruara të mbulojnë kostot operacionale, prandaj ERRU aplikon metodën "Kosto Plus" për periudha afatshkurtra.

Sipas raportimit të të dhënave të shoqërive UK dhe nga analiza e performancës së shoqërive është konstatuar se disa shoqëri synojnë të mbulojnë me të ardhurat edhe nevojat për investime, tarifat e së cilave kërkojnë një metodë me të avancuar (Çmimi Tavan) për miratimin e tarifave nga ERRU. Në këtë kuadër KKRR mori vendimin nr.18 datë 22.03.2018 "Për fillimin e procedurës për ndryshimin e Metodologjisë për vendosjen e tarifave", në përmbushje të nevojës për rregullim më efektiv të sektorit nëpërmjet tarifave të shërbimeve. Procesi i hartimit të metodologjisë së re të miratimit të tarifave

përfundoi në fund të vitit 2021, e cila u konkretizuar me vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”. Procesi i hartimit të metodologjisë së re është mbështetur nga asistenca e një eksperti ndërkombëtar i fushës, financuar nga Banka Botërore në kuadër të Programit të Danubit.

Duke filluar nga data 05.01.2022 të gjitha aplikimet për tarifa do të rregullohen nëpërmjet kësaj metodologjie të re, e cila konsiston në dy metoda të përcaktimit të tarifave, metoda “Kosto Plus” për shoqëritë që mbulojnë deri në 100% kostot operationale dhe metoda “Çmimi Tavan” për shoqëritë që mbulojnë mbi 100% kostot operationale.

Objektivat kryesorë të metodës së re të përcaktimit të tarifave të shërbimeve të rregulluara të shoqërive UK në Shqipëri janë përcaktimi, përkufizimi dhe shpërndarja e kostove sipas shërbimeve, rregullimi i orientimit të tarifës fikse, rregullimi i normave të amortizimit, përcaktimi i të ardhurave të nevojshme, planifikimi i vëllimeve në bilancin e ujit, rregullimi i mbajtjes së një sistemi informacioni nga shoqëritë, monitorimi i treguesve kryesorë të performancës, përditësimi i tarifave nëpërmjet vlerësimit të performancës dhe efikasitetit të kostove me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe më pas vetëfinancimit të investimeve të nevojshme për shoqërinë, me fokus mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol.

Gjithsesi procesi tarifar dhe miratimi i tarifave, për të gjitha aplikimet për tarifa deri në mbyllje të vitit 2021, bazohet në vendimin nr.39 datë 09.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, në vendimet e KKRR, përkatësisht nr.40 datë 09.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, në vendimin nr.41 datë 09.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe në vendimin nr.42 datë 09.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”.

Në fillim të vitit 2021, ERRU ka njoftuar të gjitha shoqëritë e reja të cilat janë formuar si rezultat i vendimit nr. 63 datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” por edhe shoqëritë të cilat nuk kanë tarifa të miratuara, apo i ka mbaruar afati ose kanë tarifa të ndryshme për zona të ndryshme, të ndjekin procedurat e aplikimit për tarifa. Konstatohen 17 shoqëri UK të cilat kanë problematika me tarifat e shërbimeve të tyre. Gjatë vitit 2021, ERRU ka zhvilluar takime me shoqëritë UK dhe me kryetarët e Bashkive të secilës UK, në të cilat është theksuar detyrimi për të aplikuar vetëm tarifa të miratuara nga ERRU, si autoriteti i vetëm që miraton tarifat e shërbimeve UK. Si rezultat i këtyre takimeve, pothuaj të gjitha shoqëritë janë angazhuar për të filluar procedurat e aplikimit për tarifa, por në mbyllje të vitit vetëm tre shoqëri përkatësisht UK Mallakastër, Konispol dhe Kukës të cilat nuk kishin tarifa të miratuara nga ERRU, arritën të aplikojnë.

Përfundimisht gjatë vitit 2021 janë shqyrtuar pranë ERRU propozimet për tarifa të reja për 6 shoqëri UK, përkatësisht, UK Mallakastër, UK Patos, UK Sarandë, UK Konispol, UK Kukës dhe UK Bulqizë, dhe kanë përfunduar analizat e janë marrë vendimet përfundimtare për tarifat vetëm për shoqëritë UK Mallakastër, UK Patos, dhe UK Sarandë, që jepen në Tabelën 1. Për UK Mallakastër KKRR me 9 dhjetor

2021 mori projektvendimin për tarifën, që iu dërgua shoqërisë dhe bashkisë përkatëse për komente. Mbasi nuk kishte asnjë koment mbi këtë projektvendim, formalisht tarifën për UK Mallakastër u miratuan me 17 janar 2022.

Tabela 1 . Shoqëritë për të cilat KKRR ka marrë vendimet për ndryshimin e tarifave

Nr.	Operatori	Numri i Vendimit të KKRR	Data e Vendimit
1	UK Patos	53	04.02.2021
2	UK Sarandë	205	28.05.2021
3	UK Mallakastër	477	9.12.2021 (projekt-vendim) 17.01.2022 (vendim)

Për aplikimet e shoqërive UK Konispol, UK Kukës dhe UK Bulqizë, duke parë problematikat që paraqesin në drejtim të mosplotësimit plotësisht të dokumentacionit të tyre, vetëm në fund të vitit 2021 u arrit plotësimi korrekt i tyre dhe u mor vendimi përkatës nga KKRR për fillimin e procedurës për tarifa. Tabela 2 jep shoqëritë për të cilat është marrë vendimi nga KKRR për fillimin e procedurës për tarifa.

Tabela 2. Shoqëritë për të cilat KKRR ka marrë vendimet për fillimin e procedurës për tarifa

Nr.	Operatori	Numri i Vendimit të KKRR	Data e Vendimit për fillimin e procedurës tarifore
1	UK Konispol	536	30.12.2021
2	UK Kukës	537	30.12.2021
3	UK Bulqizë	538	30.12.2021

Motivi kryesor i aplikimeve për tarifa të reja nga shoqëritë e mësipërme ka qenë:

- Përmbushja e detyrimit ligjor për shoqëritë UK për të aplikuar për tarifa të reja sipas pikës 3, kreu II, VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", nga nevoja për unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit të tyre, duke qenë se aplikohen tarifa të ndryshme për zona të ndryshme të shërbimit.
- Përmbushja e detyrimit ligjor për shoqëritë UK për të aplikuar tarifa të miratuara nga ERRU, në përputhje me nenin 14 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si autoritet i vetëm që miraton tarifën e shërbimeve UK.
- Aplikimi për tarifa të reja për të rritur qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, në përputhje me nenin 22, Ligji nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", për mbulimin 100% të kostove operacionale.
- Aplikim të tarifa të reja për të përmirësuar situatën financiare, për mbulimin mbi 100% të kostove operacionale me qëllim përmirësimin e shërbimit të ofruar, mirëmbajtjen e rrjetit, stacioneve të pompimit e makinerive si edhe për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucioneve të kredisë.

Detaje të aplikimeve të mësipërme jepen më poshtë:

UK Patos ka aplikuar për herë të parë, në Tetor 2020, për të miratuar tarifat pranë ERRU-së. Kjo është një nga shoqëritë me performancën më të dobët financiare, si rezultat i kostove të larta, veçanërisht atyre të energjisë elektrike. Tarifat e reja të miratuara synojnë kryesisht përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërisë me 75% mbulimin e kostove operative, në mënyrë që UK Patos të fillojë të paguajë një pjesë të kostove të energjisë elektrike, pasi me të ardhurat e saj shoqëria nuk mbulonte as 1/4 e kostove operative. ERRU miratoi edhe tarifat e kanalizimeve të ujërave të ndotura, shërbime që më parë ofroheshin dhe financoheshin direkt nga bashkia Patos.

UK Sarandë ka aplikuar për herë të parë pas riorganizimit, në Dhjetor 2020, për tarifa të reja dhe të unifikuara për të dyja zonat Ksamil dhe Sarandë. ERRU miratoi tarifat fikse dhe volumetrike për të dyja shërbimet si dhe tarifën e shitjes së ujit me shumicë për UK Finiq. Tarifat e reja të miratuara synojnë përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimin 100% të kostove operacionale, kostove të interesave dhe një pjesë të kostove të amortizimit.

UK Mallakastër ka aplikuar në Korrik 2021, për të miratuar tarifa për herë të parë pasi kjo shoqëri ka patur probleme për t'u licencuar ndër vite. Me tarifat e reja të miratuara synohet aplikimi i tarifave të rregulluara nga ERRU, si autoritet i vetëm që miraton tarifat e shërbimeve UK si dhe përmirësimi i gjendjes financiare të shoqërisë nëpërmjet reduktimit të kostove të punës duke arritur mbulimin me 61% të kostove operacionale.

ERRU analizon veçmas kostot e secilit shërbim, në mënyrë që të llogarisë nevojën për të ardhura dhe të orientojë tarifat drejt kostove të shërbimeve përkatëse dhe gjithashtu vlerëson performancën aktuale dhe të pritshme të këtyre shoqërive, duke përcaktuar dhe objektiva për të ardhmen. Monitorimi i tarifave të miratuara është pjesë e vijimit të punës nga ERRU.

Gjatë analizës së propozimeve për tarifa të reja, konstatohen probleme lidhur me raportimin e të dhënave kryesisht për numrin e lidhjeve, sasitë e prodhuara, të faturuara dhe të humbura të ujit, për sasitë e energjisë elektrike të konsumuar etj., të cilat zgjasin procesin tarifar pasi duhen verifikuar dhe saktësuar për të përfunduar një analizë të plotë të situatës teknike dhe ekonomike të shoqërisë. Pasaktësitë në raportimin e të dhënave pritet të minimizohen sepse në metodologjinë e re janë përcaktuar udhëzimet për mbajtjen e një sistemi informacioni për të dhënat që shoqëria duhet të krijojë dhe të mirëmbajë, nëpërmjet së cilës do të vlerësohet cilësia e të dhënave të raportuara.

Për mbrojtjen e klientëve nga tarifat e larta dhe të pajustificuara, në analizën dhe vendimmarrjen për tarifa të reja vlerësohet kriteri i përballueshmërisë së faturës së llogaritur për shërbimet e ofruara për konsumatorët familjarë. Fatura e llogaritur me tarifat e miratuara nga ERRU nuk e kalon nivelin prej 5% të shpenzimeve mujore të Njësisë Ekonomike Familjare (NJEF), që INSTAT publikon në dokumentin "Anketa e Buxhetit të familjes për vitin 2020" e publikuar në vitin 2021 për të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë.

Duke qenë se në dokumentin e publikuar nga INSTAT nuk jepet informacion mbi shpërndarjen e decileve të konsumit për secilin qark, ERRU në kuadër të ndryshimit të metodologjisë me qëllim përmirësimin e këtij kriteri dhe mbrojtjes së familjeve në nevojë, ka kërkuar nga INSTAT këtë informacion. INSTAT e ka dhënë këtë informacion në rang vendi dhe jo sipas qarqeve për shkak të

ndryshimeve të metodës së mbledhjeve të të dhënave në vitin 2018, të cilat sipas tyre kërkojnë të paktën një periudhë 3 vjeçare për të prodhuar të dhëna në nivele më të detajuara. Në metodologjinë e re mundësohet furnizimi falas deri në një normë konsumi të përcaktuar për klientët familjarë të konsideruar me status me “ndihmë ekonomike”. Për të gjithë klientët e tjerë familjarë, kriteri i përballueshmërisë do të llogaritet në të njëjtën mënyrë me kufi 5% por mbi bazën e 90 % të shpenzimeve mesatare të NJEF duke përjashtuar 10% me shpenzime më të larta të publikuara nga INSTAT (familjet e pasura). Në rast se INSTAT nuk e ka këtë informacion llogaritja do të bëhet mbi shpenzimet mesatare mujore për konsum të NJEF të mëparshme sipas qarqeve.

Tendenca e ndryshimit të tarifave për shërbimet FU dhe KUN ka ardhur në rritje për shkak se kostot janë shumë më të larta krahasuar me të ardhurat, por edhe sepse fatura mujore për familje me konsum mesatar 12 m³ në muaj për të gjithë sektorin UK përmban ende rezerva në drejtim të përballueshmërisë së pagesës së saj nga konsumatorët familjarë.

Të gjitha projektvendimet për miratimin e tarifave përpara se të marrin formë përfundimtare nga ERRU, dërgohen për konsultim tek Shoqëritë dhe Bashkitë përkatëse, si edhe te Autoriteti i Konkurrencës, të cilët mund ta komentojnë apo të dakordësohen me të.

Zbatimi i metodës së re të vendosjes së tarifave do të nxisë arritjen e objektivave me kosto efektive, pasi do të përcaktohen tarifa me afat nëpërmjet periudhës rregullore bazuar detyrimisht në një Plan Biznesi 5 Vjeçar, dhe do të ketë monitorim të të dhënave të planifikuara çdo vit, rezultati i të cilave do të ketë ndikim në tarifë.

Megjithatë duhet të vazhdohet mbështetja e shoqërive me subvencione nga qeveria qendrore deri sa gradualisht nëpërmjet kostove efektive dhe planifikimit afatgjatë të arrihet të mbulohen me të ardhura të gjitha kostot operationale në sektorin UK.

1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore

Gjatë vitit 2021 Enti Rregullator i Ujit ishte palë në 6 (gjashtë) procese gjyqësore nga të cilat 5 (pesë) procese gjyqësore të iniciuara nga vetë ERRU me objekt shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të pagesës rregullore nga ana e shoqërive ujësjellës kanalizime.

Aktualisht çështjet gjyqësore janë në fazat si më poshtë:

1. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Skrapar sh.a

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Skrapar sh.a

Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Skrapar” sh.a. të shlyejë shumën prej 266 917 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje u gjykua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila me vendimin nr. 5754, datë 09.09.2021 vendosi miratimin e marrëveshjes së arritur mes ERRU dhe UK Skrapar për shlyerjen e detyrimit objekt të padisë me këste për një afat 2 vjeçar.

2. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a

Palë paditëse:	Enti Rregullator i Ujit
Palë e paditur:	Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a
Objekti:	Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Elbasan” sh.a. të shlyejë shumën 4 854 000 (katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë) lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Shoqëria UK Elbasan ka shlyer vullnetarisht para zhvillimit të seancës gjyqësore shumën prej 4 854 000 (katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë) lekë. Kjo çështje është pushuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas kërkesës së bërë nga pala paditëse Enti Rregullator të Ujit.

3. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Devoll sh.a

Palë paditëse:	Enti Rregullator i Ujit
Palë e paditur:	Ujësjiellës Kanalizime Devoll sh.a
Objekti:	Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Devoll” sh.a. të shlyejë shumën 233 100 (dyqind e tridhjetë e tre mijë) lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Shoqëria UK Devoll ka shlyer vullnetarisht para zhvillimit të seancës gjyqësore shumën prej 233 100 (dyqind e tridhjetë e tre mijë) lekë. Kjo çështje është pushuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 4387, datë 22.06.2021 sipas kërkesës së bërë nga pala paditëse Enti Rregullator të Ujit.

4. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Pukë sh.a

Palë paditëse:	Enti Rregullator i Ujit
Palë e paditur:	Ujësjiellës Kanalizime Pukë sh.a
Objekti:	Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Pukë” sh.a. të shlyejë shumën 425 000 (katërqind e njëzet e pesë mijë) lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është shqyrtuar nga ana e Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka pranuar marrëveshjen e arritur mes palëve për shlyerjen e detyrimit objekt të padisë me këste, por ende nuk është zbardhur vendimi përfundimtar.

5. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Mirditë sh.a

Palë paditëse:	Enti Rregullator i Ujit
Palë e paditur:	Ujësjiellës Kanalizime Mirditë sh.a
Objekti:	Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Mirditë” sh.a. të shlyejë shumën 108 325 (njëqind e tetë e treqind e njëzet e pesë mijë) lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është duke u shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Luena Brekofca - Enti Rregullator i Ujit

Palë Paditëse: Luena Brekofca

Palë e Paditur: Enti Rregullator i Ujit

Objekti:

1. Shfuqizim i vendimit nr.15, datë 25.03.2019 “Për zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës”;
2. Detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblimin me 12 muaj pagë pune, për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
3. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 3 muajve për mos respektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
4. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 2 muajve për mos respektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
5. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e një 15 ditëshi për çdo vit vjetërsi në punë, konkretisht 9 vjet vjetërsi në punë, e barabartë me 4 paga e gjysmë shpërblim, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;

Kjo çështje është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesë – padisë. Ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ende nuk e ka shqyrtuar çështjen.

1.4.4 Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve

Trajtimi i ankesave të konsumatorëve të drejtuar pranë ERRU-së vijon të jetë në fokusin e punës së rregullatorit për të garantuar cilësinë dhe përmirësimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Gjithashtu nëpërmjet shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, rregullatori evidenton problematikat që kanë shoqëritë UK në lidhje me ofrimin e shërbimit dhe jep rekomandimet e duhura në drejtim të përmirësimit të menaxhimit dhe respektimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjatë vitit 2021, pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorit janë depozituar 14 ankesa nga konsumatorë familjarë ku 9 prej tyre ju janë drejtuar shoqërive UK dhe kanë vendosur ERRU-në “*për dijeni*” për ankesën e tyre. Edhe për këto lloj ankesa, ERRU ka vijuar trajtimin e ankesave duke ndjekur procedurat e komunikimit zyrtar me shoqëritë UK. Natyra e ankesave edhe këtë vit ka qenë në tre kategori, përkatësisht:

- zbatueshmëria e kushteve të kontratës për shërbime ujësjellës kanalizime;
- cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK;
- faturimi aforfe.

E veçanta e këtij viti, ka qenë trajtimi i një ankese problematike të një konsumatori familjar me verifikim në terren dhe takim të përbashkët Konsumator - Rregullator - Shoqëri UK, duke gjetur një zgjidhje të kënaqshme për të dyja palët. Angazhime të tilla, sidomos për ankesat që vijnë në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit UK, do vijohen të ndiqen edhe në të ardhmen nga ERRU për të qenë sa

më afër konsumatorit. Referuar tabelës 3 së mëposhtme, nga totali i të gjithë ankesave, 5 prej tyre kanë pasur një zgjidhje përfundimtare dhe të kënaqshme në favor të konsumatorit.

Tabela 3. Ankesat e trajtuara nga ERRU gjatë vitit 2021

Nr.	Objekti i Ankesës	Nr. Ankesave	Nr. Ankesave të Zgjidhura
1.	Faturimi Aforfe	3	1
2.	Zbatueshmëria e Kushteve të Kontratës	5	1
3.	Cilësia e shërbimit	6	3
TOTALI		14	5

Ndërgjegjësimi dhe nevoja për marrjen e një shërbimi UK në sasinë dhe cilësinë e duhur ka ndikuar vit pas viti në shtimin e numrit të ankesave me objekt *“cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK”*. Objektet e ankimit të këtyre lloj ankesave kanë qenë të fokusuara në probleme teknike për të cilat shoqëritë UK nuk kanë dhënë një zgjidhje përfundimtare apo për cilësinë e ujit të pijshëm. Këto lloj ankesash kanë gjetur një zgjidhje të kënaqshme dhe të favorshme për konsumatorët të cilët i janë drejtuar ERRU-së.

“Respektimi dhe zbatueshmëria e të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në kontratën për shërbime ujësjellës kanalizime” ka qenë objekt ankimi për pesë ankesa të tjera të ardhura pranë ERRU-së. Kontrata për shërbime ujësjellës kanalizime përcakton të drejtat dhe detyrimet e marrëdhënies konsumator - shoqëri UK ndaj respektimi i tyre është kusht kryesor për sigurimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit.

Ankesat e paraqitura në ERRU me objekt *“anulim i faturimit aforfe”* kanë qenë më të pakta në krahasim me vitet e tjera. Megjithatë problematika ku shoqëritë UK nuk respektojnë normativat e miratuara në rastet e faturimit aforfe 4.5 m³/muaj/frymë për konsumatorët familjarë, duke faturuar kështu konsumatorët më shumë se konsumi mujor i tyre vazhdon të jetë evidente. Edhe për vitin 2021 ka vijuar bashkëpunimi shoqëruar me rekomandimet përkatëse me shoqëritë UK për të respektuar normativat e lejuara në raste të këtij lloj faturimi dhe për të gjetur një zgjidhje korrekte për këto lloj ankesash pa ju drejtuar gjykatave të rretheve gjyqësore.

Përveç ankesave të paraqitura në mënyrë zyrtare, ERRU ka vijuar komunikimin dhe ka ofruar asistencë me të gjithë konsumatorët që janë drejtuar ERRU-së nëpërmjet konsultimeve verbale, me e-mail apo telefon për zgjidhjen e problemeve të tyre lidhur me shërbimet UK.

Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve

Në zbatim të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 *“Për mbrojtjen e konsumatorëve”* i ndryshuar me ligjin nr. 71/2018, në përputhje me Direktivën 2013/11/EU mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve për mosmarrëveshjet konsumatore, por edhe në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi në Rezolutë për vitin 2021, Enti Rregullator i Ujit në Nëntor 2021 krijoi Strukturën e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes (SZAM) si struktura përgjegjëse brenda rregullatorit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorit dhe shoqërisë UK në sektorin ujësjellës kanalizime.

Në vijim, Komisioni Kombëtar Rregullator miratoi dhe rregulloren për procedurat që do të ndiqen për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjes midis konsumatorit dhe operatorit ujësjellës kanalizime nga kjo strukturë duke vendosur kështu një kuadër rregullator për trajtimin dhe zgjidhjen alternative të një mosmarrëveshje në lidhje me detyrimet kontraktuale midis një operatori UK dhe një konsumatori.

Monitorimi i Trajtimin të Ankesave

Në përmbushje të objektivit të ERRU-së për zhvillimin e një praktike të unifikuar monitorimi për trajtimin e ankesave në të gjitha shoqëritë UK me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit në këndvështrimin e së drejtës së tij për t'u ankuar nëpërmjet një procedure korrekte ligjore, ERRU gjatë vitit 2021 zhvilloi dy procese monitorimi pranë shoqërive UK Durrës dhe UK Elbasan mbi trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve drejtuar këtyre shoqërive.

Nisur nga eksperiencia e mëparshme, kontrolli rregullator u fokusua në mënyrën e organizimit të shoqërisë në drejtim të trajtimit të ankesave të konsumatorëve, respektimi i akteve ligjore dhe nënligjore si dhe evidentimi i problematikave që kanë shoqëritë në ofrimin e shërbimit UK.

Në përfundim të këtij monitorimi, u hartuan raportet finale ku u pasqyruan gjetjet dhe rekomandimet e ERRU-së mbi procesin e trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve.

Shoqërisë UK Durrës ju kërkua që të marrë masa për riorganizimin e strukturës organizative në drejtim të trajtimit të ankesave, hartimin e rregulloreve ku të përfshihen dhe qendërohet e gjithë zona e shërbimit për të gjitha procedurat për trajtimin e ankesave si dhe kategorizimin e tyre për të evidentuar problematikave që ka shoqëria në drejtim të shërbimit UK. Gjithashtu të merren masa për shmangien e informalitetit dhe dublimit të kontratave, instalimit të matësive të ujit aty ku ende nuk janë vendosur si edhe të mbahen në fokus për kompensim shtresat në nevojë në ato raste kur është bërë instalimi i tyre.

Shoqërisë UK Elbasan ju kërkua kategorizim më i detajuar i llojit të ankesave të konsumatorëve duke patur në vëmendje faturimin aforfe sipas normave të caktuara dhe duke ja drejtuar Departamentit të Shitjes të gjitha ankesat që vijnë në këtë shoqëri. Gjithashtu, shoqërisë ju rekomandua saktësimi i adresave të konsumatorëve debitorë për nxjerrjen e titujve ekzekutivë si dhe database-n e adresave të shtresave në nevojë.

1.4.5 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK

Në vijim të forcimit të rolit të tij monitorues për sektorin UK, iniciativë kjo e ndërmarrë tashmë që në vitin 2019 nga ERRU, ku për herë të parë Raporti Vjetor i Performancës së Sektorit UK u realizua me të dhënat e grumbulluara sipas formatit të data bazës së miratuar prej saj, edhe gjatë vitit 2021, i është kushtuar një rëndësi e veçantë monitorimit dhe vlerësimit të performancës së operatorëve të shërbimit UK dhe sektorit në tërësi. Kjo lidhet direkt me nevojën për të pasur një sektor financiarisht të qëndrueshëm, i cili ofron shërbime me cilësinë më të mirë të mundshme për konsumatorët.

Raporti Vjetor i Performancës së Sektorit UK i publikuar çdo vit nga ERRU jep rezultatet e monitorimit të shoqërive UK me qëllim transparencën për të gjithë aktorët e interesuar. Monitorimi jep mundësi për një vlerësim korrekt të performancës së çdo operatori dhe vendosjen e objektivave sfiduese dhe të arritshme shoqëruar me plane veprimi për arritjen e tyre.

Raporti i publikuar u shpërndahet të gjitha shoqërive UK dhe aktorëve kryesorë të sektorit ujësjellës kanalizimeve, si dhe është i disponueshëm në faqen e web-it të ERRU-së. Një formë e shkurtuar e tij është e disponueshme në gjuhën angleze po në këtë faqe web-i për të gjithë aktorët ndërkombëtarë që lidhen me sektorin, përfshirë dhe konsulentët e huaj.

Gjatë vitit 2021, ERRU ka intensifikuar punën e tij në drejtim të monitorimit të sektorit UK. Krahas monitorimit të të dhënave të grumbulluara nga shoqëritë UK dhe analizës së tyre janë realizuar edhe monitorime në terren me shoqëritë UK, si një praktikë e zakonshme e ERRU-së me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes së punës së shoqërive të licencuara. Pjesëmarrës gjatë monitorimeve të shoqërive UK kanë qenë edhe kryetarët e bashkive përkatëse, në rolin e pronarëve të shoqërive, me qëllim informimin në detaje mbi situatën dhe performancën e shoqërisë për të cilën janë përgjegjës.

Vëmendja e shtuar nga ana e ERRU-së në drejtim të monitorimit të shoqërive UK shprehet nëpërmjet numrit të lartë të vizitave që janë zhvilluar gjatë vitit 2021. *Konkretisht janë realizuar vizita monitorimi në 35 shoqëri UK, përkatësisht Tiranë, Shkodër, Malësi e Madhe, Lezhë, Kurbin, Durrës, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Has, Elbasan, Tepelenë, Memaliaj, Bulqizë, Klos, Burrel, Kavajë, Peqin, Belsh, Cërrik, Konispol, Kamëz, Mallakastër, Pogradec, Patos, Krujë, Finiq, Mirditë, Gramsh, Vorë, Berat – Kuçovë, Ura Vajgurore, Roskovec, Fier dhe Lushnjë.* Pjesa e mbetur prej 23 shoqërish do të jetë subjekt monitorimi gjatë vitit 2022, pasi për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 dhe në disa raste të agjendave të palëve, nuk ka qenë i mundur realizimi i monitorimit gjatë këtij viti.

Monitorimet e zhvilluara u fokusuan në këto drejtime:

- Zbatimi i ligjit të ERRU-së nr.8102 (vlefshmëria e licencës, tarifat e aplikuara dhe pagesa rregullatore);
- Krahasimi i performancës së shoqërive gjatë dy viteve të fundit (përmirësimet apo përkeqësimet e saj);
- Identifikimi i problematikave të hasura, (pengesat në përmirësimin e performancës së tyre);
- Situata financiare (nevoja për përmirësimin e performancës financiare)
- Saktësia e të dhënave (nevoja për raportime të sakta)

Konkretisht saktësia e të dhënave konsiderohet si një nga problematikat kryesore që ka sektori UK. Për këtë arsye, ERRU, theksoi edhe në prezencë të kryetarëve të bashkive vëmendjen që i duhet kushtuar nga ana e stafeve drejtuese të shoqërive raportimit të të dhënave të deklaruara pranë ERRU-së si dhe institucioneve të tjera, në mënyrë që ato të jenë të njëjta dhe reale për secilën palë të interesuar.

Pasaktësia e të dhënave të raportuara influencon në drejtim të konkluzioneve të gabuara gjatë analizës së performancës që i bëhet shoqërive UK çdo vit, e cila publikohet edhe në raportin e performancës së sektorit UK. Saktësia e këtij raporti ka një rëndësi të veçantë, pasi shpesh herë të dhënat e dala prej tij shërbejnë si referencë për institucionet e tjera shtetërore, të huaja, donatorët, mediat si dhe publikun e gjerë.

ERRU do të vijojë të jetë proaktive me të njëjtin intensitet në monitorimin e shoqërive UK edhe gjatë vitit 2022, duke e rritur nivelin e kërkesës ndaj tyre, në mënyrë që të arrijmë të kemi shoqëri të shëndosha financiarisht dhe të afta për të ofruar shërbim sa më cilësor ndaj konsumatorëve.

1.4.6 Përmirësimi i Standardeve në Sektorin UK nëpërmjet Instrumenteve Rregullatore

ERRU edhe gjatë vitit 2021 bazuar në kompetencat e KKRR dhe funksioneve të tij të parashikuara në ligj, ka vijuar me punën për të përmirësuar instrumentet rregullatore që lidhen kryesisht me aplikimin për ndryshimin e tarifave, efikasitetin operacionale të shoqërive si dhe përmirësimeve në drejtim të trajtimit të ankesave të konsumatorëve. Në këtë kuadër ERRU ka rishikuar dokumentet e mëposhtme:

“Metodologjia e Vendosjes së Tarifave” Komisioni Kombëtar Rregulator me vendimin Nr.539, datë 30.12.2021 miratoi dokumentin “Metodologjia dhe procedura për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve”, dokument ky i lënë për detyrë edhe në rezolutën e miratuar nga Kuvendi për ERRU-në në vitin 2021. Nisur nga rëndësia e këtij dokumenti theksojmë se hartimi i tij u realizua edhe me ndihmën e një eksperti ndërkombëtar të fushës, financuar nga Banka Botërore në kuadër të Programit të Danubit duke marrë në konsideratë praktikën më të mira rregullatore të Europës të përshtatura më tej me nevojat e sektorit UK në vendin tonë.

Metodologjia e rishikuar e tarifave përmban dy metoda të llogaritjes së tarifave, atë ekzistuese të rishikuar “Kosto-Plus” e cila do të vazhdojë të përdoret për shoqëritë UK që propozojnë rritje tarifash deri në mbulimin 100% të kostove të O&M, dhe ajo e “Çmimit Tavan”, e cila aplikohet për tarifa të propozuara për shoqëritë me target mbulimin deri 100% të Kostove Kapitale të aktivitetit. Metodologjia sipas “Çmimit Tavan”, kërkon që shoqëritë të aplikojnë për tarifa të reja detyrimisht bazuar në një Plan Biznesi 5 vjeçar. ERRU përcakton planin tarifor dhe objektivat për periudhën rregullatore 5 vjeçare gjatë së cilës shoqëria do të jetë në monitorim të vazhdueshëm. Në fund të çdo viti ERRU do të përditësojë tarifat e tyre, sipas nivelit të performancës dhe efektivitetit të kostos që shoqëria ka arritur për një vit, dhe këto tarifa do të hyjnë në fuqi për vitin e ardhshëm.

Në të njëjtën kohë ERRU, inkurajon që të gjitha shoqëritë të aplikojnë për tarifa të reja bazuar në një Plan Biznesi 5 Vjeçar sepse edhe për këtë kategori shoqëri ERRU do të aprovojë një periudhë rregullatore me objektiva përkatëse për më shumë se një vit.

“Struktura e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes” Në zbatim të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, në përputhje me Direktivën 2013/11/EU mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve për mosmarrëveshjet konsumatore, por edhe në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi në Rezolutë për vitin 2021, Enti Rregulator i Ujit me vendimin nr. 450, datë 23.11.2021, “Për krijimin e strukturës së zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes (SZAM)” miratoi krijimin e SZAM pranë ERRU, si struktura përgjegjëse brenda rregullatorit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorit dhe shoqërisë UK në sektorin ujësjellës kanalizime.

Me vendimin nr. 478, datë 09.12.2021 “Për miratimin e aktit normativ administrativ “Rregullore për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes midis konsumatorit dhe operatorit ujësjellës kanalizime nga Struktura e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes”, miratoi rregulloren mbi të cilën do të zhvillojë veprimtarinë SZAM.

“Studimi mbi Problematikën e Mbulimit të Kostove të Energjisë për Shoqëritë UK” është realizuar gjatë vitit 2021 nga ERRU, i cili është prezantuar dhe në Konferencën Ballkanike Vjetore për Ujin të zhvilluar nga SHUKALB dhe SHUKOS në Nëntor 2021 përmes platformës online ZOOM.

Qëllimi i këtij studimi ishte evidentimi i gjendjes së shoqërive UK me nivel debie të konsiderueshme ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), analiza e faktorëve që kanë ndikuar në akumulimin e kësaj debie, si dhe dhënia e rekomandimeve për mundësinë e shlyerjes së tyre.

Nëpërmjet të dhënave të raportuara nga OSHEE dhe nga Shoqëritë e Sektorit UK në Shqipëri, ERRU analizoi qasjen mbi mundësitë për zgjidhjen e kësaj problematike të krijuar ndër vite janë, përkatësisht: rritja e efijencës së përdorimit të energjisë elektrike dhe e treguesve të performancës në tërësi për shoqëritë UK, Plan i ri tarifor për shërbimet Ujës-jellës - Kanalizime që shoqëritë ofrojnë, Subvencionimi pjesërisht/plotësisht nga buxheti i shtetit dhe ulja e tarifës së energjisë elektrike për shoqëritë, por që kjo e fundit u përjashtua si mundësi duke patur parasysh momentin e krizës energjitike globale dhe në rajon.

Duke qenë se janë 7 Shoqëri UK që përbëjnë rreth 70% të detyrimit total për energjinë elektrike, në këtë studim u analizuan mundësitë për përmirësimin e performancës financiare për secilën prej tyre, duke propozuar rritjen e efijencës së përdorimit të energjisë elektrike dhe performancës në tërësi nëpërmjet një kontrate performance, me fokusin në treguesit e Ujit Pa të Ardhura, Norma Korrente e Arkëtitimit dhe Efijenca e Stafit; përditësimi i Planit të Biznesit 5-vjeçar të shoqërive, duke synuar mbulimin 100% të kostove O&M; lidhja e një kontrate ndërmjet shoqërive dhe OSHEE për likuidimin e debive të akumuluar (duke përfshirë dhe kamatë-vonesat), të shtrirë në kohë bazuar në terma të dakordësisë së dyanshme, si dhe kryerja e investimeve që do të ndihmojnë në përmirësimin e TKP-ve të këtyre shoqërive.

1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së

Në funksion të rolit të tij rregullator, ERRU ka intensifikuar bashkëpunimet me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare drejt përmbushjes së misionit për krijimin e një mjedisi që siguron stabilitet për kompanitë e licencuara dhe shërbim më të mirë për konsumatorët si një aktor kyç në sektorin e ujit.

1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare

1.5.1.1 Me Kuvendin e Shqipërisë

Marrëdhënia me institucionin legjislativ në vend nuk kufizohet vetëm në raportimin e përvitshëm të punës institucionale në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, por edhe me komunikimin periodik, përmes takimeve të organizuara si dhe me raportimin e vazhdueshëm mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve që Kuvendi jep në rezolutë çdo vit.

1.5.1.2 Me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

ERRU në zbatim dhe të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit, ka vijuar bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në drejtim të rregullimit të shërbimit që ofrojnë shoqëritë UK, ku më kryesori është zgjidhja e problemit për mos miratimin dhe mos pajisjen me aktin higjieno-sanitar për të gjithë zonat e shërbimit nga ana e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) që duhet të plotësojnë shoqëritë me qëllim për t'u licencuar nga ERRU.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme edhe gjatë vitit 2021 ka propozuar ngritjen e një grupi pune për rishikimin e akteve ligjore me përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

1.5.1.3 Me Autoritetin e Konkurrencës

Në vijim të zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me Autoritetin e Konkurrencës, ERRU edhe përgjatë vitit 2021 ka vijuar bashkëpunimin me këtë institucion me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive dhe garantimin e mbrojtjes së interesave publike në sektorin e ujit. ERRU ka kërkuar vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për 3 projektvendime për miratimin e nivelit të ri tarifor për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura, konkretisht për shoqëritë UK Sarandë, UK Patos dhe UK Mallakastër.

1.5.1.4 Me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)

Në zbatim të reformës për menaxhimin e integruar të ujit në Shqipëri, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) ka bashkëpunuar me Entin Rregullator të Ujit, si një aktor me rëndësi në këtë fushë. ERRU ka qenë pjesë e procesit të konsultimit ndërinstitucional për kuadrin ligjor dhe draft raporteve të menaxhimit të baseneve lumore në përputhje me kërkesat ligjore të BE-së si dhe ka marrë pjesë në konferencën Kombëtare të AMBU, në kuadër të zbatimit të një projekti të bashkë financuar me Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim (ADA) dhe Bashkimin Evropian për rritjen e kapaciteteve teknike në menaxhimin e burimeve ujore.

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr.157, datë 22.10.2018 *“Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”* ERRU ka marrë pjesë në takimet e zhvilluara online nga AMBU, nëpërmjet platformës zoom, si anëtare e grupit tematik “Burimet ujore”, për grupin e Punës për Menaxhimin e Integruar të Politikave. Takimet janë fokusuar tek puna në zbatim të kuadrit ligjor për menaxhimin e burimeve ujore, duke filluar nëpërmjet Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore (PMBU). Fillimisht u startua me PMBU Drin-Bunë dhe Seman, me caktimin e detyrave të institucioneve përgjegjëse.

Gjithashtu, në kuadër dhe të asistencës IPA III, është përgatitur dokumenti i Veprimit për Sektorin e Ujit që ka të bëjë me forcimin e sistemit të monitorimit dhe laboratorëve, kompletimi i kuadrit ligjor dhe përgatitja e dokumenteve strategjike, në zbatim të kërkesave të direktivave të BE. Bashkëpunimi me AMBU do të vijojë dhe në vitin 2022.

1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

Përgjatë vitit 2021 nuk kanë munguar aktivitetet me organizatat ndërkombëtare, duke marrë dhe shkëmbyer përvoja të reja. Duke qenë pjesë e shoqatave dhe rrjeteve rregullatore në fushën e ujit në mbarë botën, Enti Rregullator i Ujit ka konsoliduar pozitën e tij duke marrë pjesë në organizimet e tyre. Shumica e aktiviteteve janë mbajtur virtualisht në platforma të ndryshme për shkak të situatës së diktuar nga pandemia globale.

1.5.2.1 ERRU Anëtare e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare

Prej tetë vitesh, Enti Rregullator i Ujit është pjesë e Shoqatës Evropiane të Rregullatorëve (**WAREG**) si anëtar me të drejta të plota duke marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e bordit si edhe mbledhjet periodike të asambleve të WAREG të fokusuara në procesin e agregimit të shoqërive UK, direktivat e Bashkimit Evropian në drejtim të trajtimit të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura si dhe planin e aktiviteteve për vitin 2022.

Në 1 dhjetor 2021, WAREG zhvilloi Forumin e dytë evropian, “Për një Evropë të gjelbër” në të cilën kreu i ERRU, z. Ndrëçim Shani, njëherësh Zv. president i WAREG moderoi një panel kryesor që trajtoi sfidat e ujit me të cilat përballen sot vendet e Ballkanit Perëndimor dhe nevojat urgjente që duhet të përmbushin, si kusht për t’u anëtarësuar në bashkimin evropian, si dhe referoi në sesionin plenar ku u dhanë konkluzionet përfundimtare të forumit.

Në vijim të iniciativës së nisur që në 2020 nga Shoqata Ndërkombëtare e Ujit (**IWA**) për “Rregullimin e ofrimit të shërbimit gjithëpërfshirës për kanalizimet në qytete” ERRU, si pjesë e task forcës së rregullatorëve, është bërë pjesë e tryezave dhe aktiviteteve, qoftë online apo me prezencë fizike. Në muajin e parë të vitit 2021, ERRU ndoqi webinarin e fokusuar në mënyrën se si rregullatorët mund të mbështesin ofruesit e shërbimeve përmes qasjeve bashkëpunuese dhe stimujve me qëllim për të ofruar një shërbim cilësor dhe me çmim të përballueshëm për të gjithë konsumatorët. Në muajin korrik, Enti Rregullator i Ujit iu bashkua virtualisht Forumit të VI Ndërkombëtar të Rregullatorëve të Ujit, ndërsa në muajin nëntor ndoqi nga afër edhe një tjetër forum të IWA, i cili u mbajt në Beograd duke përcjellë problematikën dhe perspektivën e menaxhimit të aseteve të ujësllës kanalizimeve në vend.

ERRU ka bashkëpunuar ngushtë edhe me **Programin e Ujit për Rajonin e Danubit** duke u bërë pjesë në evente dhe konferenca të zhvilluara përmes platformave elektronike. E fundit ishte ajo në 18-20 nëntor 2021 që fokusohet në ndërtimin e një rajoni elastik dhe të sigurt në shërbimet e ujit, një program i menaxhuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Kompanive të shërbimeve të ujit (IAWD) dhe Banka Botërore si dhe financuar nga qeveria austriake.

ERRU gjatë vitit 2021 ndoqi gjithashtu takimin e radhës të Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë (**NER**) të krijuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim në Evropë (OECD), i cili u mbajt sërish online. Nga formësimi i rregullatorëve të së ardhmes, tema e këtij viti u fokusua në përmirësimin e performancës së vetë rregullatorëve. Korniza e vlerësimit që ka hartuar NER shqyrton institucionet, proceset dhe praktikatat që ndihmojnë rregullatorët të matin e vlerësojnë punën e tyre.

1.5.2.2 Bashkëpunimi me Donatorë dhe Aktorë Kombëtar dhe Ndërkombëtar

Një rëndësi të veçantë përgjatë vitit 2021 ERRU i ka kushtuar aktorëve e donatorëve të shumtë që japin kontributin e tyre në sektorin e ujit në Shqipëri. ERRU është ftuar në takimet që ata zhvillojnë për të diskutuar dhe shkëmbyer zhvillimet më të rëndësishme në sektor dhe për të përditësuar aktivitetet ose projektet e reja. Një prej tyre është ai i **GIZ** me programin “Shërbime të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime të Orientuara drejt Performancës dhe Konsumatorëve”, që definoi dy dokumente me rëndësi: agjendën kombëtare për rritjen e numrit lidhjeve me sistemin e ujërave të ndotura si dhe agjendën kombëtare për digjitalizimin e sektorit UK.

Po ashtu, ERRU është bërë pjesë e një tjetër projekti, “Programi kombëtar i modernizimit në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura”, i financuar nga Banka Botërore për asistencë

në fuqizimin institucional dhe investime fizike të konsiderueshme në sektor. Takimi me ERRU i paraprin fazës së paranegocimit përfundimtar që pritet të firmoset nga qeveria qendrore.

ERRU është gjithashtu pjesë e grupit të punës, në projektin e financuar nga Ambasada Suedeze “Planifikimi në sektorin e ujit për negociatat me BE-në” që ka si synim zhvillimin e kapaciteteve strategjike dhe planifikuese në sektorin e ujit për zbatimin e direktivave dhe standardeve me Bashkimin Evropian, ku vendi ynë synon të hapë së shpejti negociatat për t’u anëtarësuar. Duke patur parasysh rolin e rëndësishëm që ka ERRU në zhvillimin e kapaciteteve strategjike dhe planifikuese në sektorin e ujit, në kuadër të këtij projekti u organizua një tryezë së bashku me ekipin e konsulentëve të huaj në ambientet e ERRU-së, në të cilën u diskutuan dhe shkëmbyen mendime për realizimin sa më efikas të tij.

Një marrëdhënie të ngushtë, ERRU ka me shoqatën e ujësjellës kanalizime në Shqipëri (SHUKALB), e cila e ka bërë pjesë të aktiviteteve dhe takimeve konsultuese të orientuara drejt zhvillimit të kapaciteteve për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve. Në 3 nëntor 2021, SHUKALB dhe shoqata e ujësjellës kanalizime në Kosovë (SHUKOS) zhvilluan konferencën dhe ekspozitën e IX ballkanike “Vlera e ujit”, sesionin e parë të së cilës e moderoi kryetari i ERRU. Gjithashtu ERRU u prezantua në konferencë me një temë shumë të ndjeshme për sektorin **“Studimi mbi Problematikën e Mbulimit të Kostove të Energjisë për Shoqëritë UK”**. Pas evidentimit të sfidave në përmbushjen e kërkesës për ujë, në konferencë u insistua në rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimin e hershëm mbi vlerat e patjetërsueshme dhe të pazëvendësueshme të ujit.

1.5.2.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERRU-së

Në kuadrin e bashkëpunimeve me institucione homologe, në 24 maj të vitit 2021, Enti Rregullator i Ujit nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Komisionin Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe Energjisë në Maqedoninë e Veriut (ERC) duke hedhur kështu bazat e një bashkëpunimi afatgjatë në shkëmbimin e informacionit, praktikave të përbashkëta, analizave dhe modeleve ekzistuese rregullatore në sektorin e ujit. Kjo marrëveshje i shërben gjithashtu nevojës për bashkëpunim ndërkombëtar në çështje që lidhen me adaptimin me legjislacionin evropian të ujërave. Memorandumi i paraprin një tjetër bashkëpunimi që pritet të finalizohet në fillim të vitit 2022 duke u zgjeruar në një marrëveshje që përfshin përveç ERRU dhe ERC edhe autoritetet rregullatore për ujin në Kosovë dhe Mal të Zi.

Artikuj Studimorë, Botimet

Përgjatë vitit 2021, ERRU ka botuar disa artikuj, duke dhënë një panoramë të situatës ku ndodhet sektori i ujit, problematikat që ka aktualisht dhe sfidat që e presin.

Në muajin mars, me shkrimin “Roli i rregullatorit ekonomik në sektorin UK në Shqipëri” u botua në gazetën e përmuajshme të WAREG si dhe në buletin elektronik “Burimi” të SHUKALB, kryetari i ERRU, z. Ndrizim Shani trajtoi domosdoshmërinë e rregullatorit në një mjedis monopol shërbimesh, për të vendosur tarifa për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve, vendosjen e rregullave, monitoruar performancën e shoqërive dhe sektorit, si dhe për të diktuar standardet e shërbimeve dhe licencimin e shoqërive.

Ndërsa në buletin e muajit qershor të SHUKALB, z. Shani ka parashtruar në një shkrim të gjatë analizues dy alternativat e agregimit në sektorin UK, bashkë me efektet e pritshme, nëse aplikohet secila prej tyre.

Në fund të vitit, tek gazeta e përmuajshme e WAREG, z. Shani ka publikuar një shkrim mbi sfidën e trefishtë me të cilën po përballen vendet e Ballkanit Perëndimor në sektorin e ujit duke qenë se ato kanë disa ngjashmëri. Së pari, ofrimi i shërbimeve cilësore, përafrimi i legjislacionit me atë evropian si dhe ndryshimet klimatike, rënia e popullsisë e pasiguria ekonomike, të përkeqësuar së fundmi nga kriza energjetike.

1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median

Përgjatë 2021-ës, Enti Rregullator i Ujit ka rritur prezencën e institucionit në rrjete sociale dhe media, e veçanërisht atë online, përmes pasqyrit në portale online të aktiviteteve ku ERRU ka marrë pjesë. Po ashtu, kreu i Entit Rregullator të Ujit, Z. Ndiriçim Shani i është përgjigjur ftesës së televizioneve kombëtare për të folur mbi sfidat e sektorit dhe rolin e rregullatorit për përmirësimin e performancës së shoqërive aksionere dhe cilësinë e shërbimeve të ujit. Ndër çështjet kryesore që vijon të tërheqë vëmendjen e mediave është rritja e çmimit, për të cilën ERRU jep vendimin final, por vetëm pasi sigurohet se ajo është e justifikueshme dhe e përballueshme nga konsumatorët si edhe garantimi i shërbimit të duhur nga ana e shoqërive ujësjellës-kanalizime.

Faqja zyrtare e ERRU vijon të mbetet shtylla kryesore përmes të cilës përditësohen informacionet më të rëndësishme për qytetarët, nga vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator deri tek monitorimet e kryera në çdo shoqëri UK.

Gjithashtu, në vitin 2021, ERRU ka hapur rrjete të reja sociale, Twitter, Instagram dhe LinkedIn duke krijuar kanale të reja komunikimi, një urë lidhëse me shumë që ndihmon apo udhëzon qytetarët drejt zgjidhjes së problemeve që lidhen me ujërat.

Në përmbushje të një prej detyrave të lëna nga Kuvendi mbi promovimin e institucionit, por edhe ndërgjegjësimin të konsumatorëve për të drejtat e tyre, ERRU ka hapur një faqe të re në rrjetin social “Facebook”, gjerësisht të përdorshëm nga qytetarët. Institucioni ka rritur prezencën e saj me postime mbi aktivitetin e ERRU në terren, qoftë me monitorimet e shoqërive UK, dëgjuesat publike ashtu edhe me ndërmjetësimin e problematikave të lindura midis këtyre të fundit dhe qytetarëve.

Në funksion të ndërgjegjësimin të konsumatorëve për të drejtat e tyre si dhe rritjes së besimit tek ERRU-ja, institucioni së shpejti prezantohet me faqen e riformatuar të website, përmes të cilës konsumatorët kanë akses më të shpejtë e të lehtë në informacionin që iu nevojitet.

1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

1.7.1 Të Ardhurat

Pagesat rregullatore të operatorëve që operojnë në sektorin UK dhe pagesat për liçensimin e tyre përbëjnë burimin e vetëm të financimit në ERRU, sikurse përcaktohet në ligjin 8102 datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”. Enti Rregullator i Ujit ka nënshkruar kontrata me operatorët për aplikimin e tarifave të

miratuara, ku është përcaktuar pagesa rregullatore vjetore dhe afatet e likuidimit. Detyrimi vjetor i pagesave rregullatore për vitin 2021, mbështetur në kontratat me 42 shoqëri UK, është në shumën 53, 241, 805 lekë. Detyrimi për pagesë rregullatore i mbartur nga vitet paraardhëse është 54, 155, 825 lekë.

Arkëtimet totale të ERRU të realizuara gjatë vitit 2021 janë në shumën 60, 925, 444 lekë, nga të cilat 59, 495, 444 lekë janë pagesa rregullatore dhe 1, 430, 000 lekë janë tarifa licencimi detajuar më poshtë në Tabelën 3.

Tabela 4. Realizimi i Arkëtimeve Sipas Zërave

Nr.	Emërtimi i të Ardhurave	Vlera/ lekë
1	Nga pagesat rregullatore të prapambetura	28,546, 569
2	Nga pagesat rregullatore të vitit 2021	30, 948, 875
3	Nga pagesat e licencimit	1, 430, 000
Totali		60, 925, 444

Për mbledhjen e detyrimeve të papaguara në më shumë se dy vjet, shoqërive UK gjatë vitit 2021 u është kërkuar përmbushja e detyrimit si dhe janë nënshkruar aktmarrëveshje për lehtësimin e shlyerjes me këste të vazhdueshme. Disa shoqëri të cilat nuk kanë paguar vullnetarisht detyrimin sipas vendimit gjyqësor janë në proces të ekzekutimit të vendimit gjyqësor për mbledhjen e tij nga zyra e përmbarimit.

Shlyerja e detyrimeve të pagesës ndaj ERRU-së për licencimin ka qenë e rregullt si detyrim paraprak i shoqërive UK për t'u licencuar.

Likuiditetet në vitin 2021 garantojnë tërësisht mbështetjen financiare për ushtrimin e aktivitetit për vitin 2022 të Entit, duke mbuluar tërësisht shpenzimet e parashikuara vjetore.

1.7.2 Shpenzimet Operative


Administrimi i vlerave materiale e monetare në ERRU kryhet në përputhje të plotë me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" dhe rregullores së brendshme të ERRU "Për menaxhimin e aktiveve".

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së propozohet nga ajo vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së, për vitin 2021, është miratuar VKM nr. 872, datë 11.11.2020, "Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2021, për Entin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe është ndryshuar me VKM nr. 254 date 07.05.2021.

Fondi i miratuar për shpenzimet operative është 51, 919, 550 lekë. KKRR me vendimin nr. 13, datë 14.01.2021, ka detajuar planin vjetor të miratuar nga Këshilli i Ministrave në artikuj të shpenzimeve në përputhje me nevojat e domosdoshme për të garantuar mbështetjen logjistike për përmbushjen e objektivave vjetorë të ERRU-së, zhvillimin e veprimtarive të parashikuara dhe funksionimin normal të veprimtarisë së përditshme.

Plani vjetor është detajuar në katër zërat kryesorë: paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shërbime e furniturë dhe investime sipas raporteve në përqindje që paraqiten në Grafikon 2.



Grafiku 2. Struktura e Planit të Shpenzimeve Operative të Vitit 2021

Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të Entit gjatë vitit 2021, janë në shumën 42, 893, 161 lekë, ose 83 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative.


Faktet, derivat i diferencës së mosrealizimit të fondit të parashikuar janë:

- Mbyllja dhe kufizimi nga pandemia Covid-19 e cila ka ndikuar kryesisht në mosrealizimin e Shërbimeve dhe Furniturave në veçanti zëri Udhëtime dhe dieta jashtë vendit i cili zë 20% të fondit të parashikuar.
- Një vend vakant përgjatë gjysmës së parë të vitit 2021 që kanë ndikuar në mosrealizimin e zërit Fondi i Pagave dhe për rrjedhojë zërit Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Realizmi i shpenzimeve në zëra dhe në vlera paraqiten si më poshtë:

- 29, 78, 472 lekë / 94%, shpenzime për pagat e punonjësve;
- 5, 104, 134 lekë / 93% shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore;
- 7, 409, 645 lekë / 53% shpenzime për shërbime e furniturë;
- 591, 910 lekë / 86% shpenzime për investime.

Plani i miratuar i shpenzimeve operative të ERRU krahasuar me shpenzimet e realizuara paraqitet në vijim në Grafikon 3.



Grafiku 3. Plani i Shpenzimeve të Miratuara nga KM krahasuar me Shpenzimet e Realizuara

2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2021

Rezoluta e Kuvendit referuar Raportit të Aktivitetit të Entit Rregullator të Ujit, për vitin 2020 përcakton angazhimet në drejtim të institucionit të ERRU-së për vitin 2021, realizimi i të cilave cituar sipas numrit rendor që jepen në të, rezulton si më poshtë:

1. Të kryejë një analizë të detajuar të dokumentit të Bilancit të Ujit të shoqërive UK dhe kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja, të kërkojnë në mënyrë rigoroze objektivat e vëna nga ERRU-ja për këtë. Fakti që shumë shoqëri kanë nivel të mirë të Ujit Pa të Ardhura (UPA) tregon që realisht është e mundur që ky tregues të përmirësohet.

Reduktimi i Ujit Pa të Ardhura mbetet problem serioz për qëndrueshmërinë e shumë shoqërive UK në sektor. ERRU i kushton një rëndësi të veçantë këtij treguesi duke publikuar çdo vit Raportin Vjetor të Bilancit të Ujit për të gjitha shoqëritë UK, në të cilin paraqitet niveli i humbjeve për çdo shoqëri, arsyet që shkaktojnë këto humbje dhe masat që duhen marrë për reduktimin e humbjeve administrative dhe fizike, si për lidhjet e paligjshme, nën faturime edhe për abuzimet e ndryshme për ujitje etj. Raporti Vjetor i Bilancit të Ujit për Vitin 2020, u publikua në muajin gusht 2021, ju dërguar të gjitha shoqërive për njohje të situatës ku ndodhen dhe masat që duhet të marrin për të përmirësuar këtë tregues. Ky raport gjithashtu është publikuar edhe në faqen e web të ERRU.

ERRU për të shtatin vit radhazi vazhdon në mënyrë sistematike të rrisë kërkesën dhe të asistojë Shoqëritë UK për të hartuar një Bilanc Uji sa më real dhe të detajuar. Progresi në këtë drejtim nga ana e shoqërive UK është i dukshëm në këto vitet e fundit, por përsëri mbetet mjaft për tu bërë për përmirësimin e tij sepse elementë të veçantë të tij lidhen me investimet fizike në sisteme. Investimet kërkojnë kryesisht në rrjetet shpërndarëse për ujëmatës të mëdhenj e individuale, si dhe ndarjen e rrjetit shpërndarës në zona të veçanta të matura (DMA).

Në procesin e aplikimit për nivel të ri tarifor, ERRU e analizon në detaje, treguesin UPA si element kryesor i Bilancit të Ujit për vendosjen e objektivave reale dhe ambicioze për tu arritur nga shoqëritë. Kjo është reflektuar edhe në aplikimet e shoqërive UK Patos, UK Sarandë dhe UK Mallakastër që kanë aplikuar në vitin 2021 e cila jepet si më poshtë në tabelën 5.

Tabela 5. Treguesi i Ujit Pa të Ardhura

Nr.	Operatori	Treguesi i Vitit 2020 (në %)	Propozimi i shoqërisë Viti 2022 (në %)	Objektivi i Vendosur nga ERRU Viti 2022 (në %)
1	UK Patos*	I pamundur për vlerësim për zonën e re të shërbimit	65.4	60
2	UK Sarandë*	52.8	51.1	48
3	UK Mallakastër	61.6	50.2	50.2

* Objektivi i propozuar për UK Patos dhe UK Sarandë është raportuar për vitin 2021 pasi këto shoqëri kanë aplikuar në fund të vitit 2020.

Referuar tabelës së mësipërme ERRU është treguar ambicioze në vendosjen e objektivit për UK Patos duke patur parasysh mundësitë reale që ka kjo shoqëri për rregullimin e këtij treguesi. Gjithashtu

ERRU, ka konsideruar të arritshëm objektivin 48% të UPA për shoqërinë UK Sarandë duke ju referuar planit të biznesit 2020-2024 të shoqërisë lidhur me këtë tregues për vitin 2022. Në rastin e UK Mallakastër është marrë në konsideratë objektivi i vetë shoqërisë pasi shoqëria ka parashikuar të ketë ulje të humbjeve administrative, teknike dhe të konsumit të autorizuar të pa faturuar e cila pritët të sjellë rritjen e sasisë së ujit të faturuar.

2. Të vijojë të jetë proaktive dhe të luajë një rol nxitës e ndërgjegjësues që të fillojë realizimi i 2-3 shembujve pilot të agregimit (bashkimit) të disa shoqërive UK në sektor, duke pasur parasysh avantazhin e ekonomisë së shkallës në përmirësimin e performancës së një sektori mjaft të fragmentarizuar me 57 shoqëri UK.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha raportet vjetore që publikon për sektorin, si dhe në takimet e ndryshme me aktorët e qeverisë qendrore dhe donatorët ka theksuar fort nevojën e agregimit të sektorit si një sektor mjaft i fragmentarizuar me 57 shoqëri UK ku në mbyllje të vitit 2021 vetëm 12 shoqëri kanë mbuluar mbi 100 % kostot O&M.

ERRU ka rekomanduar që procesi i agregimit të sektorit UK si avantazh i ekonomisë së shkallës duhet të bëhet sipas principit në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore duke synuar që fillimisht të bëhen 2-3 agregime të suksesshme. Më tej këto shembuj pozitivë do të shërbejnë si bazë për agregimin aty ku është e mundur për të gjithë sektorin.

Siç duket procesi i agregimit do të jetë pjesë e reformës për sektorin e ujit, por që akoma nuk ka një njoftim konkret nga ana e qeverisë qendrore për formën dhe detaje të tjera organizative, financiare dhe kohore për realizimin e saj.

3. Me gjithë përmirësimin e lehtë të treguesit "Eficienca e Stafit" gjatë vitit 2020, ERRU të vijojë të ketë prioritet të punës së saj kryerjen e një analize të thelluar të organigramës dhe numrit të stafit të shoqërive UK, duke justifikuar secilin pozicion të stafit të saj edhe me përshkrimin përkatës të punës, veçanërisht kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja.

Eficienca e stafit për 1000 lidhje është një tregues shumë i rëndësishëm i cili është një nga zërat me peshën kryesore në kostot e shoqërive UK. Ky tregues monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga ERRU sidomos gjatë procesit të analizës tekniko - ekonomike të shoqërive që aplikojnë për nivel të ri tarifar ku analizohen në mënyrë të detajuar kostot e punës të lidhura me të.

ERRU u kërkon shoqërive të paraqesin organikën e stafit me pozicionet e punës dhe pagat respektive me argumentet përkatëse në mënyrë që kjo të jetë sipas nevojave reale të shoqërisë dhe jo e mbingarkuar me staf, duke qenë se është i njohur fakti që shoqëritë UK janë të mbingarkuara me staf të punësuar në kritere jashtë nevojave reale dhe profesionalizimit të stimuluar nga politika. Në këtë kuadër, ERRU, gjatë analizës tekniko – ekonomike për tarifat e reja të propozuara nga shoqëritë, kur konstaton staf të mbingarkuar, vlerëson se kush janë kostot e justifikuara që lidhen me të, si dhe rekomandon reduktimin e tij, i cili reflektohet edhe në objektivin e këtij treguesi të vendosur nga ERRU për shoqëritë UK. Një gjë e tillë është ndjekur edhe në aplikimet e vitit 2021 për shoqëritë UK Patos, UK Sarandë dhe UK Mallakastër e cila jepet si më poshtë në tabelën 6.

Tabela 6. Treguesi i Efiçencës së Stafit për 1000 lidhje

Nr.	Operatori	Treguesi i Vitit 2020 (në %)	Propozimi i shoqërisë Viti 2022 (në %)	Objektivi i Vendosur nga ERRU Viti 2022 (në %)
1	UK Patos*	24.3	10.8	10.8
2	UK Sarandë*	5	5	5
3	UK Mallakastër	15.5	15	13.8

* Objektivi i propozuar për UK Patos dhe UK Sarandë është raportuar për vitin 2021 pasi këto shoqëri kanë aplikuar në fund të vitit 2020.

Nga tabela shihet se për shoqërinë UK Patos është parashikuar një përmirësim i dukshëm i efiçencës së stafit. Ndikimi vjen si rezultat i reduktimit të stafit me 15 punonjës më pak nga 145 në 130 si dhe i shtimit të numrit me 515 lidhje të reja furnizimi me ujë dhe 5,672 lidhje kanalizime të ujërave të ndotura, si shërbim i cili iu ofrohet këtyre klientëve për herë të parë. Për UK Sarandë treguesi ka mbetur i njëjtë me propozimin e shoqërisë duke qenë se shoqëria operon me 175 punonjës dhe ky numër është parashikuar të jetë i njëjtë për të gjithë vitet e parashikuara në Planin e Biznesit 2020-2024 të shoqërisë. Në lidhje me shoqërinë UK Mallakastër ERRU nuk ka marrë në konsideratë objektivin e parashikuar nga shoqëria për shkak se ky tregues ka një nivel performance të dobët bazuar në kufijtë e objektivave të vendosura nga ERRU për grupin e dytë të shoqërive ku dhe bën pjesë UK Mallakastër.

Gjithashtu një tjetër element i rritjes artificiale të numrit të punonjësve është garantimi i sigurisë së objekteve të sistemeve të furnizimit me ujë me roje, si objekte të rëndësisë së veçantë. ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka rekomanduar që të rishikohet legjislacioni për mundësi të tjera alternative teknike për garantimin e sigurisë së këtyre objekteve, si masa teknike përforcuese kundër aksesit në to, monitorimi në distancë i objekteve me kamera etj. Natyrisht kjo kërkon edhe alokimin e fondeve shtesë që shumë prej shoqërive nuk mund t'i përballojnë financiarisht.

4. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, gjatë vitit 2021, bazuar në monitorimin e kryer pranë shoqërisë UK Tiranë, të punojë për krijimin e një praktike standarde monitorimi për të gjitha shoqëritë UK me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit në këndvështrimin e së drejtës së tij për t'u ankuar nëpërmjet një procedure liqjore dhe trajtimi i këtyre ankesave të qejë një zgjidhje sa më të drejtë. Trajtimi i ankesave të konsumatorëve duhet të përfshihet nga ERRU-ja si bonus ose penalitet në vlerësimin e shoqërive UK.

Bazuar në praktikën e kryer pranë UK Tiranë për monitorimin e trajtimit dhe zgjidhjes të ankesave të konsumatorëve nga ana e shoqërisë UK, gjatë vitit 2021 ERRU ka krijuar një praktikë standarde monitorimi duke hartuar një program vjetor për monitorimin e shoqërive UK për trajtimin e ankesave të konsumatorëve. ERRU monitoroi veprimtarinë e dy shoqërive që janë edhe dy ndër shoqëritë UK më të mëdha në vend, UK Durrës dhe UK Elbasan.

Në metodologjinë e rishikuar të tarifave për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, është përfshirë në Treguesit Kryesorë të Performancës që ERRU vlerëson edhe treguesin e “Përmirësimit të Kënaqësisë ndaj Konsumatorëve” bazuar në “Ankesat e Klientëve” “Përgjigjet ndaj Ankesave të Klientëve” dhe “Zgjidhjet e Ankesave të Klientëve”, të cilat do të ndikojnë në përditësimin tarifor nëpërmjet dhënies së bonusit/penalitetit që nxisin shoqëritë për përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

5. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, me miratimin e VKM-së përkatëse në zbatim të ligjit nr.71/2018, të punojë për krijimin e strukturës përgjegjëse pranë ERRU-së për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) midis shoqërive UK dhe konsumatorëve, si një mundësi më shumë, si dhe një përmirësim të procedurave dhe efikasitetit të zgjidhjes së problematikave dhe ankesave të konsumatorëve.

Në zbatim të nenit 52/2, të ligjit Nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar dhe VKM- së Nr. 1089, datë 24.12.2020, Enti Rregullator i Ujit me vendimin nr. 395, datë 21.10.2021 ka miratuar Rregulloren për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes (ZAM) midis konsumatorit dhe operatorit ujësjellës-kanalizime nga struktura e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes.

6. Duke qenë se shoqëritë UK në rastet e faturimit aforfe vijojnë të mos respektojnë normativat e miratuara prej 4.5m3/muaj/frymë për konsumatorët familjarë, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, gjatë vitit 2021, ERRU-ja të marrë masat për t’u dhënë fund këtyre lloj praktikave jo të drejta të ndërmarra nga shoqëritë UK kundrejt konsumatorëve. Ankesat e konsumatorëve me objekt “anulim i faturimit aforfe” vijojnë të zënë numrin më të madh të ankesave.

ERRU e ka në mënyrë të vazhdueshme në fokus mbrojtjen e konsumatorit duke bërë përpjekjet maksimale për zgjidhjen e problematikave që ato kanë në drejtim të mbi faturimit kur nuk janë të pajisur me matës dhe faturohen aforfe mbi normën e konsumit prej 150 litra/ditë/person (4.5 m3/muaj/person) për klientët familjarë sipas Vendimit 102 datë 16.03.1992 “Për normat e përdorimit dhe çmimit të ujit të pijshëm në qytet dhe fshat”.

Një praktikë e tillë ndiqet edhe në aplikimet e shoqërive UK për nivel të ri tarifor ku rekomandohen për zbatimin e Vendimit 102 datë 16.03.1992. Gjithashtu ERRU rekomandon shoqëritë edhe për pajisjen me matës të të gjithë klientëve dhe sidomos në zonat rurale të cilët faturohen aforfe ndërkohë që ato mund të harxhojnë sasi të konsiderueshme uji për vadtje. Rekomandime të tilla ERRU i ka vendosur edhe në rastin e shoqërive UK Patos, UK Sarandë dhe UK Mallakastër të cilat kanë marrë tarifa të miratuara nga ERRU gjatë vitit 2021, si dhe ato që janë në proces vlerësimi, përkatësisht për shoqëritë UK Kukës, UK Bulqizë dhe UK Konispol.

Gjithsesi gjatë vitit 2021 pranë ERRU-së nuk ka patur asnjë ankesë nga konsumatorët në drejtim të abuzimit me faturimin aforfe.

7. Për eliminimin e problemeve të licencimit të shoqërive UK për plotësimin e kushteve të Akt Miratimit të lejes Higjieno - Sanitare dhe të inspektimeve që lidhen me to, në bashkëpunim me Inspektoratin Sanitar Shtetëror të merren masa për propozimin e ndryshimeve përkatëse ligjore. Theksojmë se ky shqetësim është kërkuar të adresohet në mënyrë të përsëritur edhe në rezolutat e mëparshme, por për shkak të situatës së pandemisë COVID -19 ky problem nuk është trajtuar në vitin 2020.

Për përmirësimin e të gjithë procesit të licencimit të shoqërive UK për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e ujit të pijshëm për popullsinë janë të nevojshme rishikimi dhe përmirësimet ligjore përkatëse që lidhen me lëshimin e Akt Miratimit Higjieno-Sanitar nga ISHSH për shoqëritë UK. ERRU e ka ngritur këtë çështje në mënyrë të vazhdueshme pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, si edhe Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor,

por gjatë vitit 2020 ka qenë pothuajse e pamundur për shkak të Covid-19, pasi strukturat institucionale që lidhen me to kanë qenë tërësisht të fokusuar në drejtim të luftës kundër pandemisë.

Mendojmë që në përmbushje të detyrave të rezolutës së Kuvendit duhet rikonsideruar çështja për ngritjen e Grupit të Punës përkatës me përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për rishikimin e akteve dhe nën akteve ligjore përkatës që lidhen me këtë problematik edhe pse situata pandemike po vazhdon.

Theksojmë faktin se ERRU me shkresën nr.366 prot më datë 06.10.2021 me lëndë “mbi eliminimin e problemeve të licencimit të shoqërive UK në lidhje me plotësimin e kushteve të Akt Miratimit Higjieno - Sanitare dhe të inspektimeve që lidhen me to”, ju drejtua Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të rimarë iniciativën për ngritjen e Grupit të Punës për këtë qëllim. Letra është e shoqëruar me një relacion me argumente të detajuara në mbështetje të kërkesës së mësipërme.

Në këtë kuadër gjithashtu në shtator 2021, Kryetari i ERRU ka zhvilluar një takim me Drejtorin e Programit të Ujit të GIZ, në lidhje me asistencën e nevojshme që mund të kërkohej për përmirësimet e mësipërme, duke marrë paraprakisht një konfirmim në parim për mbështetjen me ekspertizë nga një ekspert ndërkombëtar i fushës, si dhe planifikimin e fondeve përkatëse për vitin 2022.

Sa më sipër, ERRU mbetet në pritje të përgjigjes së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të iniciuar punën për zgjidhjen e këtij problemi në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

8. *Duke qenë se treguesi “Norma e Arkëtimit” ka pasur një përkeqësim me 3% gjatë vitit 2020, edhe pse ERRU-ja është treguar agresive në vendosjen e objektivave për shoqëritë UK, të cilat aplikojnë për tarifa të reja, duhet që po kaq rigorozë të treqohet edhe në ndjekjen e përmbushjes së këtyre objektivave dhe të mos lejojë rritje tarifash në rast se shoqëria UK nuk ka përmbushur objektivat e caktuar për normën e arkëtimit. Rritja e tarifave pa përmirësuar normën e arkëtimit çon në diskriminimin e atyre konsumatorëve të cilët janë më korrekt me pagesat. Nga ana tjetër, fakti që në sektor ka shumë shoqëri që këtë tregues e kanë konstant ose/dhe me përmirësim tregon që është një objektiv i mundshëm për t’u arritur dhe ndikon drejtpërdrejtë në përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive UK.*

Përmirësimi i nivelit të treguesit “Norma e Arkëtimit” konsiderohet shumë i rëndësishëm nga ERRU pasi lidhet direkt me qëndrueshmërinë financiare dhe aftësinë paguese të shoqërive UK. Si rrjedhojë gjatë aplikimit të shoqërive për nivel të ri tarifar, përmirësimi i Normës së Arkëtimit është një ndër objektivat kryesorë që ERRU i vendos shoqërive për të arritur në të ardhmen. ERRU, për të vlerësuar performancën reale të shoqërive UK në drejtim të Normës së Arkëtimit, kërkon që të raportojnë veç Normën Korrente të Arkëtimit (NKA) dhe veç Normën e Përgjithshme të Arkëtimit (NPA) që përfshin dhe mbledhjen e debive të prapambetura.

Përgjithësisht ERRU vendos theksin në treguesin NKA për të cilin vendosen edhe objektivat gjatë analizës së aplikimeve për nivel të ri tarifar në mënyrë që të nxitet mbledhja e arkëtimeve të vitit dhe të mos rritet më tej niveli i detyrimeve të prapambetura.

Kjo praktikë është ndjekur edhe gjatë vitit 2021 në aplikimin për nivel të ri tarifar të shoqërisë UK Patos, UK Sarandë dhe UK Mallakastër e cila jepet si më poshtë në tabelën 7, si dhe ato që janë në proces vlerësimi, përkatësisht për shoqëritë UK Kukës, UK Bulqizë dhe U Konispol. ERRU vlerëson në detaje këtë tregues, krahasuar edhe me përqindjen e Familjeve me Ndihmë Ekonomike në zonën e

shërbimit të shoqërisë dhe vendos objektivin përkatës që duhet të arrijë shoqëria për përmirësimin e tij.

Tabela 7. Treguesi i Normës së Arkëtimit Korrente

Nr.	Operatori	Treguesi i Vitit 2020 (në %)	Propozimi i shoqërisë Viti 2022 (në %)	Objektivi i Vendosur nga ERRU Viti 2022 (në %)
1	UK Patos*	I pamundur për vlerësim për zonën e re të shërbimit	70.2	74
2	UK Sarandë*	76.1	77.6	78
3	UK Mallakastër	79.7	87	87

* Objektivi i propozuar për UK Patos dhe UK Sarandë është raportuar për vitin 2021 pasi këto shoqëri kanë aplikuar në fund të vitit 2020

Duhet theksuar se përmirësimi i treguesit të “Normës së Arkëtimit” gjatë dy viteve të fundit ka qenë i vështirë për shoqëritë UK, kjo si rezultat i pandemisë së Covid-19 dhe pasojave të tërmetit të fund vitit 2019.

9. Duhet të vijojë përpjekjet për të bërë të mundur promovimin e institucionit, ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre, si dhe për të rritur besimin e konsumatorëve tek ERRU-ja për mbrojtjen e interesave të tyre. Mbrojtja e interesave të konsumatorit duhet të jetë gjithmonë një prioritet i veprimtarisë së ERRU-së.

ERRU gjatë vitit 2021 nëpërmjet dëgjësive publike, promovimit të institucionit nëpërmjet rrjeteve sociale, takimeve dhe kontakteve të shpeshta me stafet e shoqërive Ujësjellës-Kanalizime në lidhje me ankesat e ndryshme të konsumatorit, ka rritur dhe vijon përpjekjet për rritjen e nivelit të besimit për zgjidhjen e problematikave nëpërmjet rekomandimeve ashtu dhe në dhënien e mendimeve për çdo ankesë që është paraqitur. ERRU ka planifikuar edhe riformatimin e faqes zyrtare të web-it ku konsumatorët të kenë akses për komente, ankesa dhe pjesëmarrje në problematikat e ndryshme të shërbimeve të Ujësjellës Kanalizimeve që ofrohen nga shoqëritë UK.

10. Të propozojë një qasje licencimi për skemat e veçanta që përdoren për furnizimin me ujë në zonat rurale dhe që administrohen nga vetë banorët. Këto skema duhet të jenë të studiuara dhe të mos krijojnë problematika me banorët që e kanë krijuar vetë infrastrukturën për këtë shërbim.

Të gjitha shoqëritë e riorganizuar në përputhje me reformën administrative, domethënë që përfshijnë në zonën e re të shërbimit edhe zonat rurale që më parë administroheshin nga ish komunat, janë përgjegjëse për shërbimet edhe në këto zona. Në mjaft raste cilësia e shërbimit në këto zona është me e ulët se ajo në zonat urbane. Në këtë situatë shoqëritë duhet ti japin prioritet dhe vëmendje të veçantë përmirësimit të cilësisë së shërbimeve edhe në këto zona që kanë nevojë për investime fizike për realizimin e tyre.

Shembull tipik i një eksperience pozitive është shoqëria UK Korçë e cila është angazhuar dhe po zbaton një plan investimi sipas një strategjie të përcaktuar menaxhimi të shërbimeve në zonat rurale për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve me rezultate pozitive mjaft të dukshme. Kjo eksperiencë e

mbështetur edhe nga programi i GIZ po promovohet dhe inkurajohet edhe nga ERRU për të gjitha shoqëritë e Ujësjetës Kanalizimeve.

Përhapja e kësaj eksperience do të eliminonte edhe fenomenin e administrimit nga vetë banorët e sistemeve të veçanta të furnizimit me ujë, të cilat është e pamundur që të licencohen nga ERRU për shkak të pamundësisë të përmbushjes së kërkesave ligjore për ti ofruar konsumatorëve shërbime profesionale dhe në garanci të mbrojtjes së shëndetit publik.

11. Në bashkëpunim me institucionet dhe aktorët kryesorë të sektorit UK të hartojë standardet përkatëse të njësive të shërbimit të klientit në territor, për të bërë të mundur lehtësimin e aksesit, mënyrën e pagesës, standardin e shërbimit etj.

Standartet e shërbimeve që një shoqëri UK duhet të respektojë në marrëdhëniet me konsumatorët janë të sanksionuara në Kodin e Ujit, drafti i së cilës u rishikua në fillim të këtij viti dhe është dërguar për aprovim në Këshillin e Ministrave.

ERRU bëri të gjithë komentet dhe rekomandimet për përmirësimin e këtij drafti në drejtim të standartit të shërbimeve, por zyrtarisht nuk ka marrë një kopje përfundimtare të tij për të verifikuar marrjen parasysh të tyre.

Theksojmë faktin se pavarësisht eksperiencës së mëparshme, që për arsye objektive drafti është aprovuar me anë të një VKM, ai përfaqson një dokument pune të natyrës teknike dhe që është mjaft dinamik në kohë. Bazuar në të gjitha eksperiencat ndërkombëtare, hartimi i këtij dokumenti duhet të jetë kompetencë e Rregullatorit (ERRU-së).

Për sa më sipër do të ishte mjaft e arsyeshme që në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për aprovimin e këtij drafti të rishikuar të përfshihej një klauzolë që ja kalonte kompetencën për hartimin/rishikimin e tij Rregullatorit (ERRU-së).

12. Të jetë proaktive në të gjitha rastet, ku, pavarësisht performancës së ndërmarrjeve UK në arkëtimin e faturave, të nxisë vendosjen e një sistemi tarifor që është konform analizave bashkëkohore financiare bazuar në një plan biznesi 5-vjeçar. Kjo duhet të jetë e reflektuar në metodologjinë e rishikuar të vendosjes së tarifave që ERRU-ja duhet të miratojë brenda vitit 2021.

Rishikimi i metodologjisë për vendosjen e tarifave ka qenë prioritet në planin e punëve të ERRU-së gjatë vitit 2021 dhe me vendim e KKRR Nr.539, datë 30.12.2021 u miratua dokumenti “Metodologjia dhe procedura për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjetës kanalizimeve”, i cili u hartua edhe me ndihmën e një eksperti ndërkombëtar të fushës, financiar nga Banka Botërore në kuadër të Programit të Danubit. Drafti i është shpërndarë për komente të gjitha shoqërive UK, si dhe institucioneve kryesore të fushës së ujit, përkatësisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKUM.

Metodologjia e rishikuar përmban dy metoda të llogaritjes së tarifave, atë ekzistuese të rishikuar “Kosto-Plus” e cila do të vazhdojë të përdoret për shoqëritë UK që propozojnë rritje tarifash deri në mbulimin 100% të kostove të O&M, dhe ajo e “Çmimit Tavan”, e cila aplikohet për tarifa të propozuara për shoqëritë me target mbulimin deri 100% të Kostove Kapitale të aktivitetit. Metodologjia sipas “Çmimit Tavan”, kërkon që shoqëritë të aplikojnë për tarifa të reja detyrimisht bazuar në një Plan Biznesi 5 vjeçar. ERRU përcakton planin tarifor dhe objektivat për periudhën rregulatore 5 vjeçare

gjatë së cilës shoqëria do të jetë në monitorim të vazhdueshëm. Në fund të çdo viti ERRU do të përditësojë tarifat e tyre, sipas nivelit të performancës dhe efektivitetit të kostos që shoqëria ka arritur për një vit, dhe këto tarifa do të hyjnë në fuqi për vitin e ardhshëm.

Gjithsesi ERRU ka rritur kërkesat dhe inkurajon që të gjitha shoqëritë të aplikojnë për tarifa të reja bazuar në një Plan Biznesi 5 Vjeçar sepse edhe për këtë kategori shoqërish ERRU do të aprovojë një periudhë rregullatorë me objektiva përkatëse për më shumë se një vit.

13. Për çdo ndërmarrje UK duhet të analizohen indikatorët minimale të ofrimit të shërbimit, të cilët duhet të përmbushen, në mënyrë që ndërmarrja UK të vijojë të gëzojë licencën.

ERRU licencën e miratuar për kategori të ndryshme të shërbimeve që shoqëritë ofrojnë ndaj konsumatorëve e shoqëron me kushtet përkatëse të licencimit që duhen zbatuar gjatë afatit të vlefshmërisë së licencës. Në to përfshihen edhe indikatorë të ndryshëm që duhen përmbushur, që janë të sanksionuara edhe në Kodin e Ujit. Zbatimi i këtyre kushteve monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga ERRU. Gjatë vitit 2021 zbatimi i këtyre kushteve ka qenë pjesë e platformës së monitorimit që ERRU kryen në baza vjetore për shoqëritë UK. Deri në fund të vitit 2021, ERRU, ka realizuar vizita monitorimi në 35 shoqëri UK, përkatësisht, Tiranë, Shkodër, Malësi e Madhe, Lezhë, Kurbin, Durrës, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Has, Elbasan, Tepelenë, Memaliaj, Bulqizë, Klos, Burrel, Kavajë, Peqin, Belsh, Cërrik, Konispol, Kamëz, Mallakastër, Pogradec, Patos, Krujë, Finiq, Mirditë, Gramsh, Vorë, Berat – Kuçovë, Ura Vajgurore, Roskovec, Fier dhe Lushnjë.

Gjatë këtyre vizitave, realizohen takime edhe me kryetarët e bashkive përkatësi si përfaqësues ligjor të aksionareve dhe që ligji i ngarkon me përgjegjësinë e realizimit të shërbimeve të Ujësjellës Kanalizimeve në territorin e tyre administrativ.

Monitorimi shoqërohet me një raport përkatës që krahason progresin në objektivat e indikatorëve të performancës, problemet dhe rekomandimet përkatëse për zgjidhjen e tyre në të ardhmen.

3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi

ERRU si institucion i pavarur dhe aktor kryesorë në sektorin UK jep në mënyrë të vazhdueshme kontributin e tij me rekomandime konkrete në adresë të qeverisë qendrore për përmirësimin e sektorit UK. Rekomandimet vinë si rezultat i njohurive që ERRU ka për sektorin UK nisur edhe nga eksperiencia mbi 20 vjeçare në rregullimin e sektorit të ujit në Shqipëri. Në raportin vjetor të aktivitetit të ERRU-së për vitin 2020, të dërguar pranë Këshillit të Ministrave dhe të prezantuar në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë nga Kryetari i ERRU, si dhe në raportin e performancës për shoqëritë UK të vitit 2020, janë dhënë disa rekomandime të cilat kërkojnë ndërhyrjen dhe mbështetjen e qeverisë qendrore.

Konkretisht rekomandimet e dhëna nga ERRU në vitin e mëparshëm konsistojnë në disa pika të nevojshme për t'u ndërmarrë në konsideratë nga qeveria qendrore për përmirësimin e sektorit UK në vendin tonë të cilat ishin:

- Hartimi i akteve të nevojshme nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjieno Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të rregullores së Inspektimeve Higjieno Sanitare për sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Hartimi i nënakteve të mësipërme do ti shërbejë rritjes së garancisë së sigurtë së shëndetit publik për uljen e riskut të kontaminimit të rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit, si një domosdoshmëri për zgjidhjen e problemit të licencimit të shoqërive UK.
- Është tashmë e njohur ideja dhe domosdoshmëria e procesit të agregimit të Shoqërive UK si avantazh i ekonomisë së shkallës për përmirësimin e performancës së sektorit dhe nisja e procesit bazuar në principin “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar fillimisht që të realizohen 2-3 agregime të suksesshme, ku ERRU duhet të para vlerësojë tarifat e agreguara në rastet e seleksionuara për agregim.
- Uji Pa të Ardhura, 65.4% në nivelin më të lartë të viteve të fundit mbetet problem serioz për sektorin UK. AKUM duhet të mbështesë instalimin e matësve të ujit në burim dhe tek konsumatorët familjarë kryesisht për shoqëritë e dobëta financiarisht në mënyrë që të hartohen bilanci e ujit të sakta si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.
- Si një element kyç për përmirësimin e performancës financiare të shoqërive UK, të thellohet procesi i hartimit të Kontratave të Performancës ndërmjet AKUM dhe Bashkive bazuar në Treguesit Kryesorë të Performancës aktuale dhe ato si objektiva të vlerësuar realisht, proces në monitorimin e të cilave duhet të përfshihet edhe ERRU. Realizimet e vlerësuara të këtyre kontratave të shërbejë si kriter bazë edhe për shpërndarjen e subvencioneve nga qeveria qendrore për shoqëritë UK.

Nisur nga rekomandimet e mësipërme konstatohet se në fund të muajit tetor të vitit 2021 qeveria qendrore ka shtuar vëmendjen në drejtimin e nevojës për rishikimin e reformës së ujit dhe nën drejtimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë po diskutohet edhe qasja për agregimin e sektorit UK, por akoma nuk ka një dokument apo vendim përfundimtar nga ana e qeverisë qendrore për formën,

shkallen dhe dimensionin e agregimit, planet e veprimit me të gjitha detajet e nevojshme mbi anën organizative, financiare dhe afate kohore për realizimin e saj.

Sa i përket rekomandimit të përsëritur mbi hartimin e akteve të nevojshme nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjiëno Sanitar për shoqëritë UK, ERRU edhe gjatë vitit 2021 ka vijuar të jetë proaktive në këtë drejtim.

Për këtë qëllim i është dërguar rishtazi një shkresë me nr. 366 prot, datë 06.10.2021 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të rimarrë iniciativën për ngritjen e Grupit të Punës për këtë qëllim me përfaqësues nga institucionet kyçe që lidhen me Akt Miratimin Higjiëno Sanitar. Shkresa është shoqëruar me një memo të hollësishme në lidhje me problematiken dhe detaje të tjera mbi rëndësinë dhe domosdoshmërinë dhe hapat që duhen ndjekur për zgjidhjen e këtij problemi. Deri në mbyllje të vitit nuk konstatohet të jetë ndërmarrë ndonjë veprim konkret në këtë drejtim.

Paralelisht ERRU gjatë vitit 2021 ka zhvilluar takime me Drejtorin e Programit të Ujit të GIZ, në lidhje me asistencën e nevojshme që mund të kërkohej për përmirësimet e mësipërme, nga ku është marrë premtimi për të përfshirë në buxhetin e vitit 2022 të GIZ fondet e nevojshme për asistencën e kërkuar.

ERRU ka dhënë prej kohësh propozime konkrete për rishikimin e akteve nënligjore aktuale mbi dhënien e Akt Miratimeve Higjiëno Sanitare, prej të cilave varet ngushtësisht dhe detyrimisht licencimi i shoqërisë UK për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura që ato i ofrojnë popullsisë.

Vlen të theksohet se vijimi i pandemisë edhe gjatë vitit 2021 ka ndikuar në marrjen në konsideratë të kësaj problematike pasi strukturat institucionale që lidhen me to kanë qenë tërësisht të fokusuara në drejtim të luftës kundër pandemisë.

Ecuria e rekomandimeve të tjera në lidhje me mbështetjen e nevojshme që kërkohej nga AKUM në drejtim të instalimit të matësave në burim si dhe të hartimit të Kontratave të Performancës ndërmjet AKUM dhe Bashkive bazuar në Treguesit Kryesorë të Performancës të vlerësuar realisht dhe me përfshirjen e ERRU-së, nuk ka patur zhvillime konkrete gjatë vitit 2021, kjo sigurisht që lidhet edhe me qasjen akoma të papërcaktuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në drejtim të agregimit të shoqërive UK në mënyrë që të vijohet më tej me ndërhyrje dhe masa konkrete.

4 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2022

- Rishikimin e ligjit nr. 8102 për forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur dhe të performancës së tij në shërbim të rritjes së performancës së sektorit në përgjithësi.
- Të ndjekë dhe nxisë procesin e plotësimit të strukturës së saj organizative me pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm në përgjigje të rritjes së efikasitetit të aktivitetit në përputhje me kërkesat e kohës dhe me detyrat që e ngarkon ligji.
- Në vijim të kërkesës drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për nevojën e ngritjes së grupit të punës për rishikimin e nën akteve ligjore që lidhen me Akt Miratimin Higjiene Sanitar, si kusht i domosdoshëm për liçensimin e shoqërive UK, të vijoje të jetë aktive dhe ta ndjekë këtë proces deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.
- Të vijoje të jetë proaktive në drejtim të monitorimit të shoqërive UK në nxitje për përmirësimin e treguesve kryesorë të performancës, në veçanti të uljes së humbjeve dhe rritjes së normës së arkëtimit.
- Të forcojë kontrollin në shoqëritë UK me qëllim ndërgjegjësimin e tyre në raportimin e të dhënave të sakta.
- Të vijoje punën për procesin e monitorimit të shoqërive UK mbi mënyrën e trajtimit të ankesave të konsumatorëve dhe evidentimit të problematikave që kanë shoqëritë në drejtim të ofrimit të shërbimit ujësjellës kanalizime, duke lenë rekomandime konkrete për tu realizuar nga ato.
- Në kuadër të rritjes profesionale të stafit, të organizojë trajnimin në vazhdimësi të tyre me anë të programit të ASPA, si dhe duke shfrytëzuar mundësitë nga bashkëpunimet me rregullatorët Evropianë të sektorit të ujit dhe të rajonit të Ballkanit Perëndimor.
- Të marrë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK për përmirësimin e instrumenteve rregullatore gjatë veprimtarisë së tij.
- Në vazhdimësi të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të forcojë bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKUM-it, me AMBU, si dhe aktorët e tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për përmirësimin e performancës së sektorit UK.
- Me mbështetjen e Programit të Modernizimit të Sektorit UK në Shqipëri, financuar nga Banka Botërore të synohet hartimi i një udhëzuesi dhe model i unifikuar i Planit 5 Vjeçar të Biznesit për Shoqëritë UK, përfshirë dhe trajnimet përkatëse të nevojshme për këtë qëllim.
- Mbas formalizimit të reformës së qeverisë qendrore për riorganizimin e mënyrës së administrimit të sektorit UK, të luajë rol aktiv në mbështetje të realizimit të objektivave përkatëse për realizimin e saj dhe për përmirësimin e performancës së sektorit.

5 Gjendja në Sektorin e Ujësjetës Kanalizime

5.1 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2021

Gjendja e Performancës së Sektorit të Ujësjetës Kanalizimeve e paraqitur në këtë raport, si pjesë e raportit vjetor të veprimtarisë së ERRU-së bazohet në të dhënat tekniko ekonomike vjetore paraprake të Shoqërive UK të raportuara pranë ERRU-së bazuar në platformën e data bazës të miratuar prej saj.

Të dhënat e raportuara në këtë moment konsiderohen paraprake, por afër atyre që priten të certifikohen nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar deri në fund të muajit mars 2021, kohë kur realizohet edhe dorëzimi i balanceve financiare nga shoqëritë UK.

Analiza e plotë e performancës së sektorit të ujit në përgjithësi dhe e çdo shoqërie në veçanti jepet në Raportin Vjetor të Performancës që hartohet dhe botohet çdo vit nga ERRU në fund të Qershorit të vitit pasardhës pasi disponohen të dhëna të plota vjetore të certifikuara për shoqëritë UK. Të dhënat e shoqërive në këtë rast ridërgohen përsëri pranë ERRU-së pasi janë rakorduar me pasqyrat financiare të certifikuara nga ekspertët kontabël të autorizuar.

ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme gjendjen dhe performancën e secilit operator dhe të sektorit në tërësi për shërbimet e furnizimit me ujë, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, sidomos të atyre shoqërive që operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU vitet e fundit. Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës, të miratuar nga KKRR. Në tabelën 8 të mëposhtme jepen nivelet e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2021 dhe tendencën e tyre krahasuar me vitin paraardhës 2020 ndërsa në Aneks 3 jepen treguesit e performancës për secilën shoqëri në vete dhe sipas grupeve të klasifikuara për këtë qëllim.

Tabela 8. Treguesit Kryesorë të Performancës për Vitet 2020-2021

Nr.	Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2020	Viti 2021	Tendenda
1	Uji Pa të Ardhura	%	65.4	64.7	↗
2	Mbulimi i Kostove O&M	%	103.2	103	↘
3	Norma e Arkëtimit Korrente	%	76.6	79.8	↗
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	%	89.8	94.1	↗
5	Niveli i Matjes	%	79.6	80.7	↗
6	Efienca e Stafit	(stafi/1000 lidhje UK)	5.32	5.28/4.9*	↗
7	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	13.8	13.8	=
8	Mbulimi me Furnizimin me Ujë	%	76.1	77	↗
9	Mbulimi me Kanalizime	%	51.5	51.9	↗

Burimi: ERRU

* Efienca e Stafit 5.28 staf për 1000 lidhje përfshin edhe personelin roje të nënkontraktuar me privatën ndërsa 4.9 staf për 1000 lidhje UK nuk përfshin këto të fundit.

Referuar tabelës së mësipërme, Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2021 paraqiten me një përmirësim të lehtë pothuajse në të gjithë treguesit me përjashtim të treguesve Mbulimi i Kostove O&M dhe Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë të cilët mbesin në të njëjtin nivel me ato të vitit 2020.

Ndërkohë që është përmirësuar treguesi i Normës së Arkëtimit Korrent, kemi një përkeqësim të lehtë të treguesit të Mbulimit të Kostove të O&M, pra rritja e kostove të O&M nuk është kompensuar mjaftueshëm me të ardhurat.

Përmirësimi i gjendjes së sektorit UK për vitin 2021 ka ardhur si rezultat i rritjes së performancës së shoqërive në drejtimin të menaxhimit nga rritja e faturimeve dhe arkëtimeve dhe ulja e humbjeve.

Ndërkohë përmirësimi i gjendjes financiare të sektorit për të tentuar mbulimin e Kostove Totale kërkon një kontroll dhe menaxhim më të mirë të kostove të O&M që ato të jenë të justifikueshme (mundësisht të reduktohen), si edhe rritja e të ardhurave nga faturimi dhe mbledhja e tyre.

Më poshtë jepet analiza e detajuar e ecuresë për secilin tregues kryesor të performancës.

"Uji Pa të Ardhura" (UPA), i cili është një nga treguesit më të rëndësishëm, për vitin 2021 është përmirësuar me rreth 0.7% krahasuar me një vit më parë, përkatësisht nga 65.4% në 64.7%. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së volumit të ujit të faturuar me 4.9 milion m³ përkundrejt volumit të prodhuar i cili është rritur me 2.6 milion m³ gjatë vitit 2021.

Ndikimi pozitiv në këtë rast ka ardhur nga shoqëria UK Tiranë e cila ka një rritje të volumit të faturuar me 2.7 milion m³ e cila është më e madhe edhe se vet sasia totale e rritur e ujit të prodhuar nga i gjithë sektori për vitin 2021. Pjesa më e madhe e sasisë së ujit të faturuar me rreth 2 milion m³ për UK Tiranë ka ardhur kryesisht nga rritja e volumit të faturuar nga entet private dhe nga sasia e ujit të shitur me shumicë. Në sektor ka dhe shoqëri të tjera që kanë rritje të faturimit, si UK Durrës me 485 mijë m³, UK Selenicë me 319 mijë m³, Dropull me 290 mijë m³, UK Sarandë 260 mijë m³ etj. Nga ana tjetër ka disa shoqëri të cilat e kanë ulur volumin e ujit të faturuar, dhe në të kundërt kanë rritur volumin e ujit të prodhuar.

Për vitin 2021 në sektor shoqëritë që kanë nivel të mirë të këtij treguesi paraqiten: *Ersekë, Pustec, Konispol, Lezhë, Tepelenë, Dropull, Korçë, Kukës, Devoll, Belsh, Përmet* etj. Ndërkohë ky tregues mbetet akoma në nivele të papranueshme (mbi 70%) kryesisht në shoqëritë e grupit të parë si: *Durrës, Vlorë, Elbasan dhe Kamëz* të cilat japin një impakt negativ në performancën e përgjithshme të sektorit.

Evidentimi dhe vlerësimi i humbjeve që reflektohet në raportet vjetore të Bilanceve të Ujit që shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU-së merr një rëndësi të veçantë për rekomandimet për përmirësimin e kësaj gjendje. Në baze të tyre ERRU harton dhe publikon raportin e bilancit të ujit vjetor si një instrument i rëndësishëm për evidentimin e humbjeve, vlerësimin e tyre si dhe orientimin e shoqërive për përmirësimin e treguesit "Uji Pa të Ardhura". Gjithashtu një analizë e veçantë e këtij treguesi në të gjithë elementët e tij realizohet në momentin kur shoqëritë aplikojnë për nivel të ri tarifor.

"Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes" është treguesi i cili shpreh mbulimin e kostove direkte me të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë duke përjashtuar subvencionet. Këtu përfshihen kostot për personelin, energjinë, kimikatet dhe kosto të tjera sekondare që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen. Mbulimi i Kostos së Operim Mirëmbajtjes për vitin 2021 është 103% dhe është pothuajse në të njëjtin nivel me atë të vitit paraardhës që ishte 103.2%.

Në mbyllje të vitit 2021 në sektor kanë zhvilluar aktivitetin 58 shoqëri UK nga 57 që ishin në vitin paraardhës pasi është shtuar shoqëria UK Memaliaj e cila deri në mbyllje të vitit 2020 ka qenë pjesë e shoqërisë UK Tepelenë, por në këtë raportim nuk është marrë në analizë pasi nuk ka bazë krahasimore.

Nga 57 shoqëri vetëm 12 prej tyre arrijnë të mbulojnë mbi 100% kostot O&M, nga 10 shoqëri të tilla që ishin në vitin 2020. Në sektor janë 24 shoqëri të cilat performojnë dobët nën nivelin 70% të këtij treguesi që me vështirësi arrijnë të mbulojnë pagat e personelit. Pjesa tjetër e 21 shoqërive që mbeten janë në nivelet 73.5% deri 100% të këtij treguesi. Mbulimi i kostove Totale në të cilat përfshihen dhe kostot e amortizimit dhe të interesave të kredive edhe për vitin 2021 vijon të mbulohet vetëm nga dy shoqëri UK në sektor, përkatësisht UK Tiranë dhe UK Ersekë.

Në detaje kostot për sektorin e Ujësjetës Kanalizimeve jepen në Tabelën 9 të mëposhtme.

Tabela 9. Ecuria e Kostove dhe të Ardhurave krahasuar me vitin paraardhës

Nr.	Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021	Diferenca
	<i>Kostot e Shërbimit UK</i>	<i>në 000 lekë</i>	<i>në 000 lekë</i>	<i>në 000 lekë</i>
1	Kosto e punës	4,300,480	4,709,610	409,130
2	Kosto e materialeve	233,679	271,818	38,139
3	Kosto e energjisë së konsumuar	2,592,311	2,751,886	159,575
4	Kosto e riparim/mirëmbajtjes	499,668	429,528	-70,140
5	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	1,001,599	679,095	-322,504
6	Kosto të tjera	914,753	974,804	60,051
	Kostot Operim & Mirëmbajtjes	9,542,490	9,816,741	274,251
1	Kostot e amortizimit	2,595,284	2,853,020	257,736
2	Kostot financiare taksa tatime	1,011,344	684,209	-327,135
	Kostot Totale	13,149,117	13,353,970	204,853
	Të Ardhurat:			
1	Nga aktiviteti UK	9,850,414	10,114,708	264,294
	Të Ardhurat Totale	9,850,414	10,114,708	264,294
	Niveli i Mbulimit të Kostove			0
	Mbulimi i Kostove të O & M	103.2%	103%	0%
	Mbulimi i Kostove Totale	75%	76%	1%

Nisur nga tabela e mësipërme vërehet se Sektori për vitin 2021 ka zhvilluar aktivitetin e tij duke shënuar një rritje të konsiderueshme të kostove të Operimit dhe Mirëmbajtjes me rreth 274.2 milion lekë, por pothuajse në të njëjtin nivel me rreth 264.3 milion lekë janë rritur edhe të ardhurat në sektor. Kjo diferencë e vogël ndërmjet rritjes së kostove O&M dhe të ardhurave ka ndikuar në mbajtjen e këtij treguesi pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2020.

Në detaje konstatohet se rritjen më të madhe të kostove të O&M e përbëjnë kostot e punës (+409.1 milion lekë), kostot e energjisë (+159.6 milion lekë) ndërsa kostot materialeve dhe kostot e tjera kanë shënuar një rritje të lehtë dhe të justifikuar si rezultat i rritjes së çmimeve.

Kostot e Punës rezultojnë të rritura edhe pse gjatë vitit 2021 numri i punonjësve në sektor është shtuar vetëm me 11 punonjës, rritja e kostove të punës ka ardhur kryesisht për shkak të rritjes së nivelit të pagës minimale nga qeveria qendrore, që ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2021.

Kostot e Energjisë raportohen të rritura si rezultat i rritjes së vëllimit të ujit të prodhuar me ngritje mekanike me 1.5 milion m³ ujë. Peshën më të madhe në rritjen e këtij zëri e zë shoqëria UK Durrës me 191 milion lekë më shumë se në 2020, vlerë kjo më e madhe dhe se vet rritja mesatare e kësaj kostoje për të gjithë sektorin e cila rrjedhimisht ndikon drejtpërdrejt në përkeqësimin e treguesit të mbulimit të kostove për këtë shoqëri. Rritja e kostonë së energjisë për UK Durrës, vjen si rezultat i hyrjes në funksion të plotë të burimit të Fushë Milotit në vitin 2021 i cili gjatë vitit 2020 ka operuar me gjysëm kapaciteti dhe vetëm për 4 muajt e fundit të vitit. Gjithashtu ndikim të konsiderueshëm ka dhënë edhe mënyra e re blerjes së energjisë elektrike si rezultat i krizës energjitike të katër muajve të fundit të vitit 2021. Sipas njoftimit nga OSHEE, shoqëritë UK që furnizohen me energji nga burimi 35 KV faturohen nga OSHEE me tarifa të liberalizuara të tregut, pra jo të rregulluara nga ERRE. Subjekt i kësaj gjendje ka qenë UK Durrës e cila për muajt e krizës është faturuar nga OSHEE me tarifa të tregut që kanë qenë rreth 3 herë më të larta se ato para saj.

Në nëntor 2021 referuar një VKM bizneset të cilat furnizohen me energji elektrike nga burime 20KV, 10KV dhe 6 KV duke filluar nga 1 janari 2022 do të faturohen me tarifa të liberalizuara sipas tregut dhe jo më si më parë me tarifa të rregulluara nga ERRE. Në këtë kategori futen pothuajse të gjithë shoqëritë UK të Shqipërisë, që do të thotë se pritet një rritje mjaft e madhe e kostonë së energjisë elektrike për to. Duke patur parasysh impaktin negativ mjaft të madh të këtij akti në ekuilibrin financiar të shoqërive, priten vendime të tjera nga qeveria për përbalimin e kësaj situatë nga shoqëritë UK.

Kostot e Riparimeve rezultojnë të ulura për vitin 2021 kjo si rezultat i investimeve të bëra në rrjetin e ujësjellësit të cilat kanë dhënë ndikimin e vet në drejtim të reduktimit të kësaj kostoje.

Kostot e Shërbimeve të Kontraktuara rezultojnë të ulura impakt i cili ka ardhur kryesisht nga shoqëria UK Tiranë e cila ka ulur këtë kosto me 299 milion lekë dhe përbën rreth 93% të totalit të diferencës së kësaj kostoje për të gjithë sektorin krahasuar me vitin 2020. Në shërbimet e kontraktuara peshën më të madhe e zënë shërbimet e kontraktuara për rojet private.

Kostot të Tjera Operacionale Përfshihen kostot e qerave për zyrat, vendimet gjyqësore, detyrimet ndaj institucioneve si ERRU, SHUKALB, Agjencive të Baseneve ujore etj. Ky zë shpenzimesh raportohet me rritje prej 60 milion lekë krahasuar me vitin 2020.

Kostot Kapitale ku përfshihen kostot e amortizimit të cilat janë rritur me 257.7 milion lekë, ku peshën më të madhe e ka dhënë shoqëria UK Kamëz, pasi më parë ka raportuar vetëm asetet e shoqërisë si Sh.a dhe në vitin 2021 ka raportuar edhe asetet e ndërmarrjes ekzistuese. Kostot financiare rezultojnë të ulura me -327 milion lekë. Diferenca e këtyre dy zërave ka sjellë edhe përmirësimin e treguesit të Mbulimi të Kostove Totale me 1%.

Të ardhurat nga aktiviteti i UK janë rritur me 264.3 milion lekë kjo ka ardhur kryesisht nga influenza e rritjes së numrit të lidhjeve me +17,200 lidhje të reja FU e cila ka ndikuar edhe rritjen e nivelit të faturimit. Volumi i ujit të faturuar për sektorin UK në total është rritur me 4.9 milion m³ edhe për shkak se disa shoqëri kanë përmirësuar treguesin e vazhdimësisë së furnizimit me ujë

Siç theksohet më sipër këto raportime janë paraprake dhe një analizë e detajuar e treguesve të Mbulimit të Kostove O&M dhe të Kostove Totale për vitin 2021 do të jepet në Raportin e Performancës

së Sektorit Ujësjellës Kanalizime i cili publikohet në fund të muajit qershor 2022. Në këtë raport realizohet verifikimi dhe rakordimi i të dhënave duke ju referuar Bilanceve Kontabël të certifikuar nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar.

"Norma e Arkëtimit" është një nga treguesit më të rëndësishëm të performancës së shoqërive e cila lidhet me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj. ERRU për Normën e Arkëtimit konsideron dy tregues, përkatësisht Normën e Arkëtimit të Përgjithshme (NAP) dhe Normën e Arkëtimit Korrente (NAK). NAP në përlogaritjen e saj përfshin të gjitha arkëtimet e kryera nga shoqëria, përfshirë edhe debitë e vjetra, ndërsa NAK i përjashton këto të fundit.

Norma e Arkëtimit Korrente për sektorin UK në vitin 2021 rezulton të jetë përmirësuar në 79.8 % nga 76.6 % që ishte në vitin 2020. Ndikimin kryesorë e japin shoqëritë të cilat kanë një normë arkëtimi korrente mbi mesataren e sektorit si ato : *Kamëz, Poliçan, Vorë, Pogradec, Vlorë, Konispol dhe Lezhë*.

Gjithashtu Norma e Arkëtimit e Përgjithshme për vitin 2021 paraqitet e përmirësuar në 94.1% nga 89.8% në vitin 2020. Kjo tregon se shoqëritë kanë punuar mirë në drejtim të mbledhjes së debive të prapambetura ku shpesh herë nga ana e tyre përdoret alternativa e lidhjes së akt marrëveshjeve me debitorët për shlyerjen e borxheve. Shoqëritë të cilat kanë punuar mirë në drejtim të mbledhjes së debive të prapambetura për vitin 2021 janë: Tirana, Elbasani, Saranda, Divjaka, Vlora, Belshi, Përmeti, Berat-Kuçova, Ura Vajgurore, Tepelena dhe Korça.

Gjithsesi në sektor ka shumë shoqëri që kanë arkëtuar më pak debi krahasuar me vitin e mëparshëm 2020. Kjo rënie konsiderohet normale pasi mbledhja e debive të prapambetura bëhet gjithnjë dhe më e vështirë sepse një pjesë e tyre janë debi të këqija praktikisht me mundësi zero për tu mbledhur.

"Niveli i Matjes" është një tregues i cili ka një përmirësim konstant çdo vit dhe për vitin 2021 është përmirësuar me 1.1%, duke arritur për të gjithë sektorin nivelin e 80.7%. Megjithatë gjatë vitit janë instaluar rreth 39,146 matës uji, në sektor ende raportohen 177, 024 klientë pa matës nga të cilët 7,111 janë të kategorisë jo familjarë. Referuar VKM nr. 96, datë 21.02.2007 i detyron klientët jo familjarë (subjektet private) që të instalojnë ujëmatës me shpenzimet e tyre, por akoma ky vendim rezulton i pazbatuar plotësisht.

Shoqëritë duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë pajisjes 100% të konsumatorëve me matës, në mënyrë që konsumatorët të paguajnë volumin real të ujit të konsumuar, por edhe për faktin se faturimi aforfe lë shteg për shpërdorimin e ujit nga konsumatorët për ujitje, veçanërisht ato të shtëpive private dhe zonave rurale e cila jep me pas impakt negativ edhe në treguesin tjetër të Uji Pa të Ardhura.

"Eficienca e Stafit" për vitin 2021 për arsye krahasimi me vitin paraardhës është paraqitur me dy të dhëna sipas tabelës së mësipërme. Konkretisht eficienca e stafit për vitin 2021 është 5.28 punonjës për 1000 lidhje UK kundrejt 5.32 që ishte në vitin 2020. Në vlerësimin e këtij treguesi në këtë rast janë përfshirë stafet sipas organogramës së shoqërive, si dhe personeli roje i nënkontraktuar me subjekte private. Treguesi i efijencës së stafit pa përfshirë personelin roje të nënkontraktorëve është në nivelin e 4.9 punonjës për 1000 lidhje UK. Për ti venë para një reference të njëjtë krahasimi, kjo mënyrë llogaritje do të ndiqet nga ERRU në vitet në vijim pasi paraqet situatën reale të stafit i cili operon në shoqëri sipas organogramës e cila është edhe një nga dokumentet që ERRU i kërkon shoqërive në momentin që aplikojnë për nivel të ri tarifor dhe mbi të cilën vendosen edhe objektivat e këtij treguesi.

Ky tregues luhetet në varësi të dy variablave që janë numri i stafit të shoqërive dhe numri i lidhjeve UK. Përmirësimi i lehtë i efikasitetit të stafit për vitin 2021, vjen si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve të ujit me rreth 17,200 lidhje dhe zvogëlimin të lidhjeve me kanalizime me rreth 2,883 lidhje, ndërsa numri i stafit është rritur me 11 punonjës. Ulja e numrit të lidhjeve të kanalizimeve nuk është reale pasi vjen kryesisht nga shoqëria UK Tepelenë e cila në fund të vitit 2020 është ndarë nga shoqëria UK Memaliaj me të cilën kanë operuar si një shoqëri e vetme, por të dhënat e raportuara nga shoqëria UK Memaliaj për vitin 2021 për efekt krahasimi me vitin paraardhës nuk janë marrë në konsideratë pasi ka raportuar për herë të parë.

Në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të kërkesës në plotësimin e detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së veprave me personel roje veçorive të komponentëve të sistemeve të FU dhe KUN. Në ato zona shërbimi ku numri i depove dhe puseve dhe stacioneve të pompimit është i madh shoqëritë janë të detyruara që të kenë një numër të konsiderueshëm punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte që krijojnë përshtypjen e një treguesi të ulët të Efikasitetit të Stafit.

Një tjetër element evident është dhe abuzimi me punësimet e pajustificuara, prandaj ERRU i kushton një vëmendje të veçantë analizës së stafit për vlerësimin real të këtij treguesi bazuar në organogramën përkatëse të shoqërisë dhe justifikimin e çdo pozicioni të punës në përputhje me përshkrimin e saj. Veçanërisht, kjo analizë zhvillohet më tej kur shoqëria aplikon pranë ERRU për nivel të ri tarifor.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" është një tregues i cili lidhet direkt me cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe shpreh mesataren e orëve të furnizimit me ujë në ditë që ato furnizohen. Ky tregues megjithëse ka patur tendencë pozitive për çdo vit, në 2021 mbetet në të njëjtin nivel 13.79 orë/ditë me vitin 2020. Në mbyllje të vitit rezulton se në sektor operojnë 10 shoqëri UK që kanë furnizim të pandërprerë dhe me cilësi të lartë 24/7 ndërsa pjesa dominuese e shoqërive, 34 prej tyre ofrojnë furnizimin me ujë në nivele relativisht të mira 10-22 orë në ditë.

Duke patur në fokus furnizimin me ujë 24/7 orë fillimisht në qendrat urbane, qeveria qendrore ka vendosur si objektiv afat shkurtër që me investime nga buxheti i shtetit nëpërmjet AKUM të ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë 24 orë deri në vitin 2023 për 58 nga 66 qendra urbane, projekt ky që ka filluar të zbatohet që në vitin 2018. Deri në fund të vitit 2020 si rezultat i investimeve të kryera nga AKUM u arrit një regjim furnizim me ujë pa ndërprerje (24/7 orë) i 22 qendrave urbane, përkatësisht: Shkodër, Fushë Arrëz, Lezhë, Tropojë, Gramsh, Cërrik, Korçë, Pogradec, Maliq, Bilisht, Fier, Sarandë, Himarë, Konispol, Tepelenë, Përmet, Pukë, Vau Dejës, Koplik, Peqin, Poliçan dhe Këlcyrë.

Gjatë vitit 2021 si rezultat i investimeve të qeverisë qendrore nëpërmjet AKUM-it për vlerën 945,867,715 lekë (rreth 7,8 milion euro), u arrit përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për konsumatorët me një regjim 24/7 orë edhe për 7 qendra urbane, përkatësisht Kamëz, Krujë, Rrëshen, Ersekë, Berat, Kuçovë dhe Memaliaj duke e çuar në total në 29 qendra urbane të banuara me regjim të pandërprerë të furnizimit me ujë (shih Aneks 5).

"Mbulimi i Furnizimit me Ujë" për vitin 2021 ka një përmirësim me rreth 1% dhe është në nivelin e 77% nga 76.1% që ishte në vitin 2020. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i shtimi të popullsisë së shërbyer në juridiksion me rreth 46,716 banorë.

Impakti kryesor ka ardhur nga shoqëritë UK Kamëz, UK Tiranë dhe UK Durrës, por në sektor ka shumë shoqëri që kanë raportuar shifra më të ulëta se vitin paraardhës që në total kjo ulje shkon rreth 29,753 banorë, kjo si rezultat i saktësimit të të dhënave nga ana e tyre.

Rritja e Mbulimit të Furnizimit me Ujë nga shoqëritë UK është e lidhur edhe me investimet e nevojshme fizike që kërkohen në sektor në mënyrë që të mbulohen edhe zonat e bardha ose të pa shërbyera më parë.

"Mbulimi me Kanalizime" për vitin 2021 ka një përmirësim të papërfillshëm me 0.4 % krahasuar me vitin 2020 dhe është në nivelin e 51.9 %, pasi popullsia me shërbimin e KUN është rritur me rreth 17,770 banorë.

Në sektor janë akoma rreth 195 mijë banorë të cilët e realizojnë grumbullimin e ujërave të ndotura nëpërmjet gropave septike kundrejt 2.3 milion banorëve që shërbehen nga shoqëria me kanalizime. Gjithashtu rritja e cilësisë së shërbimit të kanalizimeve lidhet edhe me nevojën e ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Për vitin 2021 kanë raportuar të dhëna 7 shoqëri ku numri total i popullsisë së shërbyer me ITUN është rreth 497,960 banorë me një rritje prej 33,563 banorë krahasuar me vitin 2020.

Përmirësimi i këtij treguesi megjithë investimet e kryera nga buxheti i shtetit është në nivele të pakënaqshme. Ndër vite niveli i investimeve në drejtim të mbulimit me KUN ka qenë i pamjaftueshëm, pasi investimet kryesisht janë fokusuar në drejtim të mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë.

Investimet në Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve

Investimet fizike në sektorin e ujësjellës kanalizimeve për vitin 2021 kanë pësuar një rënie në krahasim me vitet e mëparshme. Investimet nga buxheti i shtetit për vitin 2020 nëpërmjet AKUM-it kanë qenë të orientuara për përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë për qendrat urbane, si projekte të reja dhe ato në vazhdim nga viti i kaluar. Këto investime gjatë vitit 2021 në total janë disbursuar në vlerën 946 milion lekë (rreth 7,8 milion euro). Siç është theksuar më sipër me anë të tyre u arrit përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për konsumatorët me një regjim 24/7 orë edhe për 7 qendra urbane, përkatësisht *Kamëz, Krujë, Rrëshen, Ersekë, Berat, Kuçovë dhe Memaliaj*.

Ndërkohë në sektor është investuar edhe nga donatorët e huaj, kryesisht nga BE dhe KfW. Këto investime në total kanë rezultuar në vlerën e 2.6 miliard lekë ose rreth 21 milion euro. Siç shihet këto vlera rezultojnë më të mëdha se ato të investuara nga buxheti i shtetit, por krahasuar me vitet e mëparshme këto investime kanë qenë në vlerë më të ulët. Investimet fizike nga donatorët kanë konsistuar kryesisht në financimin e Programit të Infrastrukturës Bashkiake III, IV dhe V (rreth 90% e totalit) që përmbledh 6 qytete të Shqipërisë ndërkohë që pjesa tjetër e financimit është investuar në projekte të tjera në një shkallë më të vogël, si për rehabilitimin e rrjetit hidrik të Tiranës etj.

Subvencionet

Qeveria qendrore nëpërmjet AKUM-it gjatë vitit 2021 ka shpërndarë subvencione për mbulimin e kostove të O&M për 29 shoqëri UK për vlerën totale prej 380 milion lekë, të cilat kanë qenë të dedikuara vetëm për zërin e kostos së energjisë elektrike që shoqëritë UK i detyrohen OSHEE-së, ose 230 milion lekë më shumë sesa ato të alokuara në vitin 2020. (shih Aneks 4)

Gjatë vitit 2021 qeveria qendrore nuk ka alokuar subvencione për shoqëritë UK për sigurimet shoqërore, tatimet, COVID-in etj., të cilat për vitin 2020 përbënin peshën kryesore të vlerës totale të subvencioneve.

Nëntë (9) Shoqëri, përkatësisht: Durrës (98,250,000 lekë), Vlorë (52,515,000 lekë), Patos (32,760,000 lekë), Elbasan (30,345,000 lekë), Kurbin (21,607,000 lekë), Kavajë (17,612,000 lekë), Mallakastër (13,481,000 lekë), Lushnje (12,458,000 lekë) dhe Peqin (10,629,000 lekë), *kanë marrë në total 301,000,000 lekë subvencione ose rreth 80% të totalit të subvencioneve të shpërndara nga AKUM-i në vitin 2021.*

Për këto 9 shoqëri duhet të adresohet në veçanti problemi i pagesës së faturës së energjisë elektrike dhe të borxheve të prapambetura ndaj OSHEE-së, duke analizuar të gjithë faktorët që lidhen për përmirësimin e kësaj situate, si për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në sisteme, përmirësimin e treguesve kryesorë të performancës, si dhe të aplikimit pranë ERRU-së për rritjen e tarifave të shërbimeve Ujësjellës kanalizime për konsumatorët.

6 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe të Sektorit të Ujit

- Duke patur parasysh problematiken për liçensimin e shoqërive UK, të fillojë procesi i ngritjes së grupit të punës për rishikimin dhe hartimin e akteve të nevojshme nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjieno Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të rregullores së Inspektimeve Higjieno Sanitare për sistemet e FU dhe KUN. Hartimi i nënakteve të mësipërme do ti shërbejë rritjes së garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e riskut të ndotjes së rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit.
- Për shoqëritë problematike në drejtim të pagesës së faturës së energjisë elektrike në bashkëpunim me AKUM-ERRU-OSHEE të realizohet një analizë e thelluar e gjendjes për secilën shoqëri sipas një vlerësimi real të Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP), si dhe të firmoset një kontratë performance bazuar në objektiva që synojnë përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive. Në kontratën e performancës fokusi kryesor duhet të jetë në TKP, sidomos të UPA, Normës Korrente të Arkëtimit dhe Efikasitetit të Stafit dhe të përmirësimit të treguesit të efikasitetit të energjisë elektrike. Realizimet e vlerësuara të këtyre kontratave të shërbejnë edhe si element bazë për shpërndarjen e subvencioneve nga qeveria qendrore për shoqëritë UK.
- Në kuadër të nismës së qeverisë qendrore të ndërmarrë gjatë vitit 2021 mbi agregimin e sektorit si avantazh i ekonomisë së shkallës për përmirësimin e performancës së sektorit në drejtim të përmirësimit të efikasitetit operacionale dhe qëndrueshmërisë financiare, të vijohet sa më parë me konkretizimin e këtij procesi sa i përket formës dhe detaje të tjera organizative, financiare dhe kohore që janë parashikuar për realizimin e saj.
- Për rritjen e efikasitetit të ERRU-së në mbështetje të përmirësimit të performancës së sektorit të UK në vend, si dhe në përgjigje të kërkesave të kohës për sektorin dhe të ndryshimeve klimatike, të mbështetet rishikimi i ligjit nr. 8102 për rregullimin e sektorit.

Aneks 1 - Aplikimet e Shoqërive dhe Situata e Licencimit për Vitin 2020

Tabela 1. Aplikimet e shoqërive që kanë kaluar për vendimmarrje dhe shoqëritë që janë ende në proces

Nr.	Shoqëritë që kanë aplikuar	Kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR					
		Mbarim afati	Ndryshim Drejtuesi Ligjor	Ndryshim Drejtuesi Teknik	Ndryshim Zone Shërbimi	Licencim Për herë të parë	Shtim kategori shërbimi
1	Sh.A.UK Korçë	X					
2	Sh.A.UK Lushnje	X					
3	Sh.A.UK Pogradec	X					
4	Sh.A.UK Gjirokastrë	X					
5	Sh.A.UK Konispol			X			
6	Sh.A.UK Selenicë	X					
7	Sh.A.UK Krujë	X					
8	Sh.A.UK Krujë		X				
9	Sh.A.UK Mat	X					
10	Sh.A.UK Skrapar	X					
11	Sh.A.UK Has	X					
12	Sh.A.UK Tepelenë	X					
13	Sh.A.UK Tropojë		X				
14	Sh.A.UK Delvinë	X					
15	Sh.A.UK Durrës	X					
16	Sh.A.UK Librazhd -Prenjas	X					
17	Sh.A.UK Gramsh	X					
18	Sh.A.UK Maliq	X					
19	Sh.A.UK Roskovec	X					
20	Sh.A.UK Cërrik	X					
21	Sh.A.UK Shkodër	X					
22	Sh.A.UK Tiranë	X					
23	Sh.A.UK Lezhë	X					X
24	Sh.A.UK Devoll (Bilisht)	X					
25	Sh.A.UK Poliçan	X					
26	Sh.A.UK Elbasan		X	X			
27	Sh.A.UK Rogozhinë		X	X			
28	Sh.A.UK Memaliaj					X	
29	Sh.A.UK Berat - Kuçovë	X					
30	Sh.A.UK Sarandë				X		
31	Sh.A.UK Vorë		X				
32	Sh.A.UK Patos	X					
Nëntotali		24	5	3	1	1	1
Totali		35					

Burimi ERRU

 Shoqëria sh.a UK Patos është në proces për rinovim licence

Tabela 2. Situata e Gjendjes së Licencimit të Shoqërive UK - 2021

Nr.	Me licencë të vlefshme	Në proces rinovimi	Me Licencë të pavlefshme dhe që nuk kanë aplikuar	Asnjëherë të pajisur me licencë
		Mbarim afati, ndryshim drejtuesi ligjor/teknik, ndryshim zone shërbimi, shoqëri e re		
1	Sh.a. UK Gjirokastër	Sh.a. UK Patos	Sh.a U Divjakë	Sh.a. UK Klos
2	Sh.a. UK Devoll			Sh.a. UK Pustec
3	Sh.a. UK Lezhë			Sh.a UK Kamëz
4	Sh.a. UK Tepelenë			
5	Sh.a. UK Dibër			
6	Sh.a. UK Korçë			
7	Sh.a. UK Durrës			
8	Sh.a. UK Mat			
9	Sh.a. UK Delvinë			
10	Sh.a. UK Berat - Kuçovë			
11	Sh.a. UK Selenicë			
12	Sh.a. UK Kurbin			
13	Sh.a. UK Ura Vajgurore			
14	Sh.a. UK Librazhd			
15	Sh.a. U Gramsh			
16	Sh.a. UK Malësi e Madhe			
17	Sh.a. UK Kukës			
18	Sh.a. UK Vorë			
19	Sh.a. UK Kolonjë			
20	Sh.a. UK Pogradec			
21	Sh.a. UK Krujë			
22	Sh.a. UK Poliçan			
23	Sh.a. UK Vau i Dejës			
24	Sh.a. UK Belsh			
25	Sh.a. UK Maliq			
26	Sh.a. UK Cërrik			
27	Sh.a. UK Vlorë			
28	Sh.a. UK Skrapar			
29	Sh.a. UK Shkodër			
30	Sh.a. UK Roskovec			
31	Sh.a. UK Tropojë			
32	Sh.a. UK Sarandë			
33	Sh.a. UK Libohovë			
34	Sh.a. UK Rrogozhinë			
35	Sh.a. UK Dropull			
36	Sh.a. UK Kavajë			
37	Sh.a. UK Himarë			
38	Sh.a. UK Finiq			
39	Sh.a. UK Konispol			
40	Sh.a. UK Elbasan			
41	Sh.a. U Këlcyrë			
42	Sh.a. UK Mallakastër			
43	Sh.a. UK Fushë Arrëz			
44	Sh.a. UK Përmet			
45	Sh.a. UK Peqin			
46	Sh.a. UK Pukë			
47	Sh.a. UK Fier			
48	Sh.a. U Bulqizë			
49	Sh.a. UK Mirditë			
50	Sh.a. UK Has			
51	Sh.a. UK Lushnje			
52	Sh.a. UK Tiranë			
53	Sh.a. UK Memaliaj			
Nëntotali				
	53	1	1	3
Totali 58				

Burimi: ERRU

Tabela 3. Shoqëritë e Riorganizuara dhe të Licencuara sipas Reformës

Nr.	Shoqëri të Licencuara sipas Reformës					
	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Sh.a UK Kukës	Sh.a UK Gjirokastrë	Sh.a UK Libohovë	Sh.a UK Pukë	Sh.a UK Fier	Sh.a.UK Selenicë
2	Sh.a UK Vorë	Sh.a U Gramsh	Sh.a UK Dropull	Sh.a UK Elbasan	Sh.a UK Bulqizë	Sh.a.UK Tiranë
3	Sh.a UK Belsh	Sh.a UK Korçë	Sh.a UK Konispol			Sh.a.UK Memaliaj
4	Sh.a UK Malësi e Madhe	Sh.a UK Krujë	Sh.a UK Tropojë			
5		Sh.a UK Mirditë	Sh.a UK Vlorë			
6		Sh.a U Poliçan	Sh.a UK Rrogozhinë			
7		Sh.a UK Berat Kuçovë	Sh.a UK Kavajë			
8		Sh.a UK Devoll	Sh.a UK Sarandë			
9		Sh.a UK Maliq	Sh.a UK Ura Vajgurore			
10		Sh.a UK Patos				
11		Sh.a UK Skrapar				
12		Sh.a UK Vau Dejës				
13		Sh.a UK Tepelenë				
14		Sh.a UK Delvinë				
15		Sh.a UK Lezhë				
16		Sh.a UK Pogradec				
17		Sh.a UK Shkodër				
18		Sh.a UK Cërrik				
19		Sh.a UK Roskovec				
20		Sh.a UK Mat				
21		Sh.a UK Lushnje				
22		Sh.a UK Librazhd				
Nëntotali						
	4	22	9	2	2	3
42						

Burimi ERRU

Aneks 2 - Tarifat aktuale për Shërbimin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin e Ujërave të Ndotura

Nr.	Lloji i Shoqërisë	Shoqëritë	Data e hyrjes në fuqi të vendimit	2021								
				Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm			Shërbimi i largimit të ujërave të ndotur			Tarifë fikse		
				Tarifë variabël			Tarifa variabël					
				Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat
1	UK	Belsh										
2	UK	Berat-Kuçovë	01.11.2019	50	130	130	14	24	24	100	200	200
	Nj. Administrative	Roshnik	01.11.2019	40	130	130	14	24	24	100	200	200
3	UK	Bulqizë	01.01.2013	17	55	75				100	100	100
	Nj. Administrative	Krastë		30	80	100	7	10	15			
4	UK	Cërrik										
5	UK	Delvinë	01.05.2019	58	120	120	18	35	35	167	200	200
6	UK	Devoll	01.01.2012	38	100	110				50	50	50
7	UK	Dibër	01.01.2010 dhe 01.07.2015	27	65	85						
8	Sha U	Divjakë										
9	UK	Dropull										
10	UK	Durrës	01.03.2016	70	120	130	50	60	60	150	150	150
11	UK	Elbasan	01.01.2006	38	115	130	8	25	30			
	Nj. Administrative	Elbasan (Zona Rurale)	01.06.2015	38	120	120				120	120	120
12	UK	Fier	01.01.2021	52	105	125	13	18	20	200	200	200
13	UK	Finik										
14	UK	Fushë Arrëz										
	UK	Gjrokastrë	01.04.2019	46	133	138	11	18	18	100	100	100
15	Nj. Administrative	Cepo, Antigoni, Lazarat, Lunxhëri, Odrie, Picar	01.04.2019	25	60	60	-	-	-	80	-	-
16	U	Gramsh	01.06.2018	32	90	90				60	150	180
17	U	Has										
18	UK	Himarë	01.12.2019	55	100	100	30	50	50	200	200	300
19	UK	Kamëz										
20	UK	Kavajë	01.07.2010	38	80	100	15	20	20			
21	U	Këlcyrë										
22	UK	Klos										
23	UK	Kolonjë	01.04.2015	38	100	110	10	13	18	100	100	100
24	UK	Konispol										
	UK	Korçë	01.01.2018	72	117	140	42	64	64	140	140	140
	Nj. Administrative	Mollaj, Bulgarec	01.01.2018	38	110	100				100	100	100
25	Nj. Administrative	Voskop, Komuna Vithkuq, Bulgarec (të tjera)	01.01.2018	28	110	100				100	100	100
	Nj. Administrative	Drenovë	01.01.2018	28	110	100				100	100	100
	Nj. Administrative	Voskopojë	01.01.2018	28	110	100				100	100	100
26	UK	Krujë	01.12.2019	35	80	100	8	12	12	100	200	200
27	UK	Kukës										
28	UK	Kurbin	01.01.2011	30	80	120				50	50	50
29	UK	Lezhë	01.01.2014	58	135	145	18	22	27	200	200	200
30	UK	Libohovë										
	UK	Librazhd-Prrenjas	01.12.2018	42	100	100	15	25	26	100	100	100
31	Nj. Administrative	Qukës, Rrajcë, Stravaj, Stebleve, Hotolisht, Lunik, Orenje, Polis, Qendër Librazhd	01.12.2018	26	60	60	-	-	-	100	100	100
	UK	Lushnje										
32	Nj. Administrative	Lushnje, Kolonjë, Fier-Shegan, Dushk	01.10.2019	62	130	130	17	21	24	100	200	200
	Nj. Administrative	Bubullime, Allkaj, Krutje, Golem, Ballagat, Hysgjokaj, Karbunarë	01.10.2019	62	110	110	17	21	24	100	100	100
33	UK	Malësi e Madhe	01.03.2018 dhe 01.08.2019	50	120	120	12	15	15	167	167	167
	UK	Maliq										
34	Nj. Administrative	Maliq, Libonik, Pojan, Vreshtas, Parg (Zona Fushore)	01.03.2018	45	100	105				54/50 *	54/50 *	54/50 *
	Nj. Administrative	Maliq, Libonik, Parg, Gore, Moglicë (Zona Malore)	01.03.2018	22.5	100	105				27	54	54
35	UK	Mallakastër										
36	UK	Mat	01.01.2006	23	60	80	2	4	6			
	UK	Mirditë	01.01.2012	30	100	115	10	15	15			
37	Nj. Administrative	Rubik	01.10.2008	30	70	100	7	10	15			
38	UK	Patos	01.04.2021	70	135	135	20	20	20	200	200	200
39	UK	Peqin	01.12.2020	48	120	120	12	16	16	100	200	200
40	UK	Përmet	01.01.2013	40	110	120				100	100	200
41	UK	Pogradec										
	Nj. Administrative	Pogradec Buçimas		60	111	111	30	40	40	200	300	300
	Nj. Administrative	Udenisht, Cerravë, Proptisht, Velçan, Trebinjë, Dardhas	01.10.2020	30	100	100	15	30	30	100	100	100
42	UK	Polican	01.04.2019	50	100	110	12	15	15	100	100	100
43	UK	Pukë	01.01.2014	35	130	140	8	16	16	100	100	100
44	UK	Pustec										
45	UK	Roskovec	01.02.2020	52	105	125	15	20	20	100/50*	100/50*	100/50*
46	UK	Rrogozhinë	01.01.2013	48	90	100	10	12	12	50	100	100
47	UK	Sarandë	01.07.2021	60	140	140	25	45	45	200	200	200
48	UK	Selenicë	01.07.2010	30	80	100						
49	UK	Shkodër	01.01.2012	40	110	110	15	20	20	100	100	100
50	UK	Skrapar	01.06.2018	35	100	110	10	10	10	100	100	100
51	UK	Tepelenë	01.01.2014	33	100	120	12	20	20	90	400	250
52	UK	Tiranë	01.01.2018	65	140	155	11	30	35	200	200	200
	UK	Tropojë										
53	Nj. Administrative	Bajram Curri	01.08.2019	40	80	80	13	22	22	100	100	100
	Nj. Administrative	Bujan, Bytyc Fierzë, Llugaj, Margega, Tropojë, Lekbibaj	01.08.2019	30	80	80	-	-	-	100	100	100
54	UK	Ura Vajguore	10.01.2007	40	90	100						
55	UK	Vau i Dejës	01.12.2018	42	120	120	7	20	20	83	167	167
56	UK	Vlorë	01.12.2019	45	100	100	15	25	25	100	150	150
57	UK	Vorë	01.02.2020	65	140	155	15	30	35	200	200	200

Burimi ERRU

Shoqëritë që nuk kanë tarifa të miratuara nga ERRU

* Janë tarifa fikse të ndara për ujë dhe kanalizime

Aneks 3 - Treguesit e Performancës së Shoqërive UK, Viti 2021

Grupimi	Shërbimi	Shoqëritë	Mbulimi kostos totale	Mbulimi i kostos direkte O&M	Niveli i matjes	Norma e arkëtimit e përgjithshme	Norma e arkëtimit korrente	Efienca e stafit U+K	Humbjet, uji pa të ardhura	Mbulimi me kanalizim e	Mbulimi me ujësjellës	Furnizim i me ujë
Grupi 1	ITUP	Tiranë	144%	170%	90%	89%	81%	3.67	62%	91%	97%	17
	ITUN	Durrës	57%	74%	96%	91%	77%	5.31	79%	57%	96%	13.1
	UK	Vlorë	48%	70%	65%	117%	95%	4.39	77%	64%	91%	13.5
	UK	Elbasan	68%	91%	76%	120%	68%	5.30	74%	57%	71%	13.57
	UK	Fier	81%	95%	72%	99%	82%	5.01	68%	42%	63%	22
	ITUN	Shkodër	46%	80%	71%	90%	69%	5.85	69%	44%	56%	21.7
	ITUN	Korçë	80%	173%	99%	95%	82%	2.37	29%	65%	92%	24
	UK	Berat Kuçovë	94%	140%	78%	102%	89%	4.89	65%	55%	71%	15
	ITUN	Kavajë	26%	39%	41%	98%	75%	7.11	68%	73%	98%	10
	UK	Kamëz	30%	66%	77%	106%	98%	3.86	71%	83%	73%	4
	UK	Lushnje	59%	81%	96%	94%	82%	5.35	70%	37%	73%	10
	ITUN	Sarandë	68%	99%	95%	91%	69%	4.87	42%	80%	100%	10
	ITUN	Pogradec	54%	112%	86%	107%	98%	5.79	39%	50%	86%	20.4
	ITUN	Lezhë	57%	145%	86%	100%	92%	4.25	27%	62%	75%	24
Totali Grupi I-rë			80%	113%	84%	97%	81%	4.4	67%	67%	85%	14.37
Grupi 2	UK	Maliq	62%	68%	89%	102%	92%	5.43	40%	28%	68%	17.11
	UK	Gjirokastrë	74%	90%	61%	100%	75%	8.58	45%	41%	100%	13
	UK	Devoll	86%	92%	100%	115%	91%	6.53	32%	0%	95%	24
	UK	Dibër	96%	101%	59%	82%	66%	6.34	56%	17%	40%	11
	UK	Kërrik	51%	56%	83%	87%	65%	6.45	68%	29%	64%	22
	UK	Belsh	61%	64%	92%	98%	63%	9.63	33%	15%	72%	8.5
	UK	Kurbin	31%	37%	21%	77%	67%	8.89	49%	37%	46%	4
	UK	Kukës	75%	107%	37%	73%	50%	7.45	30%	40%	75%	10.51
	UK	Librazhd	99%	117%	99%	93%	60%	5.30	43%	21%	29%	24
	UK	Divjakë	43%	49%	99%	119%	59%	11.14	65%	0%	55%	11.64
	UK	Mat	59%	66%	70%	100%	89%	6.80	42%	47%	84%	16
	UK	Himarë	72%	90%	93%	90%	84%	6.65	69%	18%	91%	16
	UK	Krujë	70%	77%	76%	82%	66%	6.85	68%	26%	43%	8
	UK	Mallakastër	42%	51%	63%	102%	83%	15.94	59%	22%	78%	11
	UK	Patos	38%	40%	33%	74%	62%	17.74	60%	52%	73%	11.5
	UK	Malësi e Madhe	82%	108%	76%	84%	77%	12.14	51%	2%	57%	19
	U	Gramsh	74%	91%	89%	98%	90%	8.75	38%	0%	90%	24
	UK	Rrogozhinë	51%	54%	95%	95%	71%	7.86	62%	8%	66%	7.5
	U	Bulqizë	72%	75%	25%	97%	81%	11.16	44%	0%	51%	24
	UK	Përmet	67%	96%	93%	108%	82%	7.21	35%	69%	96%	24
	UK	Dropull	45%	74%	19%	65%	65%	7.02	28%	0%	100%	6.5
	UK	Vorë	77%	86%	83%	109%	95%	12.37	69%	51%	55%	8
	UK	Erseke	143%	145%	40%	89%	88%	3.79	19%	82%	100%	21
	U	Selenice	99%	102%	23%	44%	44%	11.38	72%	0%	74%	7
	UK	Ura Vajgurore	43%	56%	97%	95%	58%	9.59	55%	15%	51%	12
	UK	Skrapar	44%	49%	33%	93%	71%	8.25	49%	46%	93%	14
	UK	Vau Dejës	40%	42%	84%	76%	63%	9.63	61%	6%	57%	10
	U	Peqin	55%	58%	98%	94%	80%	23.98	67%	0%	48%	20
	UK	Tropojë	87%	118%	89%	65%	65%	10.02	36%	25%	59%	19
	UK	Delvinë	69%	83%	72%	83%	80%	7.34	46%	38%	89%	8
	UK	Roskovec	44%	84%	93%	88%	57%	8.95	65%	32%	50%	4.5
	UK	Mirditë	35%	51%	70%	100%	85%	11.31	56%	40%	56%	15
	UK	Poliçan	39%	42%	66%	98%	98%	8.10	46%	68%	69%	24
Totali Grupi II-të			70%	59%	71%	90%	73%	8.76	53%	24%	63%	13.2
Grupi 3	UK	Tepelenë	44%	64%	68%	113%	67%	9.88	27%	49%	78%	20
	UK	Finiq	81%	96%	60%	75%	50%	10.23	76%	0%	44%	21.4
	U	Konispol	36%	79%	99%	101%	93%	10.50	27%	0%	95%	20
	U	Klos	65%	77%	46%	80%	62%	13.71	27%	0%	34%	10
	UK	Pukë	84%	92%	83%	101%	82%	8.78	74%	26%	39%	23
	UK	Këlcyrë	31%	33%	95%	114%	78%	19.30	74%	0%	47%	10
	U	Has	36%	43%	72%	86%	55%	20.43	54%	0%	69%	8
	UK	Libohovë	58%	62%	2%	68%	62%	12.48	72%	0%	100%	22
	UK	Fushë Arrëz	37%	67%	46%	95%	89%	7.99	49%	35%	44%	24
	UK	Pustec	29%	32%	100%	86%	68%	12.62	38%	24%	52%	24
Totali Grupi III-të			67%	47%	61%	94%	70%	11.85	60%	12%	56%	14.9
Gjendja në sektor			76%	103%	80.7%	94.14%	79.81%	5.28	64.73%	51.87%	77.01%	13.79

Burimi ERRU

- Të dhënat e publikuara janë operative pasi ato përfundimtare të certifikuara jepen në Raportin e Performancës së Sektorit UK për vitin 2021 që publikohet nga ERRU në muajin Qershor të vitit pasardhës, pas miratimit të bilanceve financiare nga ekspertët kontabël.

Aneks 4 - Subvencionet e Shoqërive UK për Vitin 2020-2021 (në lekë)

Nr.	Emërtimi	Totali	Për Energji Viti 2020	Për Energji Viti 2021	Diferenca
Grupi I-rë					
1	Kavajë	20,357,312	12,354,100	17,612,000	+5,257,900
2	Sarandë	0	0		
3	Berat - Kuçovë	0	0		
4	Lezhë	0	0		
5	Tiranë	0	0		
6	Lushnje	5,698,100	5,608,100	12,458,000	+6,849,900
7	Durrës	30,175,200	30,175,200	98,250,000	+68,074,800
8	Vlorë	30,849,000	30,429,000	52,515,000	+22,086,000
9	Elbasan	3,924,900	3,884,900	30,345,000	+26,460,100
10	Shkodër	82,749,042	7,207,900	4,228,000	-2,979,900
11	Korçë	0	0		
12	Pogradec	0	0		
13	Kamëz	5,998,506	5,836,700		
14	Fier	0	0		
Nëntotal Gr I		179,752,060	95,495,900	215,408,000	
Grupi II-të					
1	Dropull	20,000	0		
2	Selenicë	5,662,433	1,205,000	8,265,000	+7,060,000
3	Divjakë	6,385,392	2,600,400	7,494,000	+4,893,600
4	Gjirokastër	10,410,536	0		
5	Malësi e Madhe	8,341,073	0		
6	Belsh	6,962,500	1,962,500	4,792,000	+2,829,500
7	Vau i Dejës	8,823,929	1,063,400	7,768,000	+6,704,600
8	Përmet	1,000,000	0	1,082,000	+1,082,000
9	Roskovec	1,227,100	707,100		
10	Krujë	15,471,750	2,063,500	11,239,000	+9,175,500
11	Tepelenë	24,374,458	0		
12	Himarë	0	0		
13	Ersekë	3,000,000	0		
14	Vorë	6,685,600	1,685,600	3,162,000	+1,476,400
15	Delvinë	5,161,000	361,000	167,000	-194,000
16	Ura Vajgurore	7,209,291	2,909,100	7,308,000	+4,398,900
17	Kukës	87,349,258	0		
18	Gramsh	2,000,000	0		
19	Librazhd	0	0		
20	Bilisht	1,200,000	0		
21	Kurbin	19,699,987	8,475,900	21,607,000	+13,131,100
22	Maliq	1,040,400	1,040,400	3,124,000	+2,083,600
23	Mirditë	14,098,450	0	3,300,000	+3,300,000
24	Mallakastër	14,054,336	3,915,100	13,481,000	+9,565,900
25	Bulqizë	15,865,079	0		
26	Patos	65,986,304	12,346,100	32,760,000	+20,413,900
27	Burrel	3,198,372	0		
28	Cërrik	6,765,946	2,758,800	8,288,000	+5,529,200
29	Rrogozhinë	8,934,473	2,374,300	5,449,000	+3,074,700
30	Çorovodë	8,838,684	1,022,800	2,900,000	+1,877,200
31	Peqin	13,584,748	3,773,500	10,629,000	+6,855,500
32	Dibër	13,308,605	0		
Nëntotal Gr-II		386,659,704	50264500	152,815,000	
Grupi III-të					
1	Pustec	5,002,080	0	500,000	+500,000
2	Libohovë	5,329,135	0		
3	Poliçan	36,810,811	675,100	1,739,000	+1,063,900
4	Tropojë	49,532,151	0		
5	Pukë	5,489,723	0		
6	Këlcyrë	12,921,515	711,000	2,412,000	+1,701,000
7	Konispol	2,026,500	2,026,500	2,986,000	+959,500
8	Fushë Arrëz	5,353,698	0		
9	Has	30,797,647	827,000	4,140,000	+3,313,000
10	Finiq	324,976	0		
11	Klos	0	0		
Nëntotal Gr III		153,588,236		11,777,000	
TOTALI		720,000,000	150,000,000	380,000,000	+230,000,000

Burimi: AKUM

Aneks 5 - Zonat Urbane me Furnizim me Ujë 24/7 orë (Viti 2021)

Qarku	66 Zona Urbane (ZU) - 61 Bashki	2021- Shërbimi orë/ditë
Shkodër	Shkodër	24
	Fushë Arrëz	24
	Pukë	24
	Vau i Dejës	24
	Koplik	24
Lezhë	Lezhë	24
	Rrëshen	24
	Rubik	-
	Laç	-
	Mamurras	-
Kukës	Kukës	-
	Tropojë	24
	Krumë	-
Tiranë	Tiranë	-
	Kamëz	24
	Kavajë	-
	Rrogozhinë	-
	Vorë	-
Durrës	Durrës	-
	Krujë	24
	Fushë - Krujë	-
	Shijak	-
Dibër	Peshkopi	-
	Bulqizë	-
	Burrel	-
	Klos	-
Elbasan	Elbasan	-
	Librazhd	-
	Përrenjas	-
	Gramsh	24
	Cërrik	24
	Belsh	-
	Peqin	24
Korçë	Korçë	24
	Pogradec	24
	Maliq	24
	Pustec	-
	Bilisht	24
	Ersekë	24
	Leskovik	-
Berat	Berat	24
	Kuçovë	24
	Ura vajgurore	-
	Polican	24
	Çorovodë	-
Fier	Fier	24
	Lushnje	-
	Divjakë	-
	Patos	-
	Roskovec	-
	Ballsh	-
Vlorë	Vlorë	-
	Selenicë	-
	Himarë	24
	Delvinë	-
	Sarandë	24
	Ksamil	-
	Finiq	-
	Konispol	24
Gjirokastrë	Gjirokastrë	-
	Tepelenë	24
	Memaliaj	24
	Këlcyrë	24
	Përmet	24
	Libohovë	-
	Dropull	-
Total		29 ZU

Burimi: AKUM

 Zonat Urbane me furnizim 24/7 orë të shtuara gjatë vitit 2021

Aneks 6 - Mbledhjet dhe Vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator Viti 2021

Nr.	Data e mbledhjes	Vendime
1	14.01.2021	Vendim për detajimin e planit të shpenzimeve operative të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2021
2	14.01.2021	Vendim për miratimin e Programit Vjetor të shërbimeve jashtë vendit të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2021
3	27.01.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Korçë për efekt të përfundimit të afatit
4	27.01.2021	Vendim për miratimin e Raportit vjetor të aktivitetit të ERRU-së për vitin 2020
5	04.02.2021	Vendim për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë UK Patos
6	04.02.2021	Vendim për një ndryshim në planin e shpenzimeve operative të ERRU-së për vitin 2021
7	04.03.2021	Vendim për dhënie ndihme në rast fatkeqësie për Z. Taulant Kullolli dhe Znj. Etleva Prifti
8	04.03.2021	Vendim për miratimin e programit të transparencës së ERRU sipas modelit të ri të miratuar nga Komisioni për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale
9	04.03.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Tiranë për efekt të përfundimit të afatit
10	04.03.2021	Vendim për një ndryshim në vendimin Nr. 40 datë 01.06.2018 "Për licencimin e UK Tropojë"
11	04.03.2021	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR Nr. 62 datë 06.09.2018 "Për licencimin e UK Sarandë"
12	04.03.2021	Vendim për rinovim licence UK Lushnje për efekt të përfundimit të afatit
13	06.04.2021	Vendim për rinovim licence UK Rrogozhinë për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik
14	06.04.2021	Vendim për rinovim licence UK Vorë për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor
15	06.04.2021	Vendim për zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik si dhe përzgjedhjen e koordinatores Znj. Malvina Zaja
16	14.05.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Pogradec për efekt të përfundimit të afatit
17	14.05.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Gjirokastrë për efekt të përfundimit të afatit
18	14.05.2021	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR Nr. 13, datë 14.01.2021 "Detajimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU viti 2021"
19	14.05.2021	Vendim për dhënie ndihmë në rast fatkeqësie Znj. Suela Çota
20	28.05.2021	Vendim për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për UK Sarandë
21	28.05.2021	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR Nr. 13 datë 14.01.2021 "Detajimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU viti 2021"
22	16.06.2021	Vendim për veprimtari të karakterit social dhe dhënien e ndihmës nga fondi i veçantë për Znj. Engjëllushe Murataj.
23	16.06.2021	Vendim për emërim në detyrë si përgjegjëse e sektorit ekonomik dhe tarifave për Znj. Elda Kruja
24	09.07.2021	Vendim për miratimin e raportit të performancës të shoqërive UK për vitin 2020
25	09.07.2021	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR Nr. 39 datë 01/06/2021 për licencimin e UK Konispol nga ndryshimi i drejtuesit teknik
26	09.07.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Selenicë për efekt të përfundimit të afatit
27	09.07.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Krujë për efekt të përfundimit të afatit
28	15.07.2021	Vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë UK Mallakastër
29	20.08.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Mat për efekt të përfundimit të afatit
30	20.08.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Skrapar për efekt të përfundimit të afatit
31	20.08.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Has për efekt të përfundimit të afatit
32	20.08.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Delvinë për efekt të përfundimit të afatit
33	23.09.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Durrës për efekt të përfundimit të afatit
34	23.09.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Librazhd Prrrenjas për efekt të përfundimit të afatit
35	23.09.2021	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR Nr. 13, datë 14.01.2021 detajimin i planit të shpenzimeve operative të ERRU viti 2021

36	23.09.2021	Vendim për caktimin e zëvendëskryetarit të KKRR Znj. Evis Shurdha
37	23.09.2021	Vendim për emërim në detyrë të Greta Nanushi në pozicionin "Specialist i burimeve njerëzore"
38	21.10.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Gramsh për efekt të përfundimit të afatit
39	21.10.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Maliq për efekt të përfundimit të afatit
40	21.10.2021	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR Nr. 55, datë 28.10.2019 për licencimin e UK Elbasan nga ndryshimi i drejtuesit ligjor dhe teknik
41	21.10.2021	Vendim për miratimin e projektplanit të shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2022
42	21.10.2021	Vendim për shpalljen fituese të Znj. Besarta Basha për pozicionin "Specialist i marrëdhënieve me publikun "
43	21.10.2021	Vendim për shpalljen fituese të Znj. Nevila Saliu për pozicionin "Specialist i analizës së aseteve dhe investimeve"
44	21.10.2021	Vendim për miratimin e projektaktit normativ administrativ " Rregullore për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes midis konsumatorit dhe operatorit UK nga struktura e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes
45	11.11.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Roskovec për efekt të përfundimit të afatit
46	11.11.2021	Vendim për licencimin e shoqërisë UK Cërrik për efekt të përfundimit të afatit
47	11.11.2021	Vendim për licencimin e UK Shkodër për efekt të përfundimit të afatit
48	11.11.2021	Vendim për licencimin e UK Tepelenë për efekt të përfundimit të afatit
49	23.11.2021	Vendim për licencimin e UK Lezhë për efekt të përfundimit të afatit
50	23.11.2021	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR Nr. 13 datë 14/01/2021 "Detajimi i planit të shpenzimeve operative të ERRU-së viti 2021
51	23.11.2021	Vendim për shpërbimin vjetor të Kryetarit
52	09.12.2021	Vendim për aplikimin për rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit për shoqërinë UK Poliçan
53	09.12.2021	Vendim për aplikimin për rinovim licence për shoqërinë UK Devoll për efekt të përfundimit të afatit
54	09.12.2021	Vendim për miratimin e strukturës për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve
55	09.12.2021	Vendim për një ndryshim detajim i planit të shpenzimeve operative të ERRU-së për vitin 2021
56	21.12.2021	Vendim për rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit për shoqërinë UK Berat Kuçovë
57	21.12.2021	Vendim për licencim për herë të parë të UK Memaliaj
58	30.12.2021	Vendim për rinovim licence të Ujësjetllës Kanalizime Krujë për efekt të ndryshimit të Drejtuesit Ligjor
59	30.12.2021	Vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e tarifave të shoqërisë UK Konispol
60	30.12.2021	Vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e tarifave të shoqërisë UK Kukës
61	30.12.2021	Vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e tarifave të shoqërisë UK Bulqizë
62	30.12.2021	Vendim për miratimin e "Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve Ujësjetllës Kanalizime"
Në Total 20 Mbledhje KKRR dhe 62 Vendime KKRR		

Aneks 7 - Referencat Ligjore të Aktivitetit të ERRU-së

- Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102);
- Ligji nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit" (ligji nr. 120/2016);
- Ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar (ligji nr. 9902);
- Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar (ligji nr. 9121);
- Ligj nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë (Kodi i Procedurës Administrative);
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (Kodi i Punës);
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar (ligji nr. 10296);
- Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" (ligji nr. 9584);
- Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" (ligji nr. 8480).
- VKM nr. 958, datë 6.5.2009 "Për Miratimin e Kategorive të Licencimit dhe Procedurave të Aplikimit për Licencë të Operatorëve që Ushtrojnë Veprimtarinë në Sistemet e Furnizimit me Ujë, të Largimit dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotura".
- Rregullore e Licencimit "Për Procedurat e Dhënies dhe Rinovimit të Licencave Profesionale për Subjektet Juridike e Fizike që Ushtrojnë Veprimtari në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura", miratuar me Vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009, e ndryshuar.
- Vendimi nr. 39, datë 09.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".
- Vendimi nr. 40, datë 09.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura".
- Vendimi nr. 41, datë 09.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura".
- Vendimi nr. 42, datë 09.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura".



Të sigurojmë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.